

79/2009, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17 и 51/18).

Член 376

Овој закон влегува во сила со денот на објавување-то во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J PËR MBROJTJE SOCIALE

Kreu I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen sistemi dhe organizimi i mbrojtjes sociale, shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale, të drejtat e ndihmës në para dhe shërbimet sociale, procedurat për realizimin e të drejtave dhe shfrytëzimin e shërbimeve, kryerja e veprimtarisë së mbrojtjes sociale, kuadrot, financimi dhe mbikëqyrja ndaj kryerjes së mbrojtjes sociale dhe çështje të tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së mbrojtjes sociale.

Neni 2

Mbrojtja sociale është veprimtari me interes publik që realizohet përmes, masave, aktiviteteve, programeve dhe politikave për mbrojtje nga rreziqe sociale, preventivë dhe tejkallim i problemeve sociale të cilat në mënyrë të pavolitshme pasqyrohen ndaj mirëqenies së qytetarëve, me qëllim:

- promovim dhe mirëmbajtje të sigurisë sociale të qytetarëve,
- parandalim të përjashtimit social,
- përmirësim të kualitetit të jetës së qytetarëve dhe
- përforsim të kapaciteteve të qytetarëve për mbajtje të jetës së pavarur, aktive dhe produktive.

Neni 3

Veprimtaria e mbrojtjes sociale sigurohet përmes realizimit të të drejtave të ndihmës në para nga mbrojtja sociale dhe sigurimi i shërbimeve sociale dhe masa të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Mbrojtja sociale realizohet edhe përmes marrjes së masave dhe aktiviteteve në punësimin, dhënien e bursës, banimin, mbrojtjen e familjes, mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen shëndetësore, edukimin dhe arsimimin dhe në sfera të tjera në pajtim me ligj.

Institucionet për mbrojtje sociale dhe dhënësit tjerë të shërbimeve sociale në realizimin e mbrojtjes sociale, bashkëpunojnë me institucionet për fëmijë, shkollat, institucionet shëndetësore, policinë, organet e jurisprudencës dhe organet tjera shtetërore, shoqatat, dhe persona tjerë juridikë dhe fizikë.

Lista e nocioneve

Neni 4

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1) **“Problem social”** është ngjarje apo situatë objektive e shkaktuar nga ngjarje të ndërlikuara shoqërore, fatkeqësi natyrore dhe sjellje devijuese, e cila ndikon negativisht ndaj individit, grupeve shoqërore ose bashkësisë në mënyrë që ua vështirëson ose pamundëson funksionimin social dhe plotësimin e nevojave njerëzore, kurse pasojat e të cilave nuk mund të tejkalohet pa mbështetje shoqërore të organizuar;

2) **“Rreziku social”** është gjendje që ka potencial të vështirësujë ose të pamundësujë funksionimin e papenguar social të individit, familjes dhe grupit të caktuar, i cili mund të vijë në nevojë të ndihmës sociale. Reziqet sociale themelore në të cilat është i ekspozuar individi në kuptim të këtij ligji janë: amësia, sëmundja, pleqëria, vdekja, lëndimi dhe pengesa;

3) **“Ekonomi familjare”** është ekonomi familjare me një anëtar ose bashkësi e anëtarëve të familjes, si dhe të afërm të tjerë, ndër të cilët nuk ekziston detyrim ligjor për mbështetje reciproke, të cilët jetojnë së bashku, kontribuojnë, menaxhojnë dhe shpenzojnë;

4) **“Prind i vetëm”** është prind i cili vetë i kryen të drejtat dhe detyrat prindërore të fëmijës, sepse prindi tjetër është i panjohur, i vdekur, i zhdukur ose për arsye të justifikuara përkohësisht ose përgjithmonë nuk i ushtron të drejtat dhe detyrat prindërore;

5) **“Person me pengesa”** është person i cili ka çrregullime afatgjata trupore, intelektuale, mentale ose të shqisave, të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efikase në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

6) **“Person i moshuar”** është person me 65 vite jetë të mbushura;

7) **“Aktivitete themelore nga jeta e përditshme”** janë: mirëmbajtje e higjienës personale, veshje, shfrytëzim i pavarur i tualetit, mobilitet funksional në shtëpi, vetë-ushqyerje dhe aktivitete tjera të ngjashme;

8) **“Aktivitete instrumentale nga jeta e përditshme”** janë: pastrim, riparime, larje, përgatitje, blerje e produkteve, mobilitet i jashtëm, marrja e terapisë mjekësore dhe aktivitete tjera të ngjashme;

9) **“Dhënës të licencuar të shërbimeve sociale”** janë dhënës së shërbimeve të cilët i plotësojnë normativat dhe standardet për dhënie të shërbimeve dhe janë pajisur me leje për kryerje të punëve në mbrojtjen sociale;

10) **“Dhënës të autorizuar të shërbimeve sociale”** janë dhënës të licencuar të shërbimeve të cilët kanë lidhur marrëveshje administrative me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, përkatësisht komunat, qyteti i Shkupt dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe u japin shërbime shfrytëzuesve, pas aktvendimit të sjellë të Qendrës për Punës Sociale;

11) **“Shërbime të integruara sociale”** janë shërbime sociale të ngjashme në shtëpinë, bashkësinë dhe në familje të cilat jepen nga ana e dhënësit të licencuar të shërbimeve sociale;

12) **"Plan individual"** është plan për ndryshimin e situatës jetësore, përkatësisht sjelljes së shfrytëzuesit, e përpunuar në bazë të përqindjes gjithëpërfshirëse të nevojave, problemet dhe resurset në marrëveshje me shfrytëzuesin dhe anëtarët e familjes së tij, kurse me qëllim të tejkalimit të rrethanave jetësore të pavalitshme;

13) **"Udhëheqës i rastit"** është punëtor profesional i ngarkuar për rast konkret i cili në bashkëpunim me shfrytëzuesin i përcakton potencialet dhe nevojat e tij dhe shfrytëzon resurse profesionale dhe të tjera nga Qendra për Punë Sociale, institucione dhe organizata të tjera në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, kurse të cilat janë të dosmosdoshme për plotësimin e nevojave dhe tejkalimin e problemeve, përkatësisht sigurim i shërbimeve përkatëse për shfrytëzuesin;

14) **"Supervizor"** është punëtor profesional me licencë të specializuar të marrë për supervizion i cili e koordinon, drejton, nxit dhe evaluon punën e menaxhuesit të rastit përmes sigurimit të mbështetjes profesionale dhe mësimit për zhvillim të kompetencave për punë me shfrytëzues dhe

15) **"Trijazer"** është punëtor profesional në qendrën për punë sociale i cili kryen pranimin e parë, vlerësim dhe udhëzim të shfrytëzuesit për shkak të realizimit të të drejtës të ndihmës në para dhe/ose shërbimeve.

Neni 5

Shprehjet, të përdorura në këtë ligj të cilat janë të përcaktuara në bazë gjinore, shfrytëzohen në mënyrë neutrale dhe kanë të bëjnë në mënyrë të barabartë me persona nga gjinia mashkullore dhe femërore.

Neni 6

Republika kujdeset për mbrojtjen sociale të qytetarëve në pajtim me parimin e barazisë sociale.

Republika e vendos sistemin e mbrojtjes sociale dhe e mundëson funksionimin e tij.

Bartës të mbrojtjes sociale janë Republika, komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, në korniza të kompetencave të veta, kurse në pajtim me këtë ligj.

Neni 7

Republika dhe komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit sigurojnë kryerje të veprimtarisë së mbrojtjes sociale në korniza të të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ligj, përmes themelimit të institucioneve për mbrojtje sociale ose ndërprerjen e kryerjes së punëve nga mbrojtja sociale të shoqatave, personave tjerë juridikë dhe fizikë.

Republika dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale kur e bartin kryerjen e punëve të personave tjerë juridik dhe fizikë, të drejtat e tyre të ndërsjella dhe detyrime i rregullojnë me marrëveshje administrative.

Neni 8

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (në tekst të mëtejme: Ministria) përcakton rrjet të dhënësve të autorizuar të shërbimeve sociale.

Rrjetin nga paragrafi 1 të këtij neni e përbëjnë institucionet publike për mbrojtje sociale dhe dhënës të tjerë të autorizuar të shërbimeve sociale (shoqata, persona e tjerë vendas dhe të huaj), me të cilët Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, përkatësisht komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit kanë lidhur marrëveshje administrative për dhënie të shërbimeve sociale, si dhe personi fizik i cili ka marrë leje për kryerjen e punëve nga mbrojtja sociale si veprimtari profesionale dhe kanë lidhur marrëveshje me Qendrën për Punë Sociale.

Shoqata, persona të tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët nuk janë në rrjetin e dhënësve të autorizuar të shërbimeve sociale, shërbime sociale japin nëse kanë marrë leje për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale.

Neni 9

Për realizimin e veprimtarisë së mbrojtjes sociale, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Qeveria):

- miraton Program Nacional për zhvillimin e mbrojtjes sociale në të cilën përcaktohen qëllimet, prioritetet dhe drejtimitet e zhvillimit të mbrojtjes sociale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me masa të afatit të mesëm prej pesë vjet dhe në afat të gjatë deri në 10 vjet,

- miraton program vjetor për realizimin e mbrojtjes sociale me të cilin i përcakton territoret e mbrojtjes sociale, nevojat e popullatës dhe mënyrën dhe mjetet për realizimin e mbrojtjes sociale,

- themelon institucione publike për mbrojtje sociale dhe jep leje për themelimin e institucioneve për mbrojtje sociale nga ana e komunave, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe personave tjerë juridikë dhe fizikë për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale.

Neni 10

Për realizimin e veprimtarisë së mbrojtjes sociale, Ministria:

- zhvillon politikë nacionale për mbrojtje sociale,
- përpilon ligje dhe dispozita të tjera me të cilat rregullohet mbrojtja sociale,

- zhvillon, koordinon dhe administron programe nacionale dhe projekte për mbrojtje sociale,

- përcakton standarde dhe normativa për dhënie të shërbimeve sociale,

- grumbullon dhe analizon informata dhe statistike në lidhje me mbrojtjen sociale dhe i ndan me publikun e përgjithshëm,

- menaxhon me sistemin për evidentim të të dhënave për mbrojtje sociale,

- siguron mjete financiare plotësuese për komunat, qytetin e Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit për mbrojtje sociale dhe lidh marrëveshje administrative për dhënie të shërbimeve sociale,

- siguron mjete financiare për kryerjen e punëve nga mbrojtja sociale dhe lidh marrëveshje administrative për dhënie të shërbimeve sociale me dhënës të autorizuar të shërbimeve sociale,

- lëshon leje për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale të personave juridikë dhe fizikë me kushte të përcaktuara me këtë ligj,

- përcakton çmime të shërbimeve të mbrojtjes sociale në nivel vjetor, në pajtim me metodologjinë për çmime të shërbimeve nga mbrojtja sociale,

- kryen mbikëqyrje ndaj punës së institucioneve, shoqatave dhe personave tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë punë nga mbrojtja sociale,

- realizon bashkëpunim me ministritë dhe organet tjera të administratës shtetërore për zhvillim të shërbimeve sociale dhe

- kryen punë të tjera të lidhura me mbrojtjen sociale nga kompetenca e Ministrisë në pajtim me ligjin.

Neni 11

Për realizimin e veprimtarisë së mbrojtjes sociale, komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, zhvillojnë masa lokale dhe aktivitete për mbrojtje sociale në pajtim me këtë ligj:

-sigurojnë zbatim të mbrojtjes sociale në pajtim me këtë ligj,

-miraton vendime për përcaktimin dhe të drejtave të tjera dhe shërbimeve sociale në sferën e mbrojtjes sociale, të drejta dhe shërbime në vëllim më të madh nga vëllimi i të drejtave dhe shërbimeve të përcaktuara me këtë ligj dhe kushte më të favorshme për realizimin e tyre, si dhe sigurojnë mjete për zbatimin e tyre,

-themelojnë institucione publike për mbrojtje sociale në pajtim me këtë ligj,

-formojnë Këshill për Mbrojtje Sociale të komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit për territorin e komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit,

-formojnë Këshill për Mbrojtje Sociale të rajonit planor për shkak të planifikimit dhe zhvillimit të rrjetit të shërbimeve sociale të rajonit planor,

- miratojnë akte të përgjithshme nga sfera e mbrojtjes sociale,

- miratojnë programe vjetore për nevojat e qytetarëve nga sfera e mbrojtjes sociale (në tekstin e mëtejme: program vjetor për mbrojtje sociale), në të cilin parashohin aktivitete dhe mjete për realizimin e të njëjtave. Programet vjetore për mbrojtje sociale përgatiten në bazë të planit social të komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, kurse në pajtim me Programin Nacional për Zhvillim të Mbrojtjes Sociale dhe të njëjtë para miratimit, dorëzohen në Ministri për mendim,

- miratojnë raport përfundimtar mbi aktivitetet e realizuara në mbrojtjen sociale në pajtim me programin vjetor të paraparë dhe i dorëzojnë në Ministri për informim,

- japin mjete financiare për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale shoqatave, personave tjerë juridikë dhe fizikë dhe lidhin marrëveshje administrative në pajtim me këtë ligj dhe

- kryen punë të tjera të lidhura me mbrojtje sociale në pajtim me këtë ligj.

Neni 12

Secili është i detyruar të kujdeset për plotësimin e nevojave të veta jetësore dhe nevojat e personave të cilët sipas ligjit është i detyruar t'i mbajë.

Secili është i detyruar me të ardhurat e veta të kontribuojë në parandalimin, zbutjen ose eliminimin e rreziqeve sociale në të cilat është i ekspozuar ai dhe anëtarët e tij të familjes dhe personat të cilët sipas ligjit është i detyruar t'i mbajë, si dhe të veprojnë në mënyrë aktive në parandalimin dhe tejkalimin e gjendjes së ekspozimit ndaj rrezikut social.

Neni 13

Shfrytëzues të mbrojtjes sociale, sipas këtij ligji, janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të huajt që kanë të rregulluar qëndrimin e përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me këtë ligj.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët nuk kanë qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të huajt që kanë qëndrim të rregullt të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me ligjin, i shfrytëzojnë të drejtat nga mbrojtja sociale nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 14

Të drejtë të mbrojtjes sociale ka personi kërkues i së drejtës për azil, person me status të refugjatit të pranuar dhe person nën mbrojtje subsidiare, nën kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj.

Kreu II.

PARIMETE MBROJTJES SOCIALE

Parimi i subsidiaritetit

Neni 15

Personi i cili nuk mund të sigurojë mirëmbajtjen përmes punës personale, përmes të drejtave që dalin nga puna ose sigurimi, nga prona, nga burime të tjera, nga persona të cilët janë të detyruar sipas ligjit ta mbështesin ose në mënyrë tjetër, ka të drejtë të mbrojtjes sociale në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimi

Neni 16

Shfrytëzuesi ka të drejtë të mbrojtjes sociale, e cila bazohet në trajtim të barabartë dhe të drejtë.

Ndalohet çdo lloj dhe forme e diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë nacionale ose etnike, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë së grupit të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë,

prejardhjes sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjeve tjera, paaftësisë, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit social ose çfarëdo baze tjetër në realizim të ndihmës në para nga mbrojtja sociale dhe shërbimet sociale, të përcaktuara me këtë ligj.

Mbrojtja nga diskriminimi sigurohet në pajtim me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Parimi i participimit

Neni 17

Shfrytëzuesi i mbrojtjes sociale ka të drejtë të marrë pjesë në vlerësimin e gjendjes së tij dhe nevojave, të jetë i informuar për shërbimet sociale në dispozicion, të marrë pjesë në përgatitjen e planit individual, në marrjen e vendimeve për shfrytëzim e shërbimeve sociale të nevojshme, si dhe në zgjedhjen e dhënësit të shërbimit, në pajtim me këtë ligj.

Pa pëlqimin e shfrytëzuesit, përkatësisht përfaqësuesit të tij ligjor, nuk mund të jepet shërbim social, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

Fëmija ka të drejtë, në pajtim me moshën e tij dhe pjekurinë, të marrë pjesë dhe ta shprehë mendimin e vet në të gjitha procedurat në të cilat vendoset për të drejtat e veta.

Person me aftësi afariste të hequr, në pajtim me mundësitë e veta, ka të drejtë të marrë pjesë dhe të japë mendim në procedura në të cilat vendoset për të drejtat e veta.

Parimi i individualitetit

Neni 18

Shërbimet sociale sigurohen përmes shfrytëzimit të qasjes së individualizuar, i përshtatshëm në karakteristikat dhe nevojat e shfrytëzuesit.

Parimi i përforsimit të shfrytëzuesit

Neni 19

Të drejtat dhe shërbimet nga mbrojtja sociale i sigurohen shfrytëzuesit në mënyrë e cila mundëson shfrytëzim maksimal të potencialeve të tij dhe përforsimin e kapaciteteve të veta për organizim të pavarur të jetës dhe vetë-ndihmë në të ardhmen.

Parimi i privatësisë

Neni 20

Shfrytëzuesi ka të drejtë të respektimit të privatësisë gjatë realizimit të drejtave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale.

Kërkesë e informatave nga shfrytëzues gjatë marrjes së masave të domosdoshme për dhënie të shërbimeve ose realizim të të drejtës, nuk llogaritet si prishje e privatësisë së shfrytëzuesit.

Parimi i respektimit të integritetit dhe të drejtave të shfrytëzuesit

Neni 21

Integriteti fizik dhe psikik, dinjiteti dhe siguria e shfrytëzuesit respektohen gjatë realizimit të mbrojtjes sociale, në pajtim me të drejtat dhe liritë e garantuara njerëzore.

Parimi i interesit më të mirë

Neni 22

Të drejtat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale sigurohen në përputhje me interesin më të mirë të shfrytëzuesit, me respektimin e integritetit të tij, moshës në të cilën ndodhet, shprehitë jetësore, nevojat zhvillimore dhe nevojat për mbështetje në funksionimin e përditshëm.

Parimi i rrethit më së paku restriktiv

Neni 23

Shërbimet sociale sigurohen në rrethin e drejtpërdrejtë dhe më së paku restriktiv për shfrytëzuesin, kryesisht nëpërmjet shërbimeve në shtëpi ose bashkësinë lokale, të cilat i mundësojnë që t'i përmirësohet kualiteti i jetës dhe të vazhdojë të jetojë në shtëpinë personale dhe bashkësinë.

Parimi i besueshmërisë

Neni 24

Shfrytëzuesit të të drejtave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale i sigurohet fshehtësi dhe mbrojtje e të dhënave personale, në pajtim me ligjin.

Shfrytëzuesit i sigurohet besueshmëri e të gjitha të dhënave private nga dokumentacioni i cili përpunohet për nevojat e njoftimit, përkatësisht evidencë, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me personalitetin e tij, sjelljen, situatën e jetës familjare dhe mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

Parimi i transparencës në punë

Neni 25

Ministria, komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit në faqen e vet të internetit, në mjetet për informim publik, si dhe në mënyra të tjera në pajtim me ligjin, e informojnë publikun për mbrojtjen sociale dhe japin informacione të tjera të përcaktuara me ligj.

Institucionet për mbrojtje sociale dhe dhënësit e shërbimeve sociale sigurojnë qasje të lirë tek informatat për punën e vet, në pajtim me ligjin.

Parimi i drejtësisë sociale

Neni 26

Shfrytëzuesi i cili realizon të drejtat e mbrojtjes sociale për shkak të pasigurisë materiale nuk mundet përmes shfrytëzimit të atyre të drejtave të arrijë pozitë materiale

më të favorshme nga personi i cili mjetet për jetë i realizon përmes punës ose në bazë të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Kreu III.

TË DREJTA TË NDIHMËS NË PARA NGA MBROJTJA SOCIALE

Neni 27

Të drejta të ndihmës në para nga mbrojtja sociale janë:

- 1) ndihma e garantuar minimale;
- 2) kompensim për shkak të pengesës;
- 3) kompensim për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër;
- 4) kompensim të rrogës për orar të shkurtuar të punës;
- 5) shtesë për banim;
- 6) kompensim i përhershëm dhe
- 7) ndihma e njëfishtë në para.

1. Ndihma e garantuar minimale

Neni 28

Të drejtë për ndihmë minimale të garantuar ka ekonomi familjare e cila është materialisht e pasiguruar dhe nuk ka në pronësi pronë dhe të drejta pronësore nga të cilat mund të mbahet.

Për pasiguri materiale konsiderohet ekonomi familjare lartësia e përgjithshme mesatare e të cilës e të gjitha të ardhurave të të gjithë anëtarëve të ekonomisë familjare sipas të gjitha bazave në tre muajt e fundit para parashtrimit së kërkesës për realizimin e së drejtës dhe gjatë shfrytëzimit të së drejtës është më e ulët se lartësia e ndihmës minimale të garantuar të përcaktuar, në pajtim me këtë ligj.

Neni 29

Lartësia e së drejtës për ndihmën minimale të garantuar llogaritet si bazë për një anëtar të ekonomisë familjare, e rritur për koeficient nga shkalla ekuivalente për anëtarët e tjerë të ekonomisë familjare, kurse më së shumti për gjithsej pesë anëtarë në familje.

Baza nga paragrafi 1 i këtij neni, arrin 4.000 denarë në muaj, kurse për çdo anëtar të rritur të ardhshëm të ekonomisë familjare baza rritet në pajtim me shkallën ekuivalente dhe atë për:

- anëtarin e dytë për koeficientin nga 0.5,
- anëtarin e tretë për koeficientin nga 0.4,
- anëtarin e katërt për koeficient nga 0.4 dhe
- anëtarin e pestë për koeficient nga 0.2.

Për fëmijë anëtarë të ekonomisë familjare baza nga paragrafi 2 i këtij neni rritet për koeficient prej 0.1.

Shkalla ekuivalente nga paragrafi 2 i këtij neni rritet për koeficient prej 0.5 për grua vetëmbajtëse gjatë shtatzënisë një muaj para lindjes dhe prind vetëmbajtës deri në fillimin e arsimit fillor të fëmijës, por më së voni deri në moshën shtatë vjeçare të fëmijës, por përfundimisht deri të fëmija i tretë.

Shkalla ekuivalente nga paragrafi 2 i këtij neni rritet për person që është i paaftë për punë për shkak të pengesës intelektuale, pengesës fizike, sëmundje shpirtërore ose për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen shëndetësore, por më së shumti deri në tre anëtarë të ekonomisë familjare edhe atë për anëtarin e parë për koeficient prej 0.5 , për anëtarin e dytë për koeficient prej 0.2, për anëtarin e tretë për koeficient prej 0.2.,

Paaftësia për punë për personat nga paragrafi 5 i këtij neni përcaktohet me konstatim, vlerësim dhe mendim nga komisioni profesional për përcaktimin e paaftësisë për punë i formuar pranë Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

Me përjashtim nga paragrafi 6 i këtij neni, i paaftë për punë llogaritet personi lloji dhe shkalla e pengesës së të cilit është përcaktuar me konstatim, vlerësim dhe mendim të organit profesional, i përcaktuar në mënyrë në pajtim me nenin 295 paragrafin 2 të këtij ligji.

Neni 30

Qendra për punë sociale e përcakton bartësin e të drejtës së ndihmës minimale të garantuar.

Bartësi i së drejtës është i detyruar që ta paraqes gjendjen numerike të ekonomive familjare, gjendjen materiale dhe statusore për veten dhe të gjithë anëtarët e ekonomisë familjare, gjatë parashtrimit të kërkesës dhe të njoftojë për ndryshimet gjatë shfrytëzimit të së drejtës, kurse të cilat ndikojnë në realizimin dhe shfrytëzimin e së drejtës, në afat prej 15 ditësh nga paraqitja e ndryshimit, në qendrën kompetente për punë sociale.

Neni 31

Ndihma minimale e garantuar paguhet në lartësinë e dallimit nga shuma e përcaktuar e ndihmës minimale të garantuar dhe e të ardhurave mesatare mujore të përgjithshme sipas të gjitha bazave të ekonomisë familjare, të realizuara në tre muajt e fundit.

Lartësia e ndihmës minimale të garantuar harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistikë në janar në vitin rrjedhës.

Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak nuk bëhet harmonizim i lartësisë së ndihmës minimale të garantuar.

Neni 32

Gjatë përcaktimit të lartësisë së ndihmës minimale të garantuar për anëtar të ekonomisë familjare nuk llogaritet personi i cili është:

- në vuajtjen e dënimit me burg më gjatë se 30 ditë,
- me aktvendim të Qendrës për Punë Sociale është vendosur në institucion për mbrojtje sociale jashtë familjes, familje kujdestare, jetë e organizuar me përkrahje, ose institucion tjetër dhe
- kryerës i dhunës familjare.

Të ardhurat dhe prona e personit nga paragrafi 1 alineja 3 të këtij neni, nuk llogariten gjatë realizimit të të drejtës së ndihmës minimale të garantuar.

Neni 33

Të drejtë të ndihmës minimale të garantuar nuk mund të realizojë ekonomia familjare në të cilin anëtar:

- mund vetë të mbahet,
- mund të realizojë të ardhura me shitje dhe dhënie me qira të pronës në pronësi të tij, të cilat anëtarët e ekonomisë familjare nuk e shfrytëzojnë,
- ka lidhur marrëveshje për mbajtje të përgjeshme, kurse nuk ka ngritur procedurë për prishjen e asaj marrëveshjeje,
- mund të sigurojë mbajtje në bazë tjetër,
- është fshirë nga evidenca e personave të papunësuar për shkak të paraqitjes së parregullt, deri në skadimin e periudhës deri kur e fiton të drejtën përsëri të regjistrohët, në pajtim me dispozitat për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë dhe / ose
- të cilit marrëdhënia e punës i ka pushuar me marrëveshje, me kërkesën e tij ose me pushimin nga puna nga punëdhënësi për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuese ose detyrime tjera nga marrëdhënia e punës, në 12 muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës për realizimin e së drejtës së ndihmës minimale të garantuar.

Të drejtë të ndihmës minimale të garantuar nuk mund të realizojë ekonomia familjare e cila nuk është ekspozuar në rrezikun social, e konstatuar në bazë të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe dokumentacionit profesional nga punëtori i autorizuar nga Qendra për Punë Sociale.

Neni 34

Anëtarët e ekonomisë familjare, shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar, të cilët janë të papunësuar, evidentohen në qendrën kompetente për punësim, në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

Qendra për Punë Sociale e ngarkon shfrytëzuesin nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit për realizimin e ndihmës minimale të garantuar, të evidentohet si person i papunësuar në qendrën kompetente të punësimit.

Nëse shfrytëzuesi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk paraqitet në qendrën kompetente të punësimit në afatin e caktuar të paragrafit 2 të këtij neni, i njëjti me detyrë zyrtare menjëherë, kurse më së voni tri ditë nga dita e kalimit të afatit, e njofton qendrën kompetente për punë sociale.

Neni 35

Qendra për Punë Sociale me secilin anëtar të ekonomisë familjare, shfrytëzues i ndihmës minimale të garantuar, i cili është i papunësuar dhe i evidentuar në Qendrën kompetente të punësimit, përgatit plan individual.

Shfrytëzuesi i ndihmës minimale të garantuar është i detyruar që t'i realizojë detyrimet nga plani individual i paragrafit 1 të këtij neni për shkak të tejkallimit të pasigurisë materiale të ekonomisë familjare.

Neni 36

Qendra për Punë Sociale dhe Qendra për Punësim bashkëpunojnë në realizimin e planit individual për punësim të shfrytëzuesit, për shkak të pjesëmarrjes së tij në masat aktive për punësim, si dhe punësim.

Qendra për Punë Sociale e zbaton planin individual të nenit 35 paragrafi 1 të këtij ligji për secilin anëtar të aftë pune të ekonomisë familjare, shfrytëzues i ndihmës minimale të garantuar në pajtim me të dhënat nga plani individual për punësim, të marra nga Qendra për Punësim.

Neni 37

Mënyrën e bashkëpunimit për përfshirjen e shfrytëzuesit në masat aktive për punësim, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të planit individual të nenit 35 paragrafit 1 të këtij ligji, i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale (në tekstin e mëtejshëm: ministri).

Neni 38

Detyrimi nga neni 34 i këtij ligji nuk ka të bëjë për person:

- në shkollim të rregullt,
- i paaftë për punë, nga neni 29 paragrafi 5 i këtij ligji,
- gruaja gjatë shtatzënisë një muaj para lindjes dhe një nga prindërit që kujdeset për fëmijën deri në moshën nëntë mujore, përveç nëse vetë pajtohet të marrë pjesë në masat aktive dhe shërbimet,
- me mbushjen e 60 vjetëve moshë, përveç nëse vetë pajtohet të merr pjesë në masat aktive të punësimit,
- në marrëdhënie pune,
- kryerës të veprimtarisë bujqësore, blegtorale ose veprimtarisë tjetër dhe
- kryerës të veprimtarisë së zejtarisë, përkatësisht veprimtarisë profesionale.

Neni 39

Shfrytëzuesit e ndihmës së garantuar minimale mund të angazhohen me punë për kryerjen e punëve publike, në pajtim me rregullat nga sfera e punësimit dhe sigurimit në rast të papunësisë.

Personat të cilët nuk i nënshtrohen angazhimit me punë nga paragrafi 1 i këtij neni janë: person mbi moshën 60 vjeçare, gruaja gjatë kohës së shtatzënisë dhe njëri nga prindërit i cili kujdeset për fëmijën deri në moshën nëntëmuajshe të fëmijës, personi i paaftë për punë për shkak të moshës, pengesës ose sëmundjes, personi në marrëdhënie pune, nxënësi dhe studenti.

Nëse shfrytëzuesi i ndihmës së garantuar minimale nga paragrafi 1 i këtij neni pa arsye e refuzon angazhimin me punë, konsiderohet anëtar i ekonomisë familjare gjatë llogaritjes së të ardhurave të përgjithshme të ekonomisë familjare, ndërsa përjashtohet nga shfrytëzimi i së drejtës së ndihmës së garantuar minimale në 12 muajt e ardhshëm, llogaritur nga dita e miratimit të aktvendimit.

Neni 40

E drejta e ndihmës së garantuar minimale pushon, nëse:

- bartësi jep të dhëna të pavërteta ose të paplota për gjendjen materiale, familjare dhe pronësore të ekonomisë familjare gjatë parashtrimit të kërkesës,

- bartësi nuk e paraqet ndryshimin e gjendjes së numrit të ekonomisë familjare, gjendjes materiale dhe pronësore për veten dhe të gjithë anëtarët në ekonominë familjare, gjatë shfrytëzimit të së drejtës nga neni 30 paragrafi 2 të këtij ligji,

- shfrytëzuesi nuk paraqitet në qendrën kompetente të punësimit në afatin nga neni 34 paragrafi 2 të këtij ligji dhe rregullisht nuk i përmbush obligimet për evidentim në pajtim me rregullat për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë,

- shfrytëzuesi dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme refuzon t'i përmbush obligimet e planit individual për punësim për përfshirjen në programin për masat aktive të punësimit ose refuzon ndërmjetësimin për punësim në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë,

- marrëdhënia e punës i ka pushuar me marrëveshje, me kërkesën e tij ose me dorëheqjen nga punëdhënësi për shkak të shkeljes së obligimeve kontraktuese ose obligimeve tjera të marrëdhënies së punës,

- ekonomia familjare nuk është ekspozuar në rrezik social, të konstatuar në bazë të inspektimit të drejtpërdrejtë dhe dokumentacionit profesional nga punëtori i autorizuar nga qendra për punë sociale ose

- punëtorit të autorizuar nuk i lejohet të bëjë inspektim në shtëpinë për kontrollin e gjendjes materiale dhe gjendjes së numrit në ekonominë familjare, të konstatuar në bazë të dokumentacionit profesional.

Ekonomia familjare nga paragrafi 1 i këtij neni, përjashtohet nga shfrytëzimi i së drejtës së ndihmës së garantuar minimale në 12 muajt e ardhshëm.

Ekonomisë familjare së cilës do t'i pushojë e drejta e ndihmës së garantuar minimale nga paragrafi 1 i këtij neni, e drejta do të vazhdojë vetëm për personat anëtarë të ekonomisë familjare nga neni 29 paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji, nëse ai nuk është shkaktar i pushimit të së drejtës.

Neni 41

Mënyrën e realizimit të së drejtës së ndihmës së garantuar minimale, përcaktimin e gjendjes së të ardhurave, pronën dhe të drejtat pronësore të ekonomisë familjare, caktimin e bartësit të së drejtës, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm i përcakton ministri.

Neni 42

Ekonomia familjare e cila shfrytëzon ndihmë të garantuar minimale, realizon shtesë me para për shkak të mbulimit të një pjese të shpenzimeve për konsumim të energjentëve në ekonominë familjare, për muajt prej tetorit deri në mars.

Shuma mujore e lartësisë së shtesës nga paragrafi 1 i këtij neni arrin 1.000 denarë, të harmonizuar me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara në Entin Shtetëror të Statistikës, në janar për vitin rrjedhës.

Neni 43

Ekonomia familjare me fëmijë e cila shfrytëzon ndihmë të garantuar minimale, i realizon edhe të drejtat për mbrojtjen e fëmijëve, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

2. Kompensimi për shkak të pengesës

Neni 44

Kompensimi për shkak të pengesës sigurohet për nxitjen e përfshirjes sociale dhe mundësive të barabarta të personit i cili është:

- me pengesë të vështirë ose të thellë inleketuale,
- me pengesë më të rëndë trupore,
- person plotësisht i verbër dhe
- person plotësisht i shurdhër.

Kompensim për shkak të pengesës mund të realizojë personi me mbushjen e 26 viteve moshë, deri më së voni 65 vite moshë, ndërsa shfrytëzohet pa marrë parasysh moshën e pleqërisë të shfrytëzuesit.

Personi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund ta realizojë të drejtën e kompensimit për shkak të pengesës, nëse shfrytëzon pension invalidor civil ose pension invalidor ushtarak në pajtim me ligjin.

Personi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund ta shfrytëzojë të drejtën e kompensimit, për shkak të pengesës, nëse me aktvendim të qendrës për punë sociale më gjatë se 30 ditë është akomoduar në institucionin mbrojtjen sociale jashtëfamiljar, familje përkujdesëse, jetesë e organizuar me mbështetje ose në institucion shëndetësor ose institucion tjetër për periudhën derisa zgjat akomodimi.

Neni 45

Lartësia e kompensimit mujor për shkak të pengesës arrin:

-7.204 denarë për personin nga neni 44 paragrafi 1 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij ligji,

-4.117 denarë për personin nga neni 44 paragrafi 1 alineja 4 të këtij ligji.

Shuma e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin rrjedhës.

Neni 46

E drejta e kompensimit për shkak të pengesës në bazë të mendimit konziliar nga komisioni i shkallës së parë të përbërë nga tre mjekët specialistë nga institucioni shëndetësor terciar përkatës.

Në procedurën e ankesës kundër konstatimit dhe mendimit të komisionit të shkallës së parë për realizimin e kompensimit për pengesë, konstatim dhe mendim jep komisioni i shkallës së parë nga tre mjekët specialistë nga institucioni shëndetësor terciar përkatës, të cilët nuk e kanë miratuar mendimin të konsiliumit në shkallë të parë.

Mënyrën e realizimit të së drejtës së kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, dokumentacionin e nevojshëm, përbërjen e komisionit të shkallës së parë dhe

të komisionit të shkallës së dytë, formën dhe përmbajtjen e mendimit të konsiliumit, si dhe kompensimin për lëshimin e mendimit të konsiliumit, e përcakton ministri në pajtim me ministrin e Shëndetësisë.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, personat nga neni 44 paragrafi 1 të këtij ligji realizojnë të drejtën e kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, në bazë të konstatimit të përhershëm, vlerësimit dhe mendimit për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga organi profesional, në procedurën në pajtim me aktin e përgjithshëm nga neni 295 paragrafi 2 të këtij ligji dhe aktvendimin e qendrës për punë sociale.

Neni 47

Shfrytëzuesi i kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar mund me zgjedhjen personale të shfrytëzojë shërbim nga dhënësi i autorizuar i shërbimit në shtëpinë dhe në komunitetin.

3. Kompensimi për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër

Neni 48

Të drejtën e kompensimit për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër ka personi me mbushjen e 26 viteve moshë, me pengesë mesatare, të rëndë ose të thellë intelektuale, personi me pengesë të rëndë dhe më të rëndë trupore, personi plotësisht i verbër, si dhe personi me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, të cilit është e domosdoshme ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër për shkak që nuk mundet vetëm t'i kryejë aktivitetet themelore të jetës së përditshme nëse këtë të drejtë nuk mundet ta realizojë në bazë të rregullave tjera.

Neni 49

Lartësia e kompensimit për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër përcaktohet në varësi nga vëllimi i nevojës për ndihmën dhe kujdesin nga personi tjetër.

Nevojën e ndihmës dhe kujdesit nga personi tjetër në masë të madhe e ka personi me pengesë të rëndë ose të thellë intelektuale, personi me pengesë të rëndë dhe më të vështirë trupore, personi plotësisht i verbër, si dhe personi me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, për shkak që nuk mundet vetëm t'i përmbush aktivitetet themelore të jetës së përditshme, nuk mundet as me ndihmën e veglave ndihmëse ortopedike në mënyrë të pavarur të lëvizë në banesë ose jashtë banesës, në mënyrë të pavarur të ushqehet, vishet, ta mbajë higjienën personale, as t'i kryejë nevojat fiziologjike themelore.

Nevojën e ndihmës dhe kujdesit nga personi tjetër në vëllim më të vogël ka personi me pengesë mesatare intelektuale dhe personi i cili për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen shëndetësore nuk mundet pa ndihmën e personit tjetër plotësisht t'i përmbushë nevojat themelore të jetës.

Nevojën e ndihmës dhe kujdesit nga personi tjetër nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ka edhe personi i cili për shkak të ndryshimeve të përkohshme në gjendjen shëndetësore pa ndihmën e veglave ndihmëse ortopedike nuk mund t'i kryejë aktivitetet e jetës së përditshme.

Gjatë përcaktimit të vëllimit të nevojës për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër merret parasysh edhe Indeksi i Bartelit, i cili është pjesë përbërëse e mendimit të dhënë nga mjeku amë i parashtruesit të kërkesës.

Neni 50

Lartësia e kompensimit mujor për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër në masë më të madhe është 4.475 denarë, e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistikë, në janar për vitin rrjedhës.

Lartësia e kompensimit mujor për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër në masë më të vogël është 3.959 denarë, e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve për jetë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror për Statistikë, në janar për vitin rrjedhës.

Neni 51

Nevojën për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër me konstatim, vlerësim dhe mendim, e përcaktojnë komisione profesionale të formuara në institucione shëndetësore publike në përbërje me tre mjekë specialistë ose subspecialistë nga sferat në vijim: mjekësi interne, neurologji, psikiatri, mjekësi fizikale dhe rehabilitim, ortopedi ose oftalmologji.

Institucionet shëndetësore publike nga paragrafi 1 i këtij neni me akt i cakton ministri i Shëndetësisë në pajtim me ministrin.

Anëtarët e komisioneve profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni kanë të drejtë të kompensimit mujor për punën e tyre në muajin në të cilin komisioni ka vendosur për kërkesën e parashtruar, në lartësi prej së paku deri në dy të tretat e neto rrogës mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Ministria institucioneve shëndetësore publike nga paragrafi 1 i këtij neni ua paguan kompensimin nga paragrafi 3 i këtij neni.

Ministria institucioneve shëndetësore publike nga paragrafi 1 i këtij neni u paguan edhe kompensim të shpenzimeve materiale lidhur me punën e komisioneve profesionale shuma e së cilës mujore nuk mund ta tejkalojë shumën e një të dhjetës së neto rrogës mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Institucionet shëndetësore publike nga paragrafi 1 i këtij neni për punën e vet përpilojnë raporte mujore që i dorëzojnë në Ministrinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, në bazë të së cilave bëhet pagesa e kompensimeve nga paragrafët 3 dhe 5 të këtij neni.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni, gjatë përpilimit të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit e ka parasysh mendimin e dhënë nga mjeku amë nga neni 49 paragrafi 5 të këtij ligji.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, personi me moshën mbi 26 vjeçare me të meta intelektuale mesatare, të rënda dhe të thella dhe personi me të metë trupore më të rëndë dhe shumë të rëndë realizon të drejtën e kompensimit

për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër, në bazë të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit të përhershëm për llojin dhe shkallën e të metes të lëshuar nga organi profesional, në procedurë në pajtim me aktin e përgjithshëm nga neni 295 paragrafi 2 të këtij ligji dhe aktvendimin e qendrës për punë sociale

Neni 52

Ministri me aktvendim formon komision për përgatitjen e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit, në procedurën pas ankesës së parashtruar kundër aktvendimit të shkallës së parë me të cilën është vendosur për të drejtën e ndihmës dhe kurimit nga personi tjetër.

Neni 53

Shfrytëzuesi i të drejtës së kompensimit për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër, mundet sipas zgjedhjes personale të shfrytëzojë shërbim nga dhënësi i autorizuar i shërbimeve në shtëpinë.

Personi i cili me aktvendim të Qendrës për Punë Sociale më gjatë se 30 ditë është vendosur në institucion për mbrojtje sociale jashtë familjes, familje përkujdesëse, jetesë e organizuar me mbështetje, institucion shëndetësor ose institucion tjetër nuk mund të shfrytëzojë kompensim për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër për periudhën derisa zgjatë vendosja.

Neni 54

Mënyrën e realizimit të të drejtës së kompensimit për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm, formularin për mendimin e dhënë nga mjeku amë për nevojën nga ndihma dhe kurimi nga personi tjetër, mënyrën e punës së komisionit profesional, përbërjen dhe mënyrën e punës së komisionit të shkallës së dytë, mënyrën e mbajtjes së evidencës për konstatimet e dhëna dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për dhënie të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për nevojën nga ndihma dhe kurimi nga personi tjetër i përcakton ministri.

4. Kompensimi i rrogës për orarin e shkurtuar të punës

Neni 55

Të drejtën e kompensimit të rrogës për orar të shkurtuar të punës për shkak të kurimit të fëmijës me pengesa dhe me forma më të rënda të sëmundjeve kronike, e përcaktuar me Ligjin për marrëdhënie pune, prindi e realizon në qendrën për mbrojtje sociale, pa marrë parasysh moshën e fëmijës.

Lartësia e kompensimit të rrogës nga paragrafi 1 i këtij neni, arrin 50% nga neto rroga mesatare e prindit për vitin paraprak, por më së shumti deri në 50% të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Kontributet për sigurimin e detyrueshëm social për lartësinë e kompensimit nga paragrafi 2 i këtij neni, llogariten dhe paguhën në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social.

Neni 56

Mënyrën e realizimit të të drejtës së kompensimit të rrogës për orarin e shkurtuar të punës, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin për realizimin e të drejtës e përcakton ministri.

5. Shtesa për banim

Neni 57

E drejta e shtesës për banim sigurohet për persona të pasiguruar në mënyrë materiale dhe banesore.

Person i pasiguruar në mënyrë materiale në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni është:

- shfrytëzuesi i ndihmës së garantuar minimale dhe
- personi i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prind dhe pa përkujdesje prindërore, përkatësisht edhe pas ndërprerjes së kujdestarisë, ndërsa më së shumti deri në moshën 26 vjeçare.

Mënyrën e realizimit të së drejtës për shtesa për banim për personat nga paragrafi 2 alineja 1 të këtij neni, i përcakton këshilli i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit.

Formularin e kërkesës, dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e realizimit të të drejtës së shtesës për banim për personat nga paragrafi 2 alineja 2 të këtij neni i përcakton ministri.

Mjetet për realizimin e të drejtës për shtesë për banim për personat nga paragrafi 2 alineja 1 të këtij neni, sigurohen nga Buxheti i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit, ndërsa për personat nga paragrafi 2 alineja 2 të këtij neni, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet për realizimin e të drejtës për shtesa për banim mund të sigurohen edhe nëpërmjet donacioneve, kredive dhe të tjera.

6. Kompensimi i përhershëm

Neni 58

Të drejtë për kompensim të përhershëm ka kujdestari i cili është përkujdesur për një person në familjen e tij dhe prindi i cili është përkujdesur për fëmijën me pengesa.

Neni 59

Të drejtë për kompensim të përhershëm për kujdestar ka kujdestari i cili është kujdesur për një person në familjen e vet më së paku pesëmbëdhjetë vjet, pas mbushjes së moshës 62 vjeçare jetë për femër, përkatësisht 64 vjet jetë për mashkull, i cili është i papunësuar dhe nuk shfrytëzon të drejtë për pension sipas cilësdo bazë.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të realizohet nëse qendra për punë sociale e ka prishur marrëveshjen në mënyrë të njëanshme për vendosjen e personit në familje kujdestare.

Lartësia e kompensimit të përhershëm për kujdestarin arrin 8.000 denarë në muaj, e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës në janar për vitin rrjedhës.

Mënyrën e realizimit të të drejtës së kompensimit të përhershëm për kujdestar, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj të drejte e përcakton ministri.

Neni 60

Të drejtë për kompensim të përhershëm ka prindi i cili ka fëmijë me pengesa.

Të drejtën për kompensim të përhershëm e realizon prindi i cili është kujdesur për fëmijën deri në moshën 26 vjeçare, pa shfrytëzuar i njëjti shërbimin e mbrojtjes sociale jashtë familjare, i cili është i papunësuar dhe nuk e shfrytëzon të drejtën e pensionit, pas mbushjes së moshës 62 vjeçare jetë për femër, përkatësisht 64 vjet jetë për mashkull.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të realizohet nëse prindit i është marrë e drejta prindërore për fëmijën.

Lartësia e kompensimit të përhershëm nga paragrafi 1 i këtij neni arrin 8.000 denarë në muaj, e harmonizuar me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin paraprak të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin rrjedhës.

Mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës me para të prindit i cili ka fëmijë me të meta, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj të drejte e përcakton ministri.

7. Ndima e njëhershme me para

Neni 61

Ndihmë e njëhershme me para ose ndihmë në naturë i ndahet personit ose familjes e cila ndodhet në rrezik social, si dhe personit dhe familjes për shkak të pësimit të fatkeqësisë natyrore ose epidemisë dhe mjekimit më të gjatë në institucion shëndetësor të anëtarit të familjes.

Me ndihmë në naturë, sipas këtij ligji, nënkuptohet sigurimi i veshjes, ushqimit dhe mjeteve tjera për të cilat qendra për punë sociale do të konstatojë se janë të domosdoshme për ekzistencën minimale të qytetarit dhe familjes.

Me përjashtim, të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni në raste të fatkeqësisë, sëmundjes akute që kërkon mjekim spitalor dhe ngjashëm, mund ta shfrytëzojnë edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët nuk kanë vendbanim të përhershëm, si dhe të huajt me qëndrim të përkohshëm dhe hyrje të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me ligjin.

Në Buxhetin e Republikës sigurohen mjete për ndarjen e ndihmës së njëhershme në rast të rrezikimit të jashtëzakonshëm të popullsisë në përmasa më të mëdha.

Neni 62

Shuma e ndihmës së njëhershme me para mund të jetë deri në 30.000 denarë, edhe atë:

- për plotësimin e nevojave të personit ose familjes e cila ndodhet në gjendje të rrezikut social, ndërsa e cila mund të lë pasoja të përhershme, për shkak të pësimit të fatkeqësisë natyrore (tërmetit, vërshimit, zjarrit), epidemisë dhe vdekjes së anëtarit të familjes,

- personi i cili ka nevojë për ndërhyrje kirurgjike ose mjekim më të gjatë në institucion shëndetësor jashtë vendit dhe

- personi me strehim të pasiguruar shfrytëzues i ndihmës minimale me para dhe ai person i paaftë për punë, si ndihmë për sigurimin e strehimit të domosdoshëm.

Shuma e ndihmës së njëhershme me para mund të jetë deri në 15.000 denarë për nevojat e personit – viktimë të dhunës familjare për sigurimin e mbrojtjes urgjente dhe përkujdesit.

Shuma e ndihmës së njëhershme me para mund të jetë deri në 12.000 denarë për plotësimin e nevojave të personit ose familjes e cila ndodhet në gjendje të rrezikut social në rast të mjekimit më të gjatë në institucion shëndetësor, si dhe për personin – viktimë të dhunës familjare për realizimin e të drejtës së mbrojtjes shëndetësore dhe trajtimit mjekësor.

Shuma e ndihmës së njëhershme me para mund të jetë deri 4.500 denarë për plotësimin e nevojave të personit ose familjes e cila ndodhet në gjendje të rrezikut social që nuk lë pasoja të përhershme, ndërsa është i domosdoshëm sigurimi social dhe material i personit.

Lartësia e të drejtës për ndihmë të njëhershme me para nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, harmonizohet me rritjen e shpenzimeve për jetë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin rrjedhës.

Ndihma e njëhershme me para realizohet në qendrën për punë sociale.

Me përjashtim në raste urgjente dhe të paprolongueshme ministri mund të miratojë aktvendim për ndarjen e ndihmës së njëhershme me para.

Kundër aktvendimit të ministrit nga paragrafi 7 i këtij neni, mund t'i paraqitet ankesë Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

Neni 63

Personi i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, përkatësisht pas përfundimit të kujdestarisë, ndërsa më së shumti deri në moshën 26 vjeçare, ka të drejtë për ndihmë intervente të njëhershme me para në lartësi deri 180.000 denarë, për shkak të inkuadrimit në mjedisin social.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni, realizohet pas lëshimit të institucionit ose familjes përkujdesëse.

Qendra për punë sociale së bashku me personin nga paragrafi 1 i këtij neni, bën plan për integrimin e personit në mjedisin social i cili ka të bëjë me sigurimin e banimit, punësimin, arsimit të rregullt dhe nevojave tjera, në bazë të të cilit paguhen mjetet.

Plani nga paragrafi 3 i këtij neni, përpilohet tre muaj para lëshimit të institucionit për mbrojtje jashtë familjare, njësisë banesore për jetesë me mbështetje ose familje përkujdesëse.

Neni 64

Në kërkesën për realizimin e ndihmës së njëhershme me para, parashtruesi thekson për cilin qëllim i nevojitet ndihma dhe në afat prej 15 ditëve prej kur mjetet janë

shfrytëzuar, ndërsa më së voni tre muaj nga marrja e ndihmës, në qendrën për punë sociale dorëzon dëshmi se mjetet janë shfrytëzuar për qëllimin e theksuar në kërkesë, përveç për ndihmë të njëhershme me para në lartësi deri 4.500 denarë.

Nëse personi nuk dorëzon dëshmi në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, është i detyruar t'i kthejë mjetet e pranuar.

Neni 65

Mënyrën e realizimit të të drejtës së ndihmës së njëhershme me para, formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj të drejte e përcakton ministri.

Mbrojtja shëndetësore

Neni 66

Të drejtë për mbrojtje shëndetësore ka:

- shfrytëzuesi i ndihmës minimale të garantuar, i cili është person i paaftë për punë,
 - shfrytëzuesi i kompensimit për shkak të pengesës,
 - shfrytëzuesi i kompensimit për ndihmë dhe kurim nga personi tjetër,
 - personi me status të refugjatit të pranuar dhe personi nën mbrojtje subsidiare,
 - shfrytëzuesit e mbrojtjes jashtë familjare,
 - personi-viktimë e dhunës familjare për të cilin ndërmerret masa e mbrojtjes në pajtim me rregullat nga sfera për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna familjare dhe
 - personi-viktimë e tregtisë me njerëz.
- Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i këtij neni, realizojnë të drejtë për mbrojtje shëndetësore, vetëm nëse nuk mund të marrin sigurimin në bazë tjetër.

Kreu IV.

PARANDALIMI SOCIAL DHE SHËRBIME SOCIALE

1. Parandalimi social

Neni 67

Masat e parandalimit social realizohen për mbrojtje nga rreziqet sociale, parandalimin e shfaqjes së problemeve sociale dhe zbutjen e pasojave nga problemet e ndodhura sociale të qytetarëve.

Masat e parandalimit social përfshijnë:

- zbulimin e hershëm të qytetarëve në rrezik social, me vështirësi ose probleme sociale dhe sigurimin e qasjes të ndihma dhe mbështetja profesionale,
- këqyrje parandaluese të personat e prekur social, për konstatim të situatës sociale dhe parandalimit të shfaqjes së problemeve sociale,
- organizimin e ngjarjeve edukative, debateve, tribuneve, fushatave dhe projekteve për parandalimin e problemeve sociale,

-organizimin e aktiviteteve vullnetare për ndihmën e grupeve të prekura sociale në komunitetin lokal,

-nxitjen dhe ndihmën në vendosjen e grupeve për mbështetje dhe vetëndihmë të qytetarëve me probleme të ngjashme sociale dhe

-aktivitete tjera parandaluese për mbrojtjen nga rreziqet sociale dhe parandalimin e shfaqjes së problemeve sociale.

Neni 68

Masat e parandalimit social realizohen në bashkëpunim ndërmjet institucioneve për mbrojtje sociale, institucioneve parashkolllore, arsimore, shëndetësore, stacioneve policore, njërive të vetëqeverisjes lokale dhe organeve tjera shtetërore, personave juridikë dhe fizikë dhe shoqatave.

Institucioni për mbrojtje sociale, masat nga paragrafi 1 i këtij neni i realizon në pajtim me programin për punën e institucionit.

Neni 69

Masat e parandalimit social, përcaktohen në programin vjetor për realizimin e mbrojtjes sociale nga neni 9 alineja 2 të këtij ligji dhe programin vjetor për mbrojtje sociale nga neni 11 alineja 7 të këtij ligji.

2. Shërbime sociale

Neni 70

Shërbime sociale të cilat sigurohen në pajtim me këtë ligj, janë:

- 1.shërbime të informimit dhe udhëzimit;
- 2.shërbime të ndihmës dhe mbështetjes profesionale;
- 3.shërbime të këshillimit;
- 4.shërbime në shtëpinë;
- 5.shërbime në komunitetin dhe
- 6.shërbime për mbrojtje jashtë familjare.

2.1.Shërbime të informimit dhe udhëzimit

Neni 71

Shërbimet e informimit dhe udhëzimit përfshijnë informimin e qytetarëve për të drejtat e mbrojtjes sociale dhe shërbimet e disponueshme sociale, vlerësimin parimor dhe udhëzimin të institucioneve tjera, me qëllim të realizimit të qasjes së papenguar të drejtat dhe shërbimet.

2.2. Shërbime të ndihmës dhe mbështetjes profesionale

Neni 72

Shërbimet e ndihmës dhe mbështetjes profesionale të individit dhe familjes përfshijnë ndihmë dhe mbështetje për tejkallim të problemeve individuale dhe familjare përmes vlerësimit, planifikimit, ndërhyrjeve për mbrojtje dhe evaluim, si dhe ndjekje të gjendjes pas përfundimit të ndërhyrjeve, me qëllim përforcimin e shfrytëzuesve, promovimit të zhvillimit të tyre të pandërprerë, sigurimin dhe ruajtjen e gjendjes së mirë dhe pavarësisë dhe aftësim të tyre afatgjatë për tejkallim të mëvetësishëm të problemeve sociale.

2.3. Shërbime të këshillimit

Neni 73

Shërbimet e këshillimit përfshijnë punë këshillëdhënëse, përkatësisht punë këshillimore, me qëllim parandalimin, zbutjen dhe tejkalimin e pasojave nga problemet e krijuara sociale të individit dhe familjes, si vijon:

- përgatitja për martesë, jetë në familje, prindëri, planifikim të familjes, këshillim martesor/partner për partnerë me marrëdhënie të prishura,
- këshillim gjatë shkurorëzimit të martesës,
- mediacion familjar për familje me marrëdhënie të prishura familjare,
- mbështetje psiko-sociale për viktime të dhunës familjare,
- trajtim psiko-sociale të kryerësve të dhunës familjar dhe
- lloje tjera të specializuara të këshillimit.

2.4. Shërbime në shtëpi

Neni 74

Shërbime në shtëpi me shërbime për sigurim të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi të personit me kapacitet përkohësisht ose përgjithmonë të zvogëluar funksional, me qëllim mundësimin e personit për të vazhduar të jetojë në shtëpinë personale dhe parandalim të nevojës për mbrojtje jashtëfamiljare.

Shërbime në shtëpinë nga paragrafi 1 i këtij neni janë:

1. ndihmë dhe kurim në shtëpi dhe
2. asistencë personale.

Neni 75

Me shërbimin ndihmë dhe kurim në shtëpi, sigurohet ndihmë në kryerjen e aktiviteteve themelore dhe instrumentale nga jeta e përditshme deri në 80 orë në muaj, për persona me kapacitet të zvogëluar funksional që nuk mund të kujdesen vetë për vete, me qëllim që të aftësohet shfrytëzuesi për vetë-ndihmë, përkatësisht ta kthejë, përvetësojë ose ruajë aftësinë vetë që të kujdeset për vete, që të vazhdojë të jetojë në shtëpinë e tij dhe të jetojë jetë të pavarur në bashkësi.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: persona me pengesë më të rëndë, përkatësisht të kombinuar me shkallë më të lartë, persona plotësisht të verbër, pleq dhe persona të cilëve u nevojitet ndihmë dhe kujdes në shtëpi.

Neni 76

Shërbimi asistencë personale përfshin ndihmë dhe mbështetje individuale për persona nga 18 deri 65 vjet moshë, me kapacitet të zvogëluar funksional, me qëllim të mundësimin të jetesës së pavarur dhe të mëvetësishme, pjesëmarrjes aktive dhe të barabartë në bashkësi, si dhe kryerje të aktiviteteve të përditshme, të cilat persona pa pengesë zakonisht i kryejnë pa mbështetje.

Asistenca personale përfshin: ndihmë dhe mbështetje në kryerjen e aktiviteteve themelore dhe instrumentale nga jeta e përditshme, ndihmë dhe mbështetje të vendit të

punës, institucionet arsimore, qendrat për rehabilitim, ndihmë dhe mbështetje në bashkësin dhe aktivitete tjera me interes për personin, deri në 80 orë në muaj.

Shfrytëzuesit e shërbimeve janë persona me pengesë të rëndë dhe më të rëndë trupore dhe tërësisht persona të verbër.

Neni 77

Shërbimi ndihmë dhe kurimi në shtëpinë dhe asistencë personale sigurohet për person që nuk ka lidhur marrëveshje për mbështetje financiare gjatë gjithë jetës, përkatësisht ka ngritur procedurë për prishje të marrëveshjes së lidhur për mbështetje financiare gjatë gjithë jetës.

Shërbimi ndihmë dhe kujdes në shtëpi, përveç kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, i sigurohet personit të cilit nuk mund t'ia sigurojë ndihmën bashkëshorti, prindërit ose fëmijët, për shkak të marrëdhënies së themeluar të punës, gjendjes së çrregulluar shëndetësore dhe pleqërisë.

Neni 78

Shfrytëzuesi i shërbimit ndihmë dhe kurim në shtëpi që realizohet me shpenzime të kompensuar nga qendra për punë sociale, njëkohësisht nuk mund të shfrytëzojë shërbim asistencë personale.

2.5. Shërbime në bashkësi

Neni 79

Shërbimet në bashkësi përfshijnë shërbime të qëndrimit ditor, të përkohshëm, risocializim, rehabilitim, riintegrim, të shfrytëzuesve, zëvendësim të kujdesit familjar dhe shtëpi në gjysmë të rrugës, për shkak të parandalimit, përkujdesjes dhe mbrojtjes, e me qëllim të mundësimin të shfrytëzuesit të vazhdojë të jetojë në shtëpinë e tij, përkatësisht bashkësinë dhe parandalimit të nevojës për mbrojtje jashtëfamiljare.

Shërbime të qëndrimit ditor

Neni 80

Shërbimi për qëndrim ditor përfshin përkujdesje ditore, aktivitete individuale për përvetësim të shkathtësive jetësore dhe të punës, aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, edukim, mbështetje sociale të personave dhe familjeve të tyre dhe aktiviteteve tjera të ngjashme.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmijë në rrezik, persona me pengesa, persona të marginalizuar, pleq dhe persona tjera me probleme sociale specifike.

Neni 81

Shërbimi për rehabilitim dhe riintegrim të personave që ballafaqohen me probleme sociale dhe/ose shëndetësore sigurohet përmes mbështetjes psiko-sociale, punës terapeutike, terapisë së punës dhe okupacionit, mbështetje për përvetësim të shkathtësive të punës dhe shkathtësive për punësim, riintegrim dhe jetë të mëvetësishme.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmijë në rrezik, persona me pengesa, persona të marginalizuara me probleme sociale specifike dhe probleme shëndetësore.

Neni 82

Shërbimi për risocializim sigurohet përmes punës këshillëdhënëse, individuale, familjare dhe terapisë në grupe, mbështetjes arsimore, shoqërimin, edukimeve për zhvillim të shkathtësive, sportit, rekreacionit, krijimtarisë, mbështetjes për përvetësim të shkathtësive të punës dhe shkathtësive për punësim dhe shërbimeve tjera të resocializimit, varësisht nga nevoja e shfrytëzuesve.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij neni për fëmijë në rrezik dhe fëmijë në konflikt me ligjin sigurohet në qendrën për fëmijë, në pajtim me Ligjin për drejtësi për fëmijë.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij neni, për persona të moshuar pas ruajtjes së dënimit me burg dhe persona tjerë me problem sociale specifike në nevojën për risocializim sigurohet në qendrën për risocializim.

Shërbimet e qëndrimit të përkohshëm

Neni 83

Shërbimi për qëndrim të përkohshëm siguron mbrojtje dhe ndihmë profesionale të personave që gjenden në gjendje krize për tejkallim të gjendjes dhe integritet të tyre social.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmijë i cili do të haset pa kujdes prindëror ose duke u endur, fëmijë viktimë e keqpërdorimit, viktimë e dhunës familjare dhe dhunës së bazuar gjinore, viktimë e trafikimit me njerëz, të pastrehë.

Shërbimi sigurohet në kohëzgjatje deri tre muaj, me mundësi për vazhdim edhe tre muaj, e në raste ekskluzive kur gjendja nuk është tejkalluar deri një vit.

Neni 84

Shërbimi për zëvendësim të kujdesit familjar siguron përkujdesje afatshkurtër të anëtarëve të varur nga familja për shkak të zëvendësimit, pushimit dhe përmbushjes së nevojave personale dhe profesionale të anëtarëve të familjes që kujdesen për to.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të sigurohet edhe në shtëpinë e shfrytëzuesit.

Shfrytëzuesi i shërbimit është anëtar i familjes që kujdeset për plak, person me pengesa dhe person tjetër të sëmurë dhe të plogësht, i cili nuk mund t'i kryejë në mënyrë të pavarur aktivitetet esenciale dhe instrumentale nga jeta e përditshme.

Shërbimi për zëvendësim të kujdesit familjar që realizohet me shpenzime të kompensuara nga Qendra për punë sociale sigurohet në kohëzgjatje deri në 15 ditë në një vit kalendarik.

Neni 85

Shtëpia në gjysmë të rrugës siguron ndihmë, mbështetje dhe përgatitje për jetesë të mëvetësishme të personave të cilët paraprakisht kanë qenë nën mbrojtjen

jashtëfamiljare, nuk kanë shtëpi të tyre ose kushte për jetë në shtëpinë e tyre, për shkak të riintegritet të tyre në shoqërinë.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet gjatë vendosjes ose menjëherë pas ndërprerjes së vendosjes.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror, fëmijë pas braktisjes së institucionit edukativ për risocializim, persona të moshuar pas vuajtjes së dënimit me burg, person me pengesë, të varur nga alkooli dhe droga pas trajtimit të realizuar për mjekim dhe persona tjera me problem sociale specifike që kanë nevojë për përgatitje për jetë të mëvetësishme.

2.6. Shërbime të mbrojtjes jashtëfamiljare

Neni 86

Me shërbime të mbrojtjes jashtëfamiljare sigurohet bazë për mbrojtje e cila përfshin: vendosja, ndihma dhe mbështetja nga persona profesionalë, përkujdesja, ushqimi, veshja, mbrojtja shëndetësore, dhe shërbime tjera varësisht nga lloji i shfrytëzuesve, që nuk kanë kushte për jetesë në familjen ose për arsye tjera u nevojitet mbrojtje jashtëfamiljare.

Shërbime të mbrojtjes jashtëfamiljare janë:

1. jetesa me mbështetje,
2. përkujdesja në familje tjetër dhe
3. vendosja në institucion.

Jetesa me mbështetje

Neni 87

Jetesa me mbështetje sigurohet në njësi të veçantë banesore me ndihmë nga persona profesionalë ose persona tjerë në realizimin e aktiviteteve në jetën e përditshme.

Ndihmën dhe mbështetjen nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jetë përkohësisht, ndihmë dhe mbështetje ditore ose 24 orë, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesit.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: persona me pengesë dhe fëmijë pa prindër ose kujdes prindëror mbi moshën 14 vjeçare, e më së voni deri në përfundimin e arsimit të mesëm, për shkak të aftësisht për jetë të mëvetësishme dhe integritet në shoqëri.

Në njësinë banesore për jetesë me mbështetje mund të akomodohen më së shumti deri në pesë persona, përkatësisht shtatë fëmijë pa prindër ose kujdes prindëror.

Përkujdesja në familje

Neni 88

Përkujdesja në familjen përfshin mbrojtje themelore dhe kujdes për fëmijë dhe persona të mëshuara që nuk kanë familje të tyre ose nuk kanë kushte për jetë në familjen pronësore.

Përkujdesja nga paragrafi 1 i këtij neni mund të sigurohet si përkujdesje, të specializuar, të përkohshëm, intervenues ose prindëror.

Neni 89

Përkujdesja e përgjithshme është shërbim përmes personalitetit, edukimit, arsimit, zhvillimit, gjendjes shëndetësore, varësisht nga nevojat e përditshme të personit të vendosur.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: persona të vjetër, fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror, persona me pengesë.

Neni 90

Përkujdesja e specializuar është shërbim përmes të cilit personave të vendosur u sigurohet përkujdesje e përgjithshme dhe mbështetja deri në tejkalimin e problemeve sociale, ndërsa sigurohet nga ana e përkujdesësve që kanë kaluar trajnim të specializuar.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmija viktimë e dhunës familjare, fëmija në konflikt, fëmija ose personi me pengesë.

Neni 91

Familja përkujdesëse e përkohshme siguron përkujdesje të fëmijës ose personit të moshuar në familjen përkujdesës, si dhe për fëmijë ose person të moshuar me pengesë që jeton me prind/kujdestar për shkak të pushimit, terapisë, mjekimit dhe përfundimit të obligimeve shtëpiake, familjare dhe profesionale të përkujdesësit, përkatësisht prindit/kujdestarit.

Pas ndërprerjes së nevojës nga përkujdesja e përkohshme, familja përkujdesëse, përkatësisht prindi/kujdestari, e vazhdon kujdesin për fëmijën ose personin.

Neni 92

Përkujdesja intervenuese është shërbim i përkujdesjes afatshkurtër në familjen e personave për të cilat është e nevojshme mbrojtje urgjente, deri në gjetjen e formave përkatëse të mbrojtjes, ndërsa më së voni deri 30 ditë.

Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmijë pa prind dhe kujdes prindëror, fëmijë nga familjet konfliktoze, viktimat të dhunës, viktimat të trafikimit me njerëz dhe persona tjerë problem social i të cilave imponon përkujdesje dhe mbrojtje urgjente.

Neni 93

Përkujdesja prindërore është shërbim për përkujdesje të fëmijës pa prind dhe pa kujdes prindëror, në familje të gjyshes, gjyshit, vëllait, motrës, dajës, mixhës ose tezes së tij.

Vendosja në institucion

Neni 94

Vendosja në institucionin përfshin mbrojtje themelore e cila siguron: përkujdesje, ndihmë dhe mbështetje nga personat profesionalë, ushqimi, veshja dhe sigurimi i mbrojtjes shëndetësore, varësisht nga nevojat e përcaktuara të shfrytëzuesit, i cili nuk ka kushte për jetesë në familjen e vet ose për shkaqe tjera i nevojitet mbrojtje jashtëfamiljare.

Neni 95

Shërbimi për vendosje në institucionin për fëmijë, persona të moshuar, persona me pengesa dhe azilkërkuesit krahas mbrojtjes themelore nga neni 94 të këtij ligji, siguron qasje në arsimit, përvetësim të shkathtësive jetësore, aftësim pune dhe rehabilitim profesional, aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve.

Neni 96

Shërbimi për vendosjen e fëmijëve në konflikt me ligjin në moshë nga 14 deri 18 vjet me masë të shqiptuar dërgim në institucion edukativ, në pajtim me rregullat nga sfera për ekzekutim të sanksioneve dhe dërgim në institucionin adekuat në pajtim me ligjin, përveç mbrojtjes themelore nga neni 94 i këtij ligji, përfshin edhe risocializim, riintegrim, edukim, qasje në arsim dhe mbështetje arsimore, kalim i organizuar i kohës së lirë dhe shërbime tjera të risocializimit.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij neni, organizohet në institucionin edukativ për fëmijë, në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve.

Neni 97

Shërbimi për vendosje të plakut të plogësht, personit me sëmundje kronike, personit me sëmundje terminale dhe personit tjetër në përdorimin e ndihmës dhe kujdesit të vazhdueshëm, përveç mbrojtjes themelore nga neni 94 i këtij ligji, përfshin ndihmë të specializuar profesionale dhe mbështetje sociale të familjes së tij.

Neni 98

Shërbimi për vendosje të personave me pengesë, personave që kanë problem me varësinë dhe personat tjerë të marginalizuar, që kanë nevojë për realizim të trajtimit dhe rehabilitimit, përveç mbrojtjes themelore nga neni 94 i këtij ligji, u sigurohet, trajtim dhe rehabilitim, terapi pune-profesionale për përvetësim të shkathtësive të punës dhe shkathtësive për punësim, riintegrim dhe jetesë e mëvetësishme, varësisht nga nevoja e shfrytëzuesit.

Neni 99

Shërbimi për vendosje të azilkërkuesve siguron mbrojtje themelore nga neni 94 i këtij ligji, në pajtim me minimumin e standardeve për pranimin e azilkërkuesve, të përcaktuara me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 100

Shërbimi për vendosje të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror, prindër të mitur me fëmijë, grua e vetme e papunësuar shtatzëne një muaj para lindjes dhe prind i vetëm deri në moshë tremuajsh e fëmijës, pleq, persona me pengesa në shtëpi në grupe, siguron mbrojtje themelore nga neni 94 i këtij ligji, për më së shumti 10 persona.

Neni 101

Vendosja intervenuese siguron mbrojtje në gjendje krize, e më së gjati deri 30 ditë.

Neni 102

Vendosja e përkohshme sigurohet për fëmijë, për të cilin në momentin kur ka lindur nevoja nuk mund t'i sigurohet vendosje në familje përkujdesëse.

Vendosja e përkohshme mund të zgjasë në sigurimin e vendosjes në familje përkujdesëse, formë tjetër të mbrojtjes ose kthimit në familjen e tij, e më së gjati deri gjashtë muaj.

Në rast kur fëmijës i nevojitet trajtim profesional ose shërbim shëndetësor, vendosja nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të zgjasë deri në një vit.

Neni 103

Qendra e punëve sociale mund të vendosë fëmijë në konvikt të nxënësve ose në institucion tjetër, nëse vlerëson se kjo është në interes më të mirë të fëmijës për ta vazhduar arsimin e detyrueshëm për:

- fëmijë pa prindër dhe fëmijë pa kujdes prindëror, deri në aftësimin për jetë dhe punë të mëvetësishme, e më së voni deri në përfundimin e arsimit të mesëm, nëse nuk ekzistojnë mundësi që përkujdesja dhe edukimi të sigurohet në mënyrë tjetër dhe

- fëmijë në rrezik, fëmijë nga ekonomia familjare që shfrytëzojnë ndihmë të garantuar minimale dhe fëmijë viktimë e dhunës familjare.

Neni 104

Dhënësi i shërbimit mund të japë edhe shërbime tjera të ngjashme të integruara, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesit për përmbushje të aktiviteteve instrumentale nga jeta e përditshme.

Neni 105

Personi mund të shfrytëzojë shërbim social, nëse është i zhvilluar dhe i arritshëm.

Neni 106

Mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normativat dhe standardet për dhënie të shërbimeve sociale, i përcakton ministri.

Neni 107

Shfrytëzuesit i cili për shkak të gjendjes specifike sociale dhe shëndetësore ka nevojë për vendosje dhe për kujdes të vazhdueshëm shëndetësor mund t'i sigurohet shërbim shëndetësor-social.

Neni 108

Varësisht nga nevojat e shfrytëzuesit, shërbimet nga mbrojtja sociale mund të jepen njëkohësisht edhe të kombinuara me shërbimet që i japin institucionet arsimore, shëndetësore dhe institucionet tjera, për të cilat lidhet protokoll për bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet ministrive dhe/ose institucioneve.

Kreu V.USHTRUESIT E VEPRIMTARISË MBROJTJE
SOCIALE

Neni 109

Veprimtarinë e mbrojtjes sociale nën kushte dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj, e kryejnë:

1. Enti për veprimtari sociale,
2. qendra për mbështetje të familjeve përkujdesëse,
3. institucionet për mbrojtje sociale,
4. familjet përkujdesëse,
5. shoqatat dhe
6. personat fizikë.

1. Enti për veprimtari sociale

Neni 110

Enti për veprimtari sociale është institucion publik për avancimin e veprimtarisë sociale, të themeluar nga Qeveria, që realizon veprimtari në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i kryen punët në vijim:

-ndjek, hulumton dhe analizon dukuri dhe probleme sociale,

-proponon masa për avancim të veprimtarisë mbrojtje sociale,

-zbaton procedurë për licencim të punëtorëve profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale,

-realizon aktivitete për zhvillim profesional të punëtorëve profesionalë në institucione për mbrojtje sociale dhe dhënës tjerë të shërbimeve sociale,

-kryen vlerësim të nevojave nga edukimi i vazhdueshëm profesional i personave profesionale në institucionet për mbrojtje sociale edhe te dhënësit tjerë të shërbimeve sociale dhe miraton program për edukimin e vazhdueshëm profesional pas mendimit paraparak nga Komisioni për miratimin programeve për edukim të vazhdueshëm profesional,

-jep mendim profesional gjatë përgatitjes së programeve dhe strategjive për zhvillim të mbrojtjes sociale,

-përgatit standarde dhe procedura për punën e personave profesionale në institucionet për mbrojtje sociale dhe dhënësit tjetër të shërbimeve sociale,

-mban regjistër elektronik të programeve të miratuara për edukim profesional,

-miraton Kod etik për punëtorët profesionistë në veprimtarinë e mbrojtjes sociale,

-kryen mbikëqyrje të punës profesionale të institucioneve për mbrojtje sociale dhe dhënësit tjerë të autorizuar të shërbimeve sociale,

-realizon supervizion në punën profesionale në institucionet publike për mbrojtje sociale dhe personave profesionale në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë - qendra për punësim, e që punojnë në udhëheqjen e rastit dhe bashkëpunojnë me personat profesionalë në qendrat për punë sociale,

-realizon bashkëpunim profesional me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, institucionet dhe organizatat relevante dhe

-shpall publikime profesionale në veprimtarinë mbrojtje sociale.

2. Qendra për mbështetje të familjeve përkujdesëse

Neni 111

Qendra për mbështetje të familjeve përkujdesëse kryen promovim të shërbimit përkujdesje në familjen, përgatitje, vlerësim dhe trajnim të familjeve të ardhshme përkujdesëse sipas programit të miratuar nga Enti për Veprimtari Sociale, i ndjek dhe u jep mbështetje familjeve përkujdesëse ekzistuese.

Qendra për mbështetje të familjeve përkujdesëse bashkëpunon me qendrën kompetente për punë sociale dhe u dorëzon raport për punën e përkujdesësve, përkatësisht funksionimin e familjes përkujdesëse dhe propozon masa për përmirësimin e përkujdesjes së paku dy herë në vit.

Qendra për mbështetje të familjeve përkujdesëse themelohet si institucion për mbrojtje sociale ose si pjesë organizative e institucionit për mbrojtje jashtëfamiljare të fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror.

3. Institucionet për mbrojtje sociale

Neni 112

Institucionet për mbrojtje sociale janë:

1. Qendra për punë sociale;
2. Institucioni për mbrojtje sociale jashtëfamiljare;
3. Qendra për shërbime sociale.

3.1. Qendra për punë sociale

Neni 113

Qendra për punë sociale themelohet si institucion publik për mbrojtje sociale me autorizime publike për të kryer punë nga mbrojtja sociale.

Qendra për punë sociale mund të themelohet, nëse janë plotësuar kushtet për themelimin e institucionit për mbrojtje sociale nga neni 171 i këtij ligji dhe nëse i ka profilet arsimore vijuese: punëtor social, psikolog, pedagog dhe jurist.

Personat me profil arsimor nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të kenë licencë për punë në pajtim me këtë ligj.

Qendra për punë sociale mund të themelohet për territorin e një apo më shumë komunave.

Parimet e organizimit të brendshëm të qendrës për punës sociale i përcakton ministri.

Neni 114

Qendra për punë sociale i kryen punët vijuese:

-vendos për të drejtat nga mbrojtja sociale, të përcaktuara me këtë ligj,

-vendos për të drejtat e përcaktuara me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve,

-vendos për ndihmën me para personave me status të pranuar të refugjatit dhe nën mbrojtje subsidiare, të përcaktuar me Ligjin për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme,

-vendos për punët e përcaktuara me rregullat për marrëdhëniet familjare-juridike,

-vendos për të drejtën e përcaktuar me Ligjin për siguri sociale për personat e moshuar,

-vepron për punët nga veprimtaria e vet të përcaktuara me rregullat nga e drejta penale dhe

-kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 115

Gjatë realizimit të mbrojtjes sociale, si dhe të punës profesionale, qendra:

-kryen informim dhe dërgim të qytetarëve në lidhje me realizimin e qasjes të drejtat nga mbrojtja sociale,

-zbaton ndihmën profesionale dhe mbështetjen e individit dhe familjes për tejkalimin e problemeve sociale,

-realizon masa dhe aktivitete të parandalimit social dhe këshillimin e individit dhe familjes për shkak të parandalimit dhe lehtësimit të pasojave nga problemet sociale,

-kryen mbikëqyrje të drejtpërdrejtë për shkak të vërtetimit të gjendjes faktike në ekonominë familjare dhe nevojave të anëtarëve të ekonomisë familjare nga mbrojtja sociale,

-ndërmerr intervenime për ruajtjen e familjes në krizë nga dezintegrimi për shkak të parandalimit të ndarjes së fëmijëve nga familja biologjike dhe intervenime për krijimin e kushteve për kthimin e fëmijëve në familjen biologjike,

-siguron qasje të shërbimit në shtëpinë, bashkësinë dhe jashtë familjes,

-zhvillon dhe zbaton shërbime në shtëpinë dhe bashkësinë,

-përgatit plane dhe programe për mbrojtje sociale,

-mban evidencë dhe grumbullon dokumentacion për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes familjare-juridike dhe për format e zbatuara të mbrojtjes sociale,

-parashtron raport në Ministri në pajtim me ligj,

-aplikon dhe zbaton programe dhe akte tjera të përgjithshme nga sfera e mbrojtjes sociale, të miratuara dhe të financuara nga komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat e qytetit të Shkupit,

-merr pjesë në punën e këshillave për mbrojtje sociale të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe përgatitjen e planit social të komunës, qytetit të Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit,

-merr pjesë në punën e këshillit për mbrojtje sociale të rajonit të planit,

-nxit, organizon dhe koordinon aktivitete vullnetare të qytetarëve, shoqatave, fondacioneve dhe organizatave humanitare në zbatimin e programeve për mbrojtje sociale në rajonin e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave të qytetit të Shkupit dhe

-kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 116

Punëtorit profesionist nga Qendra për Punë Sociale, drejtori i lëshon legjitimacion zyrtar me të cilin e dëshmon cilësinë zyrtare, identitetin dhe autorizimin për ndërmarrjen e punëve në fushën e mbrojtjes sociale të përcaktuara me këtë dhe me ligj tjetër.

Qendra për Punë Sociale mban evidencë për lëshimin e legjitimacioneve të punonjëve profesionistë.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi 1 të këtij neni, mënyrën e lëshimit të tij dhe marrjen, përdorimin dhe mbajtjen e evidences së legjitimacioneve të lësuara i përcakton ministri.

3.2. Institucioni për mbrojtje sociale jashtë familjare

Neni 117

Llojet e institucioneve për mbrojtje sociale jashtë familjare janë:

1. shtëpi rezidenciale;
2. shtëpi për ndihmë dhe kujdes;
3. institucion edukativ;
4. institucion për trajtim dhe rehabilitim;
5. shtëpi në grupe dhe
6. institucion për pranimin e kërkuesve të azilit.

Institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni kryejnë punë të mbrojtjes sociale për ofrimin e shërbimeve sociale në përputhje me llojin, përshkrimin dhe shfrytëzuesit e shërbimit social për mbrojtjen jashtëfamiljare, të përcaktuar me këtë ligj.

Institucioni për trajtim dhe rehabilitim mund të organizohet si bashkësi terapeutike.

Në institucion mund të themelohet këshillimore, si një njësi organizative e veçantë.

Neni 118

Institucioni për mbrojtjen sociale jashtë familjare mund të ofrojë shërbime sociale shëndetësore në njësi të veçantë organizative, në pajtim me aktet e institucionit.

Puna e njësisë organizative nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohet me protokoll për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

3.3. Qendra për shërbime sociale

Neni 119

Qendra për Shërbime Sociale ofron shërbime të përditshme dhe / ose të përkohshme në shtëpinë e shfrytëzuesitshfrytëzues dhe në bashkësi.

Qendra për Shërbime Sociale që ofron shërbime ditore organizohet si:

- qendër për shërbime sociale në shtëpi,
- qendër për qëndrim ditor,
- qendër për rehabilitim,
- qendër për risocializim dhe
- këshillimore.

Qendra për Shërbime Sociale që ofron shërbime të përkohshme organizohet si:

- qendër për qëndrim të përkohshëm,
- qendër për zëvendësim të kujdesit familjar dhe
- shtëpi në gjysmë të rrugës.

Neni 120

Qendra për Shërbime Sociale mund të ofrojë shërbime të integruara në shtëpi dhe në bashkësi, në varësi të kategorisë së shfrytëzuesvshfrytëzues dhe standardeve dhe normativave për ofrimin e shërbimit nga neni 106 i këtij ligji.

Neni 121

Qendra për Shërbime Sociale kryen punë të mbrojtjes sociale për ofrimin e shërbimeve sociale në përputhje me llojin, përshkrimin dhe shfrytëzuesit e shërbimit social në shtëpi ose në bashkësi, të përcaktuara me këtë ligj.

4. Familja përkujdesëse

Neni 122

Përkujdesësi mund të jetë person që plotëson kriteret në vijim:

- të jetë i moshës madhore,
- të jetë i aftë për punë,
- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore,
- të ketë dallim në moshën midis përkujdestarit dhe personit të vendosur edhe atë së paku 18 dhe më së shumti 50 vjet,

- të mos i jetë marrë ose përkufizuar e drejta prindërore,

- të mos i jetë shqiptuar dënim për vepër penale me dënim me burg më shumë se gjashtë muaj,

- të ketë kushte materiale dhe banesore për kryerjen e këtij shërbimi dhe

- të ketë përfunduar trajnim për përkujdesës, të zbatuar nga qendra për përkrahjen e familjeve përkujdesëse.

Kriteret nga paragrafin 1, paragrafët 3 dhe 6 të këtij neni, vlejnë edhe për anëtarët e moshës madhore të familjes së përkujdesësit, që jetojnë në një familje të përbashkët.

Pavarësisht nga paragrafi 1, alineja 4 të këtij neni, dallimi i përcaktuar i moshës midis përkujdesësit dhe personit të vendosur nuk zbatohet nëse fëmija është vendosur në një familje përkujdesëse farefisnore ose nëse është në interes të fëmijës ose të personit të rritur.

Përmbushja e kriterëve nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohet nga Qendra për Punë Sociale, bazuar në vlerësimin e kryer nga qendra për mbështetje për familjet përkujdesëse.

Neni 123

Përkujdesësi ka të drejtën e kompensimit për shpenzimet e akomodimit të personit dhe kompensim për përkujdesje.

Në rast të përkujdesjes familjare nuk paguhet kompensim për përkujdesje për përkujdesësin i cili ka një detyrim ligjor për t'u kujdesur për fëmijën e vendosur.

Kontributi për sigurim pensional dhe invalidor dhe sigurim shëndetësor për përkujdesësit që kryejnë përkujdesjen e personit në familjen e tij si një veprimtari profesionale, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 124

Akomodimi i personit në një familje përkujdesëse bëhet në bazë të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet Qendrës për Punë Sociale dhe përkujdesësit.

Me marrëveshjen nga paragrafin 1 i këtij neni rregullohen në veçanti:

- mënyra dhe kushtet për vendosjen dhe ndërprerjen e strehimit të personit në familje,
- lloji dhe vëllimi i mbrojtjes sociale e cila i sigurojhet personit i cili akomodohet në familje përkujdesëse,
- lartësia e kompensimit për personin e akomoduar, e cila përfshin shpenzimet e akomodimit dhe kompensimin për përkujdesje,
- kohëzgjatja e marrëveshjes me mundësi për vazhdimin e saj,
- kushtet për prishjen e marrëveshjes,
- afati i skadimit për prishjen e marrëveshjes për përkujdesësin nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj,
- rastet gjatë të cilave pushon së vlefturi marrëveshja dhe
- të drejta, obligime dhe përgjegjësi të tjera lidhur përkujdesjen.

Qendra për Punë Sociale mund të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen edhe para skadimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje, sa herë që është në interesin më të mirë të fëmijës, respektivisht në interes të personit që akomodohet në familjen përkujdesëse.

Neni 125

Qendra për punë sociale i përcjell dhe i koordinon aktivitetet që lidhen me përkujdesjen e personit në familjen përkujdesëse.

Përkujdesësi është i detyruar të veprojë në drejtimet e dhëna nga Qendra për Punë Sociale për kujdesin e personit të vendosur dhe në kohë të informojë Qendrën për Punë Sociale për të gjitha ndryshimet dhe nevojat e personit të përkujdesur.

Neni 126

Qendra për punë sociale mund të akomodojë më së shumti pesë persona në një familje përkujdesëse, duke marrë parasysh kushtet dhe mundësitë për akomodimin e familjes.

Kriteret më të përafërta për zgjedhjen e familjes përkujdesëse, lloji dhe numri i shfrytëzuesve që mund të akomodohen në një familje kujdestare dhe standardet e ofrimit të shërbimeve sipas llojit të përkujdesjes i përcakton ministri.

5. Shoqata

Neni 127

Shoqata mund të ofrojë shërbime sociale në pajtim me këtë ligj, edhe atë:

- shërbime sociale në shtëpi,
- shërbimet sociale në bashkësi, përveç shërbimeve për ri-socializimin e fëmijëve në rrezik dhe ri-socializimin e fëmijëve në konflikt me ligjin,
- shërbimet e kujdesit jashtë familjar, përveç institucionit për pranimin e azilkërkuesve, institucionit arsimor dhe shtëpisë në grupe për fëmijët në rrezik,
- shërbime për informim dhe sugjerim,
- shërbime për ndihmë profesionale dhe mbështetje dhe
- shërbime për këshillim.

Shoqata, shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni i jep në përputhje me lejen e lëshuar për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale nga neni 163 i këtij ligji.

Neni 128

Shoqata, shërbimet e institucionit për akomodim, shtëpisë në grupe, institucionit për trajtim dhe rehabilitim i jep nëse themelojnë institucion, në përputhje me këtë ligj.

Shoqata, shërbimet nga neni 127, paragrafi 1, alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji, i jep pa themeluar institucion, nëpërmjet një njësie të veçantë organizative të shoqatës.

6. Personi fizik

Neni 129

Personi fizik mund të kryejë në mënyrë të pavarur punë për mbrojtje sociale si veprimtari profesionale, që kanë të bëjnë me ndihmën dhe kujdesin në shtëpi, përkujdesje në familje, asistencë personale dhe zëvendësim të kujdesit familjar, nëse plotëson kushtet në vijim:

- të mos i jetë hequr ose kufizuar aftësia afariste,
- të mos i jetë hequr kryerja e të të drejtës prindërore,
- të ketë aftësi shëndetësore për kryerjen e veprimtarisë,
- të ketë të paktën arsimin e mesëm,
- të mos i jetë shqiptuar dënim për vepër penale me dënim me burg mbi gjashtë muaj dhe
- të mos i jetë shqiptuar ndalim për kryerjen e detyrës, veprimtarisë dhe profesionit.

Neni 130

Kërkesa për kryerjen e punëve nga neni 129 i këtij ligji i paraqitet qendrës me kompetencë vendore për punë sociale.

Qendra për Punë Sociale, në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, përgatit mendim për përmbushjen e kushteve për kryerjen e pavarur të punëve të mbrojtjes sociale si aktivitet profesional dhe ia paraqet Komisionit për Licencim së bashku me kërkesën dhe dëshminë e paraqitur për përmbushjen e kushteve nga neni 129 i këtij ligji.

Ministri në bazë të mendimit të Komisionit për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale nga neni 166 paragrafi 1 i këtij ligji dhe dokumentacionit të paraqitur, parashtruesit të kërkesës me aktvendim i lëshon leje për kryerjen e punëve nga neni 129 i këtij ligji.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Në rastin e zgjerimit ose ndryshimit të veprimtarisë së punës së personit fizik nga neni 129 i këtij ligji, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 131

Personi fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen punë të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale, është i detyruar që për fillimin e punës të njoftojë qendrën kompetente për punë sociale në territorin e së cilës punon.

Personi nga paragrafi 1 i këtij neni në emër të tij nën të cilin punon i thekson të dhënat mbi emrin personal, adresën dhe llojin e veprimtarisë.

Neni 132

Ministria mban evidencë elektronike të personave fizikë të cilëve u është lëshuar leje për veprimtari të pavarur profesionale nga neni 130 paragrafi 3 i këtij ligji.

Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri.

Neni 133

Personi fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen punë për mbrojtje sociale si veprimtari profesionale, është i detyruar:

- t'ia ofrojë shërbimet shfrytëzuesit, në përputhje me aktvendimin e qendrës,

- në kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale nga neni 129 i këtij ligji, të zbatojnë metoda të punës profesionale, të respektojnë personalitetin e shfrytëzuesit, dinjitetin e tij dhe pacenueshmërinë e jetës së tij personale dhe familjare dhe ta ruaj sekretin zyrtar dhe profesional,

- të mbajë evidencë të shfrytëzuesve dhe të shërbimeve të dhëna dhe

- të dorëzojnë raport gjashtëmujor dhe vjetor për punën e tij në Qendrën për Punë Sociale.

Ministri i përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 1, alineja 3 të këtij neni.

Neni 134

Leja për kryerjen e pavarur të punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale shfuqizohet:

- me kërkesë të personit fizik,

- nëse pushon t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me ligj dhe

- me fuqi të ligjit.

Neni 135

Ministri, me kërkesë të personit fizik, miraton aktvendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për kryerjen e pavarur të punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale.

Kërkesa nga paragrafi 1 të këtij neni, dorëzohet në afat prej së paku dy muajsh para përfundimit të kryerjes së punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Neni 136

Leja e personit fizik për të kryer në mënyrë të pavarur punët e mbrojtjes sociale si një aktivitet profesional shfuqizohet me fuqi të ligjit, nëse:

- personi vdes,

- me aktvendimin e plotfuqishëm të gjykatës kompetente i merret ose kufizohet aftësia për punë,

- me aktvendimin të plotfuqishëm të gjykatës kompetente i është marrë ushtrimi i së drejtës prindërore,

- është dënuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm për vepër penale me dënim me burg mbi gjashtë muaj ose është i është shqiptuar sanksion për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

- e humb gjendjen e përgjithshme shëndetësore ose gjendjen e veçantë shëndetësore për kryerjen e veprimtarisë.

Ministri miraton aktvendim për shfuqizimin e lejes së personit fizik për kryerjen e pavarur të punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 2 të këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënieve të Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 137

Ministri miraton aktvendim për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për kryerjen e pavarur të punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale nëse:

- personi fizik në afatin e caktuar nuk i heq mangësitë e vërtetuara në kryerjen e punës, të përcaktuar nga mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës dhe mbikëqyrja mbi punën profesionale,

- personi fizik të cilit i është lëshuar leje për kryerjen e punëve të mbrojtjes sociale nuk i kryen ato personalisht ose nëse shfrytëzon punë për persona të tjerë në kundërshtim me lejen,

- pushon t'i përmbushë standardet dhe normat për ofrimin e shërbimit social dhe

- personi fizik, të cilit i është lëshuar licenca, pushon me punë pa e informuar paraprakisht Ministrinë dhe Qendrën për Punë Sociale, në afat prej tetë ditëve nga pushimi me punë.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Neni 138

Personi fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen punë të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale mund të ndalojë përkohësisht kryerjen e punëve për shkak të sëmundjes ose arsyeve të tjera të justifikuara.

Për ndërprerjen e përkohshme të kryerjes së punës, personi duhet menjëherë dhe më së voni se tri ditë pas paraqitjes së arsyes për ndërprerjen e kryerjes së punëve të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale ta njoftojë Ministrinë dhe Qendrën për Punë Sociale.

Neni 139

Personi fizik që kryen veprimtari të pavarur të mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale nga neni 129 i këtij ligji në përputhje me dispozitat e këtij ligji realizon të ardhura:

- nga arkëtimi i shërbimeve nga shfrytëzuesit,

- në bazë të marrëveshjes së lidhur dhe
- nga dhuratat, trashëgimia dhe legatet.

Kreu VI.

SIGURIMI I MJETEVE PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 140

Ministria publikon të paktën një herë në vit thirrje publike për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit, shoqatat dhe ofruesi privat i shërbimeve sociale nga rrjeti i ofruesve të autorizuar të shërbimeve sociale.

Ministria sipas nevojës publikon thirrje publike për shërbime sociale inovative dhe intervenuese.

1. Sigurimi i shërbimeve sociale nga komunat

Neni 141

Për sigurimin e mbrojtjes sociale nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: komuna) themelohen:

- këshilli komunal për mbrojtje sociale dhe
- këshilli për mbrojtje sociale në rajonin e planit.

Neni 142

Këshilli Komunal për Mbrojtje Sociale bazohet me vendim të këshillit të komunës, me propozim të kryetarit të komunës.

Këshilli Komunal për Mbrojtje Sociale përbëhet nga përfaqësues të administratës komunale, Qendrës për punë sociale, ofruesve të shërbimeve, shoqatave, bashkësive fetare dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë që kryejnë veprimtari të mbrojtjes sociale, institucioneve në fushën e arsimit, mbrojtjes shëndetësore, punësimit, policia dhe / ose prokuroria publike, nga rajoni i komunës.

Këshilli Komunal për Mbrojtje Sociale përgatit plan social për rajonin e komunës.

Plani social përmban hartën e problemeve sociale dhe grupeve të cenueshme në komunë, analizën e kapaciteteve dhe shërbimeve sociale në dispozicion, si dhe nevojat specifike për zhvillimin e shërbimeve sociale në komunë.

Kryetari i Komunës, në bazë të planit social, përgatit program vjetor për mbrojtje sociale, të cilin e miraton Këshilli Komunal.

Neni 143

Këshilli për Mbrojtje Sociale të rajonit e planit themelohet në çdo rajon të planit, për shkak të planifikimit dhe zhvillimit të rrjetit të shërbimeve sociale në rajon.

Këshilli për Mbrojtje Sociale të rajonit të planit përbëhet nga kryetari i komunës dhe drejtori i Qendrës për Punë Sociale, nga komuna në rajonin e planit, me mandat në kohëzgjatje prej katër vitesh.

Këshilli për Mbrojtje Sociale të rajonit të planit konstituohet me nismën e komunës me numrin e banorëve në rajon.

Anëtarët e Këshillit për Mbrojtje Sociale të rajonit të planit zgjedhin kryetar të Këshillit për Mbrojtje Sociale të rajonit të planit nga radhët e kryetarëve të komunave i cili është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Këshillit në bazë të rotacionit për periudhë njëvjeçare.

Këshilli për Mbrojtjen Sociale të rajonit të planit së paku një herë në vit Ministrisë i paraqet propozim për nevojën e zhvillimit të shërbimeve sociale në rajonin e planit, llojin dhe mënyrën e themelimit të shërbimeve.

Neni 144

Ministria siguron mjete për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni shpërndahen në mënyrë të barabartë për shërbimet sociale në rajonin e planit në të njëjtën shumë ose shumë më të lartë se mjetet e ndara për dedikim në vitin paraprak për rajonin e planit.

Neni 145

Ministria, e publikon thirrjen për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat nga neni 140 paragrafi 1 të këtij ligji, të paktën një herë në vit, në ueb faqen e Ministrisë.

Gjatë përcaktimit të llojit të shërbimit social për të cilin sigurohen mjetet përmes thirrjes publike, merret parasysh propozimi i paraqitur nga Këshilli për Mbrojtje Sociale të rajonit të planit.

Neni 146

Në thirrjen publike theksohet lloji i shërbimeve sociale për të cilat ndahen mjetet, lartësia e mjeteve që ndahen, dokumentet e nevojshme të cilat dorëzohen, afatet për kryerjen e procedurës pas thirrjes publike dhe periudha kohore në të cilën jepen shërbimet sociale për çdo planifikim rajon.

Neni 147

Gjatë shpërndarjes së mjeteve, përparësi do të kenë fletëparaqitjet të cilat do të realizohen përmes bashkëpunimit ndërkomunal, bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve të licencuara sociale, bashkëpunimit ndërresorcial dhe bashkëfinancimit të siguruar.

Neni 148

Kushtet më të afërta për ndarjen e mjeteve, formularin e shkallës së pikave, mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale nga komunat i përcakton ministri.

Neni 149

Komuna, respektivisht komunat nga rajoni i planit mund të ndajnë mjete personale për sigurimin e shërbimeve sociale për shoqërinë e licencuar ose ofrues tjetër të shërbimit social privat duke publikuar thirrje publike.

2. Sigurimi i shërbimeve sociale nga shoqatat dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale

Neni 150

Mjetet për ofrimin e shërbimeve sociale nga shoqatat dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale sigurohen në përputhje me programin nga nenin 9, pika 2 të këtij ligji, në lartësi e cila nuk mund të jetë më e vogël se lartësia e mjeteve për vitin paraprak.

Neni 151

Ministria, mjetet nga neni 150 i këtij ligji i ndan në bazë të konkursit publik, në të cilin theksohet lloji i shërbimeve sociale për të cilat ndahen mjetet, lartësia e mjeteve të cilat ndahen, dokumentet e nevojshme të cilat dorëzohen, afatet për kryerjen e procedurës pas konkursit publik dhe periudha kohore në të cilën do të ofrohen shërbimet sociale.

Konkursi publik publikohet në të paktën dy gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore, prej të cilave njëra prej gazetave që publikohet në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe në ueb faqen e Ministrisë.

Neni 152

Gjatë shpërndarjes së mjeteve përparësi do të kenë fletëparaqitjet të cilat do të realizohen nëpërmjet partneriteteve, bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkëfinancimit të siguruar.

Neni 153

Kushtet më të përafërta për dhënien e mjeteve, formularin e shkallës së pikëve, mënyrën e shpërndarjes së mjeteve për shoqatat dhe ofruesit tjerë privatë të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve sociale i përcakton Ministri i Financave.

3. Sigurimi i shërbimeve sociale inovative dhe intervenuese

Neni 154

Ministria siguron mjete për ofrimin e shërbimeve sociale inovative ose ndërhyrëse nga komunat, shoqatat ose ofruesit privatë të shërbimeve.

Neni 155

Mjetet nga neni 154 i këtij ligji shpërndahen pas shpalljes së konkursit publik ku theksohet lloji i shërbimeve sociale për të cilat ndahen mjetet, lartësia e mjeteve të cilat ndahen, dokumentet e nevojshme të cilat dorëzohen, afatet për zbatimin e procedurës pas konkursit publik dhe periudha kohore në të cilën do të ofrohen shërbimet sociale.

Neni 156

Kushtet më të përafërta, formularin për shkallën e pikëve, mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për sigurimin e shërbimeve sociale inovative ose intervenuese i përcakton ministri.

4. Procedura për ndarjen e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale

Neni 157

Procedura për shpalljen dhe zbatimin e thirrjes publike, konkretisht konkursin e kryen Komisioni për sigurimin e mjeteve për shërbime sociale nga komunat dhe ofruesit tjerë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për sigurimin e mjeteve).

Komisionin për sigurimin e mjeteve e formon ministri në përbërje prej pesë anëtarëve përfaqësues të Ministrisë me përvojë pune të mëparshme pesëvjeçare në fushën e mbrojtjes sociale.

Në përbërje të Komisionit për sigurimin e mjeteve duhet të ketë së paku nga një anëtar punëtor social, jurist, ekonomist dhe arkitekt dhe / ose inxhinier ndërtimi.

Mandati i anëtarëve të komisionit për sigurimin e mjeteve është katër vjet me mundësi për rizgjedhje. Komisioni për sigurimin e mjeteve zgjedh kryetar nga anëtarët e tij.

Komisioni për sigurimin e mjeteve miraton rregullore për punë.

Përfaqësuesit e komunave, shoqatave, ofruesit e shërbimeve sociale publike dhe private mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit për sigurimin e mjeteve.

Neni 158

Komisioni për sigurimin e mjeteve i shqyrton fletëparaqitjet pas thirrjes publike, respektivisht konkursit dhe në afat prej 30 ditëve pas mbarimit të afatit për fletëparaqitjen e fletëparaqitjeve, përgatit mendim për ministrin, në bazë të mënyrës së përcaktuar në aktin nga nenet 148, 153 dhe 156 të këtij ligji.

Në bazë të mendimit të Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni, ministri miraton aktvendim për shpërndarjen e mjeteve.

Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Neni 159

Ministri lidh marrëveshje administrative me komunën, përkatësisht me ofruesin tjetër të shërbimeve sociale që ka leje pune në përputhje me këtë ligj, në afat prej 15 ditëve nga përfundimi i aktvendimit nga neni 158 paragrafi 2 të këtij ligji, me të cilin rregullohen të drejtat e ndërsjella, detyrimet dhe përgjegjësitë në realizimin e mjeteve të ndara.

Marrëveshja administrative nga paragrafi 1 i këtij neni i rregullon:

- llojin e shërbimeve sociale, kushtet për ofrimin e shërbimit, kohëzgjatjen e marrëveshjes, financimin dhe mbikëqyrjen

- të drejtat dhe obligimet të cilat i ka ofruesi i shërbimit,

- të drejtat dhe obligimet të cilat i ndërmer Ministria,
- llojin dhe numrin e shfrytëzuesve dhe rajonin ku kryhet veprimtaria,

- kushtet për kryerje të vazhdueshme të veprimtarisë,
- kushtet për kryerje kualitative të veprimtarisë dhe
- kushte tjera të veçanta varësisht nga shërbimi social.

Marrëveshja administrative nga paragrafi 1 i këtij neni shfuqizohet pas skadimit të afatit për të cilin është lidhur dhe në rast të marrjes së lejes për punë.

Neni 160

Ministria kryen kontroll mbi komunën, respektivisht ofruerin tjetër të shërbimeve sociale në realizimin e punës së caktuar në fushën e mbrojtjes sociale për të cilën ka ndarë mjete.

Komuna, ose ofrueri tjetër i shërbimeve sociale e njofton Ministrinë për realizimin e punës në fushën e mbrojtjes sociale dhe shpenzimin e mjeteve të ndara më së voni deri më 31 mars për mjetet e realizuara nga viti paraprak.

Neni 161

Nëse përcaktohet se komuna, mjetet e marra për realizimin e punës nga sfera e mbrojtjes sociale i shpenzojnë në mënyrë të padedikuar ose punën e caktuar nga mbrojtja sociale nuk e kryejnë në pajtim me ftesën publike nga neni 145 të këtij ligji ose nuk ka filluar realizimi i punës së caktuar në afatin e paraparë, Ministria i ndërpret sigurimin e mëtejme të mjeteve të komunës, e prish marrëveshjen nga neni 159 të këtij ligji dhe ngre procedurë për kthim të mjeteve tashmë të ndara dhe kompensim të dëmit.

Nëse përcaktohet se shoqata mjetet e marra për realizimin e punës nga sfera e mbrojtjes sociale i shpenzon në mënyrë të padedikuar ose punën e caktuar nga mbrojtja sociale nuk e kryenë në pajtim me konkursin publik nga neni 151 dhe 155 të këtij ligji ose nuk ka filluar realizimi i punës së caktuar në afatin e paraparë, Ministria e ndërpret sigurimin e mëtejme të mjeteve të komunës, e prish marrëveshjen nga neni 159 të këtij ligji dhe ngre procedurë për kthim të tashmë mjeteve të ndara dhe kompensim të dëmi.

Kreu VII.**USHTRIMI I VEPRIMTARISË SË MBROJTJES SOCIALE**

Neni 162

Veprimtarinë në mbrojtjen sociale e kryejnë institucione për mbrojtje sociale dhe dhënës të tjerë të shërbimeve sociale edhe atë: shoqata, persona juridikë dhe fizikë të vendit të të huaj, me kushte të përcaktuara me këtë ligj.

1. Leja për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale

Neni 163

Ministria i jep leje për punë institucioneve për mbrojtje sociale dhe dhënësve të tjerë të shërbimeve sociale, për kryerje të punëve të mbrojtjes sociale, përveç themelimit të qendrës për punë sociale, institucion edukativ për fëmijë dhe institucion për azilkërkuar.

Institucioni për mbrojtje sociale, përkatësisht dhënës tjetër i shërbimeve sociale mund të fillojë me punë kur Ministria do të përcaktojë se janë plotësuar kushtet për fillim me punë dhe jep leje për punë në pajtim me ligj.

Neni 164

Leja për kryerje të punëve në mbrojtje sociale, i jepet dhënësit të shërbimeve sociale, i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë organizatë juridikisht e themeluar, e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- të ketë siguruar hapësirë, pajisje dhe kuadër profesional,

- të ketë plan për sigurim të mjeteve financiare dhe materiale,

- të punojë në mjedis të padiskriminuar dhe

- të ketë procedura të brendshme për evalvim të shërbimeve të dhëna dhe për vlerësim të kënaqësisë së shfrytëzuesve, në pajtim me normativat dhe standardet për dhënie të shërbimit.

Plotësimi i kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, dëshmohet me dorëzimin e dokumenteve të nevojshme, përshkrim të shërbimeve sociale dhe plotësimin e normativave dhe standardeve për dhënie të shërbimit social nga neni 106 i këtij ligji, si dhe këqyrje të drejtpërdrejtë të dhënësi i shërbimeve.

Neni 165

Dhënësi publik ose privat i shërbimeve sociale mund të japë shërbime sociale nëse posedon leje për punë.

Leja për punë për dhënie të shërbimit socialpërtërihet çdo pesë vjet.

Kur koha për dhënie të shërbimit është më e vogël se pesë vjet, leja për punë lëshohet për atë periudhë.

Leja për punë mund të hiqet ose kryerja e punëve nga mbrojtja sociale mund të kufizohet, nëse dhënësi i shërbimit pjesërisht ose plotësisht nuk i plotëson kushtet për ushtrimin e punëve nga mbrojtja sociale, të përcaktuara me këtë ligj.

Ministri me aktvendim vendos pas kërkesës për marrje të lejes, kufizimit dhe heqjes së lejes për punë, në bazë të mendimit paraprak të Komisionit për licencim të dhënësve të shërbimeve sociale.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 166

Ministri formon Komisionin për Licencim të Dhënësve të Shërbimeve Sociale në përbërje të nëntë anëtarëve, prej të cilëve pesë nga Ministria, dy nga Enti për Veprimtari Sociale me përvojë dhjetëvjeçare paraprake të punës në veprimtarinë mbrojtje sociale dhe dy anëtarë të jashtëm nga radhët e institucioneve të larta arsimore dhe institucione shkencore.

Në përbërje të Komisionit për Licencim të Dhënësve të Shërbimeve sociale duhet të ketë punëtor social, jurist dhe defektolog.

Mandati i anëtarëve të komisionit për licencim të dhënësve të shërbimeve sociale është katër vjet me mundësi për zgjedhje të sërishme.

Komisioni për Licencim i Dhënësve të Shërbimeve Sociale zgjedh kryetar nga radhët e anëtarëve-përfaqësues të Ministrisë.

Komisioni për Licencim të Dhënësve të Shërbimeve Sociale miraton rregullore për punë.

Anëtarët e Komisionit për Licencim të Dhënësve të Shërbimeve Sociale për punën në komision kanë të drejtë në kompensim vjetor në para në shumë prej më së shumti dy neto rroga mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, të cilin e cakton ministri me aktvendim.

Përfaqësues të dhënësve publikë dhe privatë të shërbimeve sociale, ndërsa sipas nevojës edhe persona të tjerë profesionalë, mund të marrin pjesë në takimet e Komisionit për licencim të dhënësve të shërbimeve sociale.

Neni 167

Ministri mban evidencë të dhënësve të licencuar të shërbimeve sociale sipas llojit të shërbimeve sociale për të cilat u është dhënë leje për punë e cila shpallet në ueb faqen e Ministrisë.

Kushtet dhe kriteret më të afërta, dokumentacionin e nevojshëm, formularin e kërkesës për marrje të leje për punë, mënyrën dhe procedurën për dhënie dhe heqje të lejes për punë dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës të dhënësve të licencuar të shërbimeve sociale e përcakton ministri.

Kreu VIII.

INSTITUCIONE PËR MBROJTJE SOCIALE

1. Themelimi dhe shuarja e institucioneve për mbrojtje sociale

Neni 168

Për realizmin e sistemit për mbrojtje sociale themelohen institucione publike dhe private për mbrojtje sociale.

Neni 169

Institucion publik për mbrojtje sociale themelon Qeveria në pajtim me nevojat e veprimtarisë për mbrojtje sociale.

Komuna mund të themelojë institucion publik në bazë të lejes për themelim në pajtim me ligj, përveç qendrës për punë sociale, institucion edukativ për fëmijë dhe institucion për pranim të azilkërkuësve.

Neni 170

Institucion privat për mbrojtje sociale mund të themelojë person juridik dhe fizik i vendit ose huaj, në bazë të lejes për themelim, në pajtim me ligj.

Person juridik dhe fizik i vendit ose huaj nuk mund të jetë themelues as bashkëthemelues i qendrës për punë sociale, institucion për pranim të azilkërkuësve, institucion edukativ, shtëpi në grup për fëmijë në rrezik, qendër për risocializim të fëmijëve në rrezik dhe qendër për risocializim të fëmijë në konflikt me ligjin.

Neni 171

Institucioni për mbrojtje sociale mund të themelohet dhe të fillojë me punë, nëse ka marrë leje për themelim dhe leje për punë.

Leja për themelim nga paragrafi 1 i këtij neni jepet në bazë të elaboratit të parashtruar për themelim të institucionit në të cilin caktohet lloji dhe vëllimi i mbrojtjes sociale, kushtet e sërishme, pajisja, numri i nevojshëm i kadrove profesional, vëllimi i mjeteve dhe mënyra e sigurimit të nivelit të qëndrueshëm të financimit të veprimtarisë për periudhë prej gjashtë muajsh, mbrojtja gjatë punës e të punësuarve dhe mbrojtja e shfrytëzuesve të shërbimit publik.

Kushtet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni kanë të bëjnë edhe me institucione publike dhe private për mbrojtje sociale.

Themeluesi i institucionit privat krahas plotësimit të kushteve nga paragrafi 2 i këtij neni, ndaj elaboratit dorëzon garanci financiare për ushtrim të vazhdueshëm të shërbimeve nga sfera e institucionit më së paku për periudhë prej gjashtë muaj dhe për kompensim të dëmit që mund t'u shkaktohet shfrytëzuesve të shërbimeve, nëse institucioni e ndërpret punën.

Kërkesa për themelim të institucionit me dokumentacionin nga paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni parashtrohet te Ministria.

Normativat dhe standardet për dhënie të shërbimit social në institucion për mbrojtje sociale në lidhje me hapësirën, mjetet, kuadra të caktuar sipas shkallës së kualifikimeve dhe profileve sipas llojit të shërbimit dhe numrit të shfrytëzuesve dhe dokumentacionit të nevojshëm i përcakton ministri.

Neni 172

Qeveria jep leje për themelim të qendrës për punë sociale dhe institucionit për mbrojtje sociale jashtë familjare, pas mendimit paraprak nga Ministria.

Neni 166

Ministria jep leje për themelim të qendrës për shërbime sociale në bashkësi.

Neni 174

Institucioni për mbrojtje sociale themelohet me akt për themelim, i miratuar nga themeluesi.

Në aktin për themelim të institucionit për mbrojtje sociale, përcaktohet:

1. titulli i themeluesit;
2. titulli i institucionit dhe selia e tij;
3. veprimtaria e institucionit për mbrojtje sociale;
4. mjetet për themelim dhe fillim me punë të institucionit për mbrojtje sociale dhe mënyra e sigurimit të mjeteve dhe garancia;
5. të drejta dhe detyrime të themeluesit në aspekt të ushtrimit të veprimtarisë, përkatësisht ushtrimit të punëve për të cilat themelohet institucioni;
6. përgjegjësitë e institucionit për detyrimet në qarkullimin juridik;

- 7.ushtruesi i detyrës drejtor;
- 8.afati për miratimin e statutit dhe
- 9.çështje të tjera.

Neni 175

Nëse institucionin e themelojnë dy ose më shumë themelues, ato lidhin marrëveshje për themelim të përbashkët të institucionit me të cilën i rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella si themelues të institucionit, në pajtim me ligj.

Neni 176

Institucioni për mbrojtje sociale mund të fillojë me punë pasi ministri me aktvendim përcakton se janë plotësuar kushtet për fillim me punë nga neni 171 paragrafi 6 të këtij ligji dhe do të lëshojë leje për punë.

Aktvendimi nga paragrafi 1 të këtij neni, miratohet pas mendimit paraprak të Komisionit për licencim të dhënës të shërbimeve sociale.

Komisioni nga paragrafi 2 të këtij neni, këqyrjen e drejtpërdrejtë e kryen me qëllim që të përcaktojë nëse janë plotësuar kushtet nga neni 171 paragrafi 6 të këtij ligji, në bazë të të cilit përpilon mendim.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni, mund të paraqitet ankesë të Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Neni 177

Institucioni për mbrojtje sociale e fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ministria mban regjistër të institucioneve për mbrojtje sociale.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit i përcakton ministri.

Neni 178

Institucioni publik për mbrojtje sociale dhe institucioni privat për mbrojtje sociale jashtë-familjare nuk mund ta zgjerojë ose ta ndryshojë veprimtarinë për të cilën është themeluar pa leje nga Qeveria.

Qendra për shërbime sociale në bashkësi nuk mund ta zgjerojë ose ta ndryshojë veprimtarinë për të cilën është themeluar pa leje nga Ministria.

Neni 179

Institucioni për mbrojtje sociale shuhet, nëse:

- me vendim të plotfuqishëm përcaktohet pavlefshmëria e regjistrimit të institucionit për mbrojtje sociale në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- është shqiptuar sanksion për ndalim për ushtrim të veprimtarisë për shkak të mosplotësimit të kushteve për ushtrim të veprimtarisë,

- është hequr leja për kryerje të punës nga mbrojtja sociale,

- themeluesi miraton akt për shuarje të institucionit për mbrojtje sociale, nëse ka pushuar nevoja, përkatësisht kushtet për ushtrim të veprimtarisë për të cilën institucioni

për mbrojtje sociale është themeluar, bashkohet me institucion tjetër për mbrojtje sociale ose ndahet në dy ose më shumë institucione ose

- janë plotësuar kushtet tjera për shuarje të institucionit për mbrojtje sociale të parapara me ligj ose akt për themelim.

Neni 180

Institucioni privat është i obliguar së paku gjashtë muaj para ndërprerjes së punës ta njoftojë Ministrinë, qendrën për punë sociale dhe shfrytëzuesit, përkatësisht përfaqësuesit e tyre ligjorë.

Neni 181

Qeveria, mund t'ia heqë lejen për themelim, nëse themeluesi themelon institucion për mbrojtje sociale për mbrojtje sociale jashtë familjare në kundërshtim me vendimin për leje nga neni 172 të këtij ligji dhe nëse përcaktohet se institucioni privat dhe institucioni publik, i themeluar nga komuna, më tej nuk i plotëson kushtet nga neni 171 paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji ose nuk i zbaton dispozitat të këtij ligji dhe aktet të tjera të miratuara në bazë të këtij ligji, në bazë të aktvendimit për heqje të lejes për kryerje të punës nga mbrojtja sociale.

Ministria, mund t'ia heq lejen për themelim, nëse themeluesi themelon institucion për mbrojtje sociale - qendër për shërbime sociale në bashkësi në kundërshtim me aktin për leje nga neni 173 të këtij ligji dhe nëse përcaktohet se më tej nuk i plotëson kushtet nga neni 171 paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji ose nuk i zbaton dispozitat të këtij ligji dhe aktet të tjera të miratuara në bazë të këtij ligji, në bazë të aktvendimit për heqje të lejes për kryerje të punës nga mbrojtja sociale.

Me ditën e miratimit të aktvendimit për heqje të lejes për kryerje të punëve nga mbrojtja sociale, institucioni privat dhe institucioni publik, i themeluar nga komuna, e ndërpret punën.

Në bazë të aktit për heqje të lejes, institucioni nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni shlyhet nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pasojat të cilat do të dalin nga heqja e lejes, do të bien në barrë të themeluesit.

2. Organizimi i institucioneve për mbrojtje sociale

Neni 182

Institucioni për mbrojtje sociale miraton statut me të cilin rregullohet organizimi i tij, menaxhimi dhe udhëheqja, aktet e përgjithshme dhe procedura për miratimin e tyre dhe punë të tjera me rëndësi për punën e institucionit për mbrojtje sociale.

Në institucionin për mbrojtje sociale për ushtrimin e veprimtarive të veçanta ose një pjese të veprimtarive ose për ushtrim të veprimtarisë në rajon të caktuar mund të themelohen njësi organizative me të drejta dhe detyrime të përcaktuara në statutin e institucionit për mbrojtje sociale dhe në korniza të veprimtarisë.

Me statutin e institucionit për mbrojtje sociale të njësisve organizative nga paragrafi 2 të këtij neni mund t'u përcaktohet autorizime të veçanta në qarkullimin juridik në

korniza të veprimtarisë, pa cilësinë e personit juridik, të cilët i kryejnë në emër dhe për llogari të institucionit për mbrojtje sociale.

Për statutin e institucionit publik të themeluar nga Qeveria pajtim jep ministri.

Për statutin e institucionit publik të themeluar nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe institucioneve private pëlqim jep themeluesi, pas mendimit të marrë paraprak nga Ministria.

Për statutin e institucionit privat, pajtim jep kryetari i komunës në rajonin e të cilës gjendet institucioni, pas mendimi të marrë paraprak nga Ministria.

3. Menaxhimi dhe udhëheqjame institucion për mbrojtje sociale

Organi i menaxhimit

Neni 183

Organ i menaxhimit në institucionin publik për mbrojtje sociale, është bordi drejtues.

Në institucionin publik për mbrojtje sociale jashtë-familjare bordi drejtues është i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar nga themeluesi prej të cilëve dy anëtarë janë nga radhët e punëtorëve profesionalë në institucion dhe një anëtar është nga radhët e shfrytëzuesve, përkatësisht përfaqësuesit/kujdestarët të tyre të propozuar nga Këshilli i shfrytëzuesve dhe dy anëtarë janë përfaqësues të themeluesit.

Në qendrën për punë sociale bordin drejtues e përbëjnë pesë anëtarë, prej të cilëve një anëtar i punësuar në administratën komunale i cili kryen punë nga mbrojtja sociale, i propozuar nga këshilli i komunës në rajonin e të cilit është selia e qendrës për punë sociale, një anëtar është punëtor profesionist nga qendra për punë sociale, një anëtar është nga radhët e shfrytëzuesve, përkatësisht përfaqësuesit/kujdestarët e tyre të propozuar nga Këshilli i shfrytëzuesve dhe dy anëtarë janë përfaqësues të themeluesit.

Në qendrën për shërbime sociale i themeluar si institucion bordin drejtues e përbëjnë tre anëtarë, prej të cilëve një anëtar është punëtor profesionist i punësuar në institucion, një anëtar është nga radhët e shfrytëzuesve, përkatësisht përfaqësues/kujdestar të tyre i propozuar nga Këshilli i shfrytëzuesve dhe një anëtar është përfaqësues i themeluesit.

Anëtarët e bordeve drejtuese në institucionet për mbrojtje sociale duhet të kenë arsim adekuat në pajtim me nenin 194 të këtij ligji dhe së paku dy vjet përvojë pune pas diplomimit.

Anëtarët e bordit drejtues zgjidhen me mandat në kohëzgjatje prej katër vjetësh.

Bordin drejtues e cakton dhe me punën e tij udhëheq kryetari i bordit drejtues, të cilin e zgjedhin anëtarët të bordit drejtues nga radhët e veta.

Bordi drejtues vendimet e veta i miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Në punën e bordit drejtues merr pjesë drejtori i institucionit për mbrojtje sociale, pa të drejtë të vendosjes.

Anëtarët e bordit drejtues kanë të drejtë në kompensim mujor në lartësi prej 1.000 denarë.

Neni 184

Bordi drejtues i institucionin publik për mbrojtje sociale:

- miraton statut,
- miraton akt për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës,
- miraton program vjetor për punë dhe e përcjell realizimin e saj,
- miraton raport për punë të institucionit publik,
- përcakton plan financiar dhe e miraton llogarinë vjetore,
- i propozon themeluesit ndryshim ose zgjerim të veprimtarisë,
- shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit dhe është i obliguar ta shpallë konkursin publik më së paku tre muaj para përfundimit të mandatit të drejtorit dhe
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin e institucionit për mbrojtje sociale.

Për aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të institucionit publik i themeluar nga Qeveria, pëlqim jep ministri, ndërsa në aktin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës të institucionit publik i themeluar nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit pëlqim jep kryetari i komunës.

Pas marrjes së pëlqimit nga paragrafi 2 i këtij neni, institucioni publik e dorëzon aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës për harmonizim dhe marrje të pajtimit të Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 185

Menaxhimin në institucionin privat për mbrojtje sociale e rregullon themeluesi, në pajtim me statutin e institucionit.

Organ i udhëheqjes

Neni 186

Me institucionin publik për mbrojtje sociale udhëheq drejtori.

Drejtor i institucionit publik për mbrojtje sociale zgjidhet personi, nëse:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka arsim të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit në varësi nga natyra e veprimtarisë së institucionit publik;
- 4) së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit;
- 5) posedon një nga certifikatat ndërkombëtarisht të pranuar si në vijim ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: - TOEFEL IBT më së paku 74 pikë, - IELLS (IELTS) - më së paku 6 pikë, -

ILLEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku B2 (B2) niveli, - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë, - BULLATAS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose - APTIS (APTIS) - më së paku niveli B2 (B2).

6) parashtron program të përgatitur për udhëheqje me institucionin.

Drejtorin e institucionit publik, të themeluar nga Qeveria, e zgjedh dhe shkarkon ministri.

Për zgjedhje të drejtorit shpallet konkurs publik, në më së paku dy gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej të cilave një nga gazetat e cila botohet në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% të qytetarëve të cilit flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 3 i këtij neni kandidati i cili nuk është i zgjedhur, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për zgjedhje të kryer për drejtor, mund të parashtrorë ankesë te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Mandati i drejtorit të institucionit zgjat katër vjet, me mundësi përsëri të jetë i zgjedhur.

Drejtorin e institucionit publik për mbrojtje sociale e themeluar nga komuna, e zgjedh dhe shkarkon kryetari i komunës, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit.

Neni 187

Nëse në kohë nuk zgjidhet drejtori në institucionin publik për mbrojtje sociale të themeluar nga Qeveria, ministri emëron ushtrues të detyrës drejtor nga radhët e të punësuarve në institucionin publik, më së shumti për gjashtë muaj me mundësi për vazhdim edhe gjashtë muaj, ndërsa për institucionin publik të themeluar nga komuna, ushtrues të detyrës drejtor emëron kryetari i komunës, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit.

Ushtruesi i detyrës drejtor duhet t'i plotësojë kushtet e njëjta si për zgjedhje të drejtorit.

Neni 188

Drejtori i institucionit publik i themeluar nga Qeveria dhe institucioni publik i themeluar nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, e organizon punën dhe udhëheq me institucionin, e përfaqëson dhe e prezanton institucionin dhe është përgjegjës për ligshmërinë në punë.

Drejtori drejtpërdrejt udhëheq me institucionin dhe kujdeset për avancimin e tij.

Drejtori i institucionit është i obliguar të veprojë pas udhëzimeve të obligueshme me shkrim të miratuara nga ministri me qëllim për avancimin dhe përsosjen e punës së institucionit.

Në varësi nga natyra dhe ndërlikimi i punës, drejtori mund të emërojë udhëheqës të shërbimi, i cili për punën e vet përgjigjet para tij.

Drejtori parashtron raport vjetor për punën dhe për punën materiale-financiare te bordi drejtues i institucionit dhe te ministri, përkatësisht te kryetari i komunës, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit.

Drejtori miraton vendim për zgjedhje të punëtorit, kryen sistematizim të punëtorëve, vendos për pushime vjetore dhe mungesa të paguara dhe të papaguara për punëtorët, miraton aktvendim për pushim të marrëdhënies së punës dhe ngre përgjegjësi për dëm material dhe kryen punë të tjera në pajtim me ligj.

Neni 189

Drejtori i institucionit publik i themeluar nga Qeveria dhe i institucionit publik i themeluar nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, mund të shkarkohet para përfundimit të kohës për të cilën është emëruar:

- me kërkesë të tij,
- nëse krijohet ndonjë nga shkaqet, për të cilat sipas rregullave për marrëdhëniet e punës pushon marrëdhënia e punës me fuqi të ligjit,
- nëse nuk vepron sipas rregullave dhe akteve të përgjithshme të institucionit ose nuk i zbaton vendimet të bordit drejtues ose vepron në kundërshtim me to,
- nëse nuk dorëzon raport nga neni 188 paragrafi 5 të këtij ligji, përkatësisht nëse raporti është negativisht i vlerësuar,
- nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe jologjore i shkakton dëm institucionit publik, ose nëse i anashkalon ose me qëllim nuk i kryen detyrat e veta dhe për shkak të asaj do të krijohen ose ka mundësi të krijohen prishje të rënda në realizimin e veprimtarisë të institucionit publik dhe
- nëse pas mbikëqyrjes inspektuese nuk i mënjanojnë mangësitë e konstatuara dhe parregullsi në afatin të caktuar me aktvendim.

Nëse drejtori është i shkarkuar në bazë të veprimeve të theksuara në paragrafin 1 alinetë 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, drejtorit i pushon marrëdhënia e punës.

Organi për kontroll të brendshëm

Neni 190

Për kryerjen e kontrollit të brendshëm të punës së institucionit për mbrojtje sociale themeluesi formon organ të mbikëqyrjes.

Organin e mbikëqyrjes e përbëjnë tre anëtarë të emëruar nga themeluesi.

Anëtarët e organit për mbikëqyrje zgjidhen me mandat në kohëzgjatje prej katër vjetësh.

Për anëtarë të organit për mbikëqyrje mund të emërohen persona të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie të punës në institucion, kanë arsim të lartë dhe posedojnë dijeni dhe përvojë nga veprimtaria e institucionit.

Organin për mbikëqyrje e cakton dhe me punën e tij udhëheq kryetari, të cilin e zgjedhin anëtarët të organit për mbikëqyrje nga radhët e veta.

Organi për mbikëqyrje vendimet e veta i miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm.

Anëtarët e Organit për mbikëqyrje kanë të drejtë në kompensim mujor në lartësi prej 1.000 denarë.

Neni 191

Organi për mbikëqyrje kryen kontroll të punës materialo-financiare të institucionit, shfrytëzim dhe shpërndarje të mjeteve të institucionit dhe për konstatimet dorëzon raport te themeluesi, Ministria, bordi drejtues dhe drejtori i institucionit.

Numri i anëtarëve të organit të mbikëqyrjes, mënyra e punës, kushtet dhe mënyra e pushimit të mandatit të anëtarëve të organit për mbikëqyrje përcaktohen me statut të institucionit.

Neni 192

Udhëheqjen në institucionin privat e rregullon themeluesi, në pajtim me statutin dhe këtë ligj.

Neni 193

Institucionet për mbrojtje sociale, përkatësisht dhënësit tjerë të shërbimeve sociale formojnë Këshill të shfrytëzuesve ose përfaqësues të tyre ligjorë, përkatësisht kujdestarë.

Kreu IX.**KRYERJA E VEPRIMTARISË NË INSTITUCIONET PËR MBROJTJE SOCIALE****1. Kuadro në institucione për mbrojtje sociale**

Neni 194

Punët profesionale në institucion për mbrojtje sociale, në varësi nga lloji i punës, i kryejnë punëtorë profesionistë:

- me arsim të lartë, punëtor i diplomuar social, jurist, i diplomuar në administratë publike/menaxhment publik, psikolog, pedagog, defektolog/edukator special dhe rehabilitues, sociolog, ekonomist, andragog, logoped, mjek, pedagog special për parandalim risocializim, punëtor shëndetësor, edukator, ekspert për çështje gjinore, specialist për familje,

- me arsim sipëror: edukator, punëtor special, infermiere kryesore, fizioterapeut, terapeut i punës, punëtor statistike, jurist, ekonomist, punëtor shëndetësor dhe punëtorë të tjerë varësisht nga nevoja e veprimtarisë,

- me arsim të mesëm: edukator, infermiere, fizioterapeut, instruktor, sistem operator për futje, punëtor statistike, ekonom, laborant, përkujdesës, punëtor shëndetësor spitalor, geronto-ekonom, përkujdesës social për fëmijë dhe

- punëtorë të tjerë për kryerjen e punëve të tjera në varësi nga veprimtaria, lloji dhe vëllimi i shërbimeve, nëse me këtë ligj më ndryshe nuk është përcaktuar.

Punëtorët profesionistë me arsim të lartë mund të kryejnë punë profesionale në institucion për mbrojtje sociale, nëse kanë licencë për punë, në pajtim me këtë ligj.

Neni 195

Në institucionet publike për mbrojtje sociale vendet e punës të të punësuarve grupohen në grupe dhe nëngrupe në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, edhe atë:

- nëpunës administrativë,
- dhënës të shërbimeve publike në institucionet publike për mbrojtje sociale dhe
- persona ndihmës-teknikë.

Neni 196

Të punësuarit në institucionet publike për mbrojtje sociale të cilët ushtrojnë punë të natyrës administrative për zbatimin e veprimtarisë të mbrojtjes sociale të përcaktuar me këtë ligj, punët të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, gjatë realizimit të ndihmës në para të persona me status të pranuar të refugjatit dhe nën mbrojtje subsidiare, të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme, punët të përcaktuara me rregullat familjare-juridike dhe rregullat penale-juridike, të përcaktuara me ligj dhe statut të institucioni publik për mbrojtje sociale, e themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, kanë status të nëpunësve administrativë.

Të punësuarit në Entin për veprimtari sociale kanë status të nëpunësve administrativë, përveç personave ndihmës-teknikë.

Për të punësuarit në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

Për kryerjen e punëve nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen edhe profilet në vijim: "i diplomuar në administratë publike/menaxhment publik".

Për çështjet të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin, avancimin, përsosjen profesionale dhe aftësimin, sistemi i rrogës, matja e efektit dhe çështje të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të nëpunësve administrativë në institucionet publike për mbrojtje sociale zbatohen dispozitat të Ligjit për nëpunës administrativë.

Neni 197

Të punësuarit në institucionet publike për mbrojtje sociale të cilët kryejnë punë nga veprimtaria për mbrojtje sociale, kanë status të dhënësit të shërbimeve publike në veprimtarinë mbrojtje sociale dhe për to zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat të Ligjit për të punësuar në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 të këtij neni përcaktohen kategoritë e vendeve të punës si vijojnë:

- kategoria A profesionale (punëtor social i diplomuar, psikolog, andragog, pedagog, jurist, ekonomist, mjek, defektolog, logoped, pedagog i veçantë për parandalim dhe risocializim dhe sociolog, punëtor shëndetësor, edukator dhe të tjerë).

- niveli A1 udhëheqës i shërbimit në institucione publike për mbrojtje sociale,

- niveli A2 koordinator në seksionin në institucion publik për mbrojtje sociale,

- niveli A3 supervizion në qendra për punë sociale (punëtor social, psikolog, pedagog),

- niveli A4 nëpunës i pavarur profesional në institucionet publike (jurist, ekonomist, punëtor social i diplomuar, psikolog, pedagog, mjek, defektolog, andragog,

logoped, mjek, pedagog i veçantë për parandalimin dhe risocializimin, punëtor shëndetësor, edukator dhe sociolog) dhe udhëheqës i rastit në qendrën për punë sociale (punëtor social i diplomuar, psikolog, pedagog, jurist në qendrat për punë sociale),

- niveli A5 nëpunës profesional në institucion publik për mbrojtje sociale (jurist, ekonomist, punëtor social i diplomuar, psikolog, pedagog, mjek, defektolog, andragog, logoped, mjek, pedagog i veçantë për parandalimin dhe risocializimin, punëtor shëndetësor, edukator dhe sociolog) dhe trijzher në qendrën për punë sociale (punëtor social i diplomuar),

- kategoria B ndihmës profesionalë (edukator, kryeinfermiere, fizioterapeut, terapeut pune, punëtor statistike, jurist, ekonomist, punëtor shëndetësor, sistem operatorë për hyrje, ekonomie, laborant, përkujdesës, infermier, fizioterapeut, infermiere geronto-ekonom, infermier, përkujdesës social për fëmijë, instruktor dhe të tjerë)

- niveli B1 ndihmës-profesionalë nga niveli i parë,

- niveli B2 ndihmës-profesional nga niveli i dytë dhe

- niveli B3 ndihmës-profesional nga niveli i dytë.

Të punësuar nga paragrafi 2 të këtij neni duhet t'i plotësojnë kushtet e veçanta:

- për nivelin A1 240 kredi të fituara sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 ose më së paku pesë vjet përvojë pune,

- për nivelin A2 240 kredi të fituara sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 ose më së paku tre vjet përvojë pune,

- për nivelin A3 240 kredi të fituara sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 ose më së paku tre vjet përvojë pune,

- për nivelin A4 të fituara 240 kredi sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 ose më së paku dy vjet përvojë pune,

- për nivelin A5 të fituara më së paku 180 kredi sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 me ose pa përvojë pune prej së paku një vit,

- për nivelin B1, së paku 180 kredi të fituara sipas SETK ose të paktën niveli i kualifikimeve VI B,

- për nivelin B2, të paktën nivelin e kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP ose arsim katërvjeçar të mesme V A 60 deri në 120 kredi sipas SETK ose arsimit të lartë dhe;

- për nivelin B3, të paktën nivelin e kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP ose arsim katërvjeçar të mesëm.

Për të gjitha nivelet nga kategoria A kushte të veçanta për punësim janë edhe njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca pune të veçanta përcaktuara me aktin për sistematizim në vende pune me vend pune përkatës.

Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin, avancimin, përsosjen profesionale dhe aftësim, matje të efektit dhe çështje të tjera që lidhen

me marrëdhënien e punës të dhënësit të shërbimeve publike në fushën e punëve sociale në institucionet publike për mbrojtje sociale, zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 198

Të punësuarit në institucionet publike të mbrojtjes sociale që kryejnë punë ndihmëse-teknike kanë statusin e personave ndihmës teknik të Grupit IV dhe për to janë përcaktuar nëngrupet, kategoritë dhe nivelet si vijojnë:

- nëngrupi 1, kategoria A, haus-mjeshër, punë hidraulike dhe elektriciste, kopshtar dhe të tjera, kategoria B ndezës i kazanit me avull, ekonom-nikoqir, automekanik dhe të tjerë, persona ndihmës-teknikë për mirëmbajtjen e objekteve dhe të pajisjes,

- nëngrupi 2 kategoria A rojtar dhe persona tjerë ndihmës teknik për sigurimin e objekteve dhe të pajisjeve,

- nëngrupi 3 kategoria A shofer dhe persona tjerë ndihmës teknikë për transport të personave dhe pajisjes,

- nëngrupi 4 kategoria A kuzhinier dhe persona tjerë ndihmës teknikë në kuzhinë ose në objekte hoteliere

- nëngrupi 5 kategoria A rrobaqepës, berber, pastrues dhe persona tjerë ndihmës teknikë.

Për çdo kategori në nëngrupet 1, 2, 3, 4 dhe 5 përcaktohen tri nivele:

- A01 persona ndihmës teknikë të nivelit të parë, me të paktën nivelin e kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP ose arsim katërvjeçar të mesëm.

- A02 persona ndihmës teknikë të nivelit të dytë, me të paktën nivelin e kualifikimit III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim trevjeçar të mesëm dhe

- A03 persona ndihmës teknikë nga niveli i tretë me më së paku nivel të kualifikimeve I ose arsim fillor.

Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin dhe çështje të tjera që lidhen me marrëdhënien e punës të personave ndihmës teknikë në institucionet publike për mbrojtje sociale, zbatohen dispozitat e këtij ligji, të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme në fushën e marrëdhënieve të punës.

2. Rroga dhe kompensimet e rrogës

Neni 199

Rroga e dhënësit të shërbimit publik përbëhet nga komponentët si vijojnë:

- komponenti bazë dhe

- komponenti i jashtëzakonshëm.

Neni 200

Komponentin bazë të rrogës e përbëjnë:

- pjesë e rrogës për shkallën e arsimit,

- pjesë e rrogës për nivel dhe

- pjesë e rrogës për stazh.

Pjesa e rrogës për shkallën e arsimit që është minimumi ligjor për nivelin përkatës të vendit të punës vlerësohet në mënyrën si vijon:

NIVELI I KUALIFIKIMEVE/ARSIMI	PIKËT
Niveli i kualifikimeve VIA, 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1	200
Niveli i kualifikimeve VI B, ose 180 kredi sipas SETK	175
Niveli i kualifikimeve VA, 60 deri 120 sipas SETK ose arsim të lartë	150
Niveli i kualifikimeve IV, 240 sipas ECVET ose SKMAP ose arsim të mesëm katërvjeçar	100

Pjesë e rrogës për nivelin për të cilin është sistemuar dhënësi i shërbimit publik vlerësohet në mënyrën si vijon:

NIVELI	PIKËT
A1 udhëheqës i shërbimit	450
A2 koordinator i seksionit	360
A3 suspervizion	350
A4 nëpunës i pavarur profesional dhe udhëheqës i rastit	330
A5 nëpunës profesional dhe trijzhë	280
B1 ndihmës-profesional nga niveli i parë	265
B2 ndihmës-profesional nga niveli i dytë	255
B3 ndihmës-profesional nga niveli i tretë	240

Pjesa e rrogës nga stazhi i punës për dhënësin e shërbimeve publike vlerësohet në shumë prej 0,5% të pjesëve të rrogës për shkallën e arsimit dhe për nivel, për çdo vit të përfunduar të stazhit të punës kurse më së shumti deri në 20%.

Neni 201

Vlera e pikës për llogaritjen e rrogave të dhënësve të shërbimeve publike dhe drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale (institucion, qendër ndërkomunale për punë sociale, respektivisht qendër për punë sociale) përcaktohet çdo vit me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të Financave dhe ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, i cili miratohet në afat prej dhjetë ditëve nga dita e miratimit të buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse në suaza të buxhetit të paraparë dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të dhënësve të shërbimeve publike të shpërndarë në nivelet e duhura për vitin rrjedhës.

Neni 202

Komponentin e jashtëzakonshëm të rrogës e përbëjnë:

- shtesa e rrogës për punë të ekspozuar në rrezik të lartë dhe/ose shtesa e rrogës për punë nate, punë në turne dhe pas orarit,
- shtesa e rrogës për punë të ekspozuar në rrezik të lartë.

Neni 203

Shtesa e rrogës për punë me ekspozim në rrezik të lartë për dhënësin e shërbimit publik duhet të parashihet me aktin për sistematizimin e vendeve të punës në institucione.

Dhënësi i shërbimit publik i cili gjatë kryerjes së punës është i ekspozuar në rrezik të lartë për jetën dhe shëndetin e tij ka të drejtën e shtesës së rrogës, në varësi të llojit të rrezikut, në lartësi prej 10% deri në 30% të shumës së rrogës bazë, në pajtim me ligjin.

Vendet e punës nga paragrafi 2 i këtij neni i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale, kurse lartësinë e shumës nga paragrafi 3 i këtij neni e përcakton Qeveria, me propozim të Ministrisë së Financave.

Neni 204

Dhënës i shërbimeve publike ka të drejtë në shtesën e rrogës për:

- punë nate,
- ndërrim në turne,
- punë gjatë pushimit javor,
- punë gjatë festave të përcaktuara me ligj dhe
- punë më të gjatë se orari i plot i punës

Shtesat për rrogë nga paragrafi 1 alinetë 1 dhe 2 të këtij neni duhet të parashihen në aktin për sistematizimin e vendeve të punës në institucione.

Shtesa e rrogës për punë nate për orë vlerësohet 35% nga shuma e rrogës neto për orë.

Shtesa e rrogës për punë në turne për orë vlerësohet 5% nga shuma e rrogës neto të llogaritur për orë.

Dhënësi i shërbimit publik i cili është angazhuar të punojë në pajtim me kushtet nga paragrafi 1, alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij neni ka të drejtën e orëve ose ditëve të lira aq sa ka qenë i angazhuar për punë jashtë orarit të rregullt të punës.

Orët e lira, respektivisht ditët e muajit rrjedhës dhënësi i shërbimit publik i shfrytëzon deri në fund të muajit të ardhshëm, pas muajit në të cilin është angazhuar.

Nëse dhënësi i shërbimit publik nuk i siguron shfrytëzimin e orëve respektivisht ditëve të lira në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni i paguhet shtesë rroge në shumën prej 35% të shumës së rrogës bazë, e llogaritur në orë.

Shtesa e rrogës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk përjashtohen.

Neni 205

Dhënësi i shërbimeve publike ka të drejtën e kompensimit për rroga dhe kompensime tjera në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune, dhe atë për:

- shpenzime rruge, mëditje dhe shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jashtë vendit,
- shpenzime për udhëtime zyrtare në vend,
- shpenzime për shfrytëzimin e automjeteve në pronësi personale për qëllime zyrtare,
- shpenzime për jetë të ndarë nga familja,
- shpenzime për zhvendosje,
- shpenzime për punë në terren,
- shpenzime për varrim në rast të vdekjes së dhënësit të shërbimit publik ose të anëtarit të familjes së tij të afërt (bashkëshorti dhe fëmijët e lindur në martesë ose jashtë martesë, fëmijë të birësuar, fëmijë të adoptuar dhe fëmijë të marrë për mbajtje),
- dëm gjatë fatkeqësive elementare dhe
- shpenzime gjatë sëmundjes më të gjatë dhënësit të shërbimeve publike.

Lartësia e kompensimeve nga paragrafi 1, alinetë 7 dhe 9 të këtij neni, përcaktohen me Ligjin për realizimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kurse lartësia e kompensimeve nga paragrafi 1 alinetë 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8 të këtij neni përcaktohen në marrëveshjen kolektive për mbrojtje sociale.

Neni 206

Nëse te dhënësi i shërbimeve publike paraqitet paafësi për punë ka të drejtë të kompensimit për rrogë në lartësi përcaktuar me ligj.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni për çdo vit përcaktohet me ligjin për realizim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 207

Gjatë shfrytëzimit të pushimit vjetor ose trajnimeve të specializuara për përsosje profesionale për nevojat e institucionit, dhënësi i shërbimit publik ka të drejtë të rrogës në lartësi të rrogës që do ta pranonte në muajin rrjedhës në qoftë se do të ishte në punë, pa shtesë të rrogës për punë të ekspozuar në rrezik të lartë.

Neni 208

Komponenti i rrogës së drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale (institucion, qendër ndërkomunale për punë sociale respektivisht qendër për punë sociale) e përbëjnë:

- pjesa e rrogës për shkallën e arsimit,
- pjesa e rrogës në bazë të udhëheqjes dhe përgjegjësisë dhe
- pjesa e rrogës për stazh.

Neni 209

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale (institucion, qendër ndërkomunale për punë sociale, përkatësisht qendër për punë sociale) realizon shtesë të rrogës për shkallë të arsimit në gjithsej 200 pikë.

Pjesa e rrogës në bazë të udhëheqjes dhe përgjegjësisë së drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale (institucion, qendër ndër-komunale për punë sociale, përkatësisht qendër për punë sociale) vlerësohet në këtë mënyrë:

pjese e rrogës në bazë të udhëheqjes dhe përgjegjësisë	PIKËT
drejtor i qendrës për punë sociale në zonat me më pak se 30,000 banorë	500
drejtor i institucionit me më pak se 70 mbrojtës	500
drejtor i entit për veprimtari sociale	550
drejtor i qendrës për punë sociale në zonat prej 30-80,000 banorë	550
drejtor i institucionit prej 70 deri më 100 mbrojtës	550
drejtor i institucionit për strehimin e personave që kërkojnë të drejtën e azilit	550
drejtor i qendrës për punë sociale në zonat prej 80-150,000 banorë	600
drejtor i institucionit me më shumë se 100 mbrojtës	600
drejtor i qendrës për punë sociale në zonat me mbi 150,000 banorë	650
drejtor i institucionit me më shumë se 200 mbrojtës	650

Pjesa e rrogës për stazh të punës së drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale (institucion, qendër ndërkomunale për punë sociale, përkatësisht qendër për punë sociale) vlerësohet në masën 0.5% nga pjesët e rrogës për nivelin e arsimit dhe pjesë të rrogës në bazë të udhëheqjes dhe përgjegjësisë, për çdo vit të përfunduar të stazhit, ndërsa së paku deri në 20%.

3. Punësimi dhe avancimi në institucion publik

Neni 210

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale, përgatit plan vjetor për punësim në institucionin publik për vitin e ardhshëm, në përputhje me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

Neni 211

Për plotësimin e vendeve të punës të dhënësve të shërbimeve publike në fushën e punëve sociale nga neni 197 paragrafi 2 të këtij ligji, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm t'i shqiptohet dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Përveç kushteve të përgjithshme për plotësimin e vendit të punës të dhënësve të shërbimeve publike në fushën e punës sociale, kandidati gjithashtu duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta në përputhje me klasifikimin e vendeve të punës të përcaktuara në nenin 197 paragrafin 3 të këtij ligji.

Personat të cilët janë të punësuar për herë të parë në institucion publik për mbrojtje sociale si dhënës të shërbimeve publike janë të detyruar të kryejnë punë provuese. Puna provuese për kandidatin e zgjedhur të kategorisë A zgjat katër muaj, nën mentorimin e dhënësit të shërbimit publik në nivel të njëjtë ose më të lartë, të emëruar nga drejtori, me qëllim të transferimit të njohurive dhe aftësive për zhvillim të kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta për të punësuarin nëpërmjet këshillave konkrete të mentorit.

Pas përfundimit të punës provuese, kandidati i zgjedhur nga paragrafi 5 i këtij neni, është e nevojshme të marrë licencën për punë në institucion për mbrojtje sociale, në përputhje me këtë ligj.

Neni 212

Drejtori i institucionit për mbrojtje sociale miraton vendim për nevojën punësim të dhënësve të shërbimeve publike, për plotësimin e vendit të lirë në institucion.

Me vendim nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet nëse plotësimi i vendeve të lira të punës në institucionin e mbrojtjes sociale bëhet nëpërmjet punësimit të personit me anë të shpalljes së konkursit publik, shpalljes së konkursit intern dhe mobilitetit nëpërmjet sistematizimit ose ndërmarrjes në përputhje me dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik.

Në institucion publik për mbrojtje sociale, nevoja për dhënës të shërbimeve publike sigurohet me shpalljen e konkursit publik në së paku dy gazeta ditore nga të cilat të paktën një nga gazetata që publikohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetata që botohen në gjuhën që flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Me përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, në institucionin publik për mbrojtje sociale mund të plotësohet vendi punës nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes për punësim për kohë të caktuar në pajtim me Ligjin për punësim në sektorin publik.

Në rastet kur plotësimi i vendeve të lira të punës kryhet me anë të shpalljes së konkursit intern, ai publikohet në tabelën e shpalljeve të institucionit dhe në faqen e internetit të institucionit. Procedura për avancim ka për qëllim tu mundësojë dhënësve të shërbimit publik përparim të karrierës. Gjatë procedurës për avancim respektohet parimi i përfaqësimit të barabartë. Procedura e përparimit mund të fillojë pas marrjes së njoftimit për mjete të të siguruar financiare.

Shpallja përmban të dhëna për vendin e punës që duhet të plotësohet për kushtet e nevojshme që duhet t'i plotësojë dhënësi i shërbimeve publike në pajtim me këtë ligj dhe aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të institucionit dhe afatin për paraqitjen e konkursit intern, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë pune nga data e publikimit të tij. Në shpallje interne mund të paraqitet dhënësi i shërbimit i punësuar në të njëjtin institucion që i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara për nivelin përkatës në këtë ligj dhe në aktin e sistematizimit si dhe:

- të vlerësohet me notë "4" ose "5" gjatë vlerësimit të fundit,

- që ka kaluar të paktën dy vite në vendin rrjedhës së punës dhe

- të mos i jetë shqiptuar masa disiplinore në vitin e fundit para shpalljes së konkursit intern.

Kandidatët paraqiten në konkursin intern me parashtrimin e fletëparaqitjes së plotësuar dhe dëshmimeve për të dhënat e përmbajtura në fletëparaqitje dhe atë nëpërmjet arkivit e dorëzojnë te njësi organizative për menaxhim me resurset njerëzore ose te personi i obliguar për menaxhim me resurset njerëzore. Afati për paraqitje nuk mund të jetë më i shkurt se tri ditë, përkatësisht më i gjatë se 10 ditë nga dita e shpalljes së tij.

Drejtori formon komision për seleksionim për avancim, të përbërë prej tre anëtarëve prej të cilëve njëri dhënës i shërbimeve publike prej të cilëve një me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik për cilin vend pune është shpallë konkursi intern, një i punësuar nga njësi organizative për menaxhim me resurset njerëzore ose personi i cili i kryen punët me menaxhim me resurset njerëzore nëse nuk ka njësi organizative edhe një i punësuar në Entin për Veprimtari Sociale dhe zëvendës të tyre. Kryetari i komisionit është nga institucioni në të cilin është shpallur konkursi intern.

Procedura për konkursin intern përbëhet prej dy fazave: seleksionimi administrativ, i cili përbëhet nga kontrolli i të dhënave të futura në fletëparaqitje dhe dëshmitë e bashkangjitura në fletëparaqitje dhe intervista. Për kandidatët për të cilët gjatë seleksionimit administrativ do të vërtetohet se nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara në konkursin intern, procedura e seleksionimit mbaron. Për kandidatët tjerë në afat prej pesë ditë pune pas mbarimit të seleksionimit administrativ komisioni zbaton intervistë.

Pas mbarimit të seleksionimit administrativ dhe intervistës, komisioni përpilon rang listë dhe ia propozon kandidatit e parë të ranguar drejtorit. Në afat prej tri ditë pune nga marrja e propozimit drejtori është i detyruar ta miratojë vendimin për zgjedhje. Vendimi për zgjedhje u dorëzohet kandidatëve dhe shpallet në ueb faqen interne të institucionit.

Drejtori mund të miratojë vendim për moskryerje të zgjedhjes, dhe në të është i detyruar t'i theksojë arsyet për miratim e saj.

Kundër vendimit për zgjedhje ose moskryerje të zgjedhjes së dhënësit të shërbimit publik kandidati i pakënaqur mund të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të dytë, në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit për vendim për zgjedhje, përkatësisht nga dita e shpalljes në faqen interne ose tabelën e shpalljes në vendim për mos kryerje të zgjedhjes.

Kur drejtori punëson dhënës të shërbimeve publike me anë të konkursit publik, është i obliguar në konkursin publik t'i theksojë kushtet që kërkohen për kryerjen e punës, fillimin dhe mbarimin e orarit ditor dhe javor të punës, orarin e punës dhe shumën në para të rrogës bazë për vendin e punës për të cilin kërkohet dhënësi i shërbimit publik dhe afatin për paraqitje, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë pune.

Drejtori formon komision për përzgjedhje për punësim, i cili është i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë nga radha e të punësuarve dhënës të shërbimeve publike dhe zëvendësve të tyre. Komisioni për Përzgjedhje për Punësim përbëhet nga një dhënës i shërbimeve publike udhëheqës dhe dy dhënës të shërbimit publik, nga të cilët një me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik për të cilin vend pune është shpallur konkursi publik dhe një anëtar i komisionit është person i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose personi që i kryen punët e menaxhimit me burimet njerëzore nëse nuk ka njësi organizative.

Procedura pas konkursit publik përbëhet nga dy faza: përzgjedhja administrative, e cila përbëhet nga kontrolli i të dhënave të futura në fletëparaqitje dhe dëshmitë e bashkangjitura në fletëparaqitje dhe intervistë. Për kandidatët për të cilët gjatë përzgjedhjes administrative do të përcaktohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkursin publik, procedura e përzgjedhjes përfundon. Për kandidatët tjerë në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të përzgjedhjes administrative komisioni zbaton intervistë.

Pas përfundimit të përzgjedhjes administrative dhe intervistës, komisioni përbën rang listë të cilën në afat prej pesë ditësh ia dorëzon drejtorit dhe ia propozon kandidatin e parë të ranguar drejtorit. Gjatë përpilimit të rang listës komisioni për përzgjedhje i zbaton dispozitat e Ligjit për të punësuar në sektorin publik për punësimin e kandidatëve me përkatësi të bashkësisë në pajtim me planin vjetor të institucionit.

Drejtori miraton vendim për kryerje të zgjedhjes ose moszgjedhjes së kandidatit, në afat prej tetë ditësh pas pranimit të rang-listës nga komisioni për përzgjedhje, e cila publikohet në tabelën për shpallje të institucionit dhe në internet faqen e institucionit. Vendimi për zgjedhje ose moszgjedhje të kandidatëve dorëzohet për kandidatët të cilët e kanë kaluar përzgjedhjen administrative.

Kundër vendimit kandidatët e pakënaqur, mund të paraqesin ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë. Pas përfundimit të vendimit për zgjedhje të kandidatëve, drejtori lidh marrëveshje për punësim me kandidatin e zgjedhur.

4. Përgjegjësia disiplinore e të punësuarve

Neni 213

Të punësuarit në institucion publik për mbrojtje sociale si dhënës të shërbimeve publike, personalisht janë përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës të vendit të punës.

Për shkelje të detyrës zyrtare, i punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përgjigjet në mënyrë disiplinore, për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore.

Parregullsia disiplinore paraqet shkelje më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës, imazhit të institucionit ose të dhënësit të shërbimit publik dhe atë:

- mosrespektim i orarit të punës, shpërndarje dhe shfrytëzim i orarit të punës,
- rruajtje të parregullt të shkresave zyrtare dhe të dhënave,
- mosardhje në punë dy ditë pune gjatë një viti kalendarik pa arsye,
- moskryerje, kryerje të pandërgjegjshme jo në kohë ose të pakujdesshme të punës dhe detyrave të punës me pasojë më të vogla të shkeljes,
- sjellje e pahijshme e dhënësit të shërbimit publik gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të punës me pasojë më të lehta nga shkelja,
- shfrytëzim i pandërgjegjshëm dhe përdorim i mjeteve të besuara financiare dhe mjeteve të punës,
- njoftim i paarsyeshëm i dhënësit të shërbimit publik epror i drejtpërdrejtë, përkatësisht të drejtorit për pengesë për mosardhje në punë në afat prej tri orësh dhe
- refuzim i aftësimin dhe përsosjes profesionale në të cilën dhënësi i shërbimit publik dërgohet.

Shkelja disiplinore paraqet shkelje më të rëndë të detyrës zyrtare, disiplinës së punës, imazhit të institucionit ose imazhit të dhënësit të shërbimit publik dhe atë:

- moskryerje kryerje e pandërgjegjshme, jo në kohë ose e pakujdesshme e detyrave të punës me pasojë më të rëndë të shkeljes,
- sjellje e pahijshme e dhënësit të shërbimit publik gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të punës me pasojë më të rëndë të shkeljes,
- prononcim dhe përfaqësim të bindjes politike në kryerjen e detyrave të punës, pjesëmarrje në aktivitetet zgjedhore ose ngjarje të tjera publike të karakterit të tillë gjatë orarit të punës, vëni e në pyetje të statusit personal të nëpunësit publik me kryerjen e aktiviteteve partiake, bartje ose theksim të simboleve partiake në hapësirën punuese,
- refuzim i dhënies ose mosdhënie e të dhënave të pasakta institucioneve, përkatësisht qytetarëve dhe personave juridikë, nëse dhënia e të dhënave është përcaktuar me ligj,
- disponim i paligjshëm me mjetet materiale dhe financiare,
- refuzim i kryerjes së detyrave të punës të lidhura me vendim e punës në të cilin është caktuar,
- refuzim i urdhrin me shkrim për realizimin e detyrave të punës të lidhura me punën e institucionit të lëshuara nga eprori i drejtpërdrejtë përkatësisht drejtori,
- mos marrje ose marrje e paplotë e masave të përcaktuara për garantimin e sigurisë së lëndëve konfidencialenë punë,
- shkaktimin e dëmit material me qëllim ose pakujdesi e skajshme,
- përsëritje e parregullsisë disiplinore më shumë se dy herë në vitin rrjedhës,
- pranim i dhuratave ose llojit tjetër të interesit,
- keqpërdorim i pushimit mjekësor,
- keqpërdorim i të dhënave të besueshme,
- keqpërdorim i të dhënave personale,
- keqpërdorim i autorizimeve konfidenciale në kryerjen e detyrave të punës,
- futje dhe përdorim, si dhe punë nën ndikimin e alkoolit ose mjeteve narkotike,
- mos përmbajtje ndaj rregullave për mbrojtjen nga sëmundja, të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, zjarrit, shpërthimit, veprimeve e dëmshme të helmeve dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dispozitave të mjedisit jetësor,
- vendosje e interesit financiar personal në konflikt me pozitën dhe statusin e nëpunësit publik,
- sjellje ofenduese ose sjellje e dhunshme,
- dhënie e informatës së klasifikuar me shkallë të përhershme të përcaktuar me ligj,
- mosveprim sipas detyrimit për vlerësim të dhënësit të shërbimit publik,
- në procedurë administrative nuk kërkon dëshmi dhe të dhëna sipas detyrës zyrtare në afat të përcaktuar me ligj,
- në procedurë administrative nuk dorëzon dëshmi dhe të dhëna të cilat janë kërkuar sipas detyrës zyrtare të përcaktuar me ligj dhe
- nuk i zgjidh lëndët në procedurë administrative në afat të përcaktuar me ligj.

Përgjegjësia për kryerje të veprës penale, përkatësisht shkeljes nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të të punësuarit.

Neni 214

Me vendim për parregullsi disiplinore të përcaktuar dhënësit të shërbimit publik mund t'i shqiptohet një nga këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim dhe
- dënim me para në lartësi prej 10% nga lartësia e shumës një mujore të rrogës neto të paguar në muajin e fundit para parregullsisë disiplinore në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj.

me vendim për shkelje disiplinore të përcaktuar dhënësit të shërbimit publik mund t'i shqiptohet një nga këto masa disiplinore:

- dënim me para në lartësi prej 30% nga lartësia e shumës një mujore të neto rrogës së paguar në muajin e fundit para shkeljes disiplinore në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj.

- sistemim në vendin e punës në nivel të drejtpërdrejtë më të ulët dhe

- ndërprerja e marrëdhënies së punës kur kanë ndodhur pasoja të dëmshme për institucionin, ndërkaq nuk janë përcaktuar rrethanat lehtësuese për dhënësin e shërbimit publik i cili e ka bërë shkeljen.

Në vendimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni detyrimisht theksohet data nga e cila ato realizohen.

Shuma e dënimeve me para të shqiptuara dhënësit të shërbimit publik në një muaj për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore nuk mund të tejkalojë 30% të shumës së neto rrogës së tij të përgjithshme për atë muaj.

Neni 215

Çdo dhënës i shërbimeve publike dhe person tjetër, në pajtim me ligj ka të drejtë të paraqesë iniciativë për ngritje të procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimit publik në institucion publik për mbrojtje sociale, e cila duhet të arsyetohet.

Propozim për ngritje të procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimit publik paraqet dhënësi të shërbimit publik epror i drejtpërdrejtë, përkatësisht nëpunësi udhëheqës ose drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale.

Neni 216

Propozimi për ngritje procedurës për përcaktimin e përgjegjësive disiplinore si rregull i përmban elementet e mëposhtme:

- emrin personal të dhënësit të shërbimit publik për të cilin paraqitet propozimi për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive disiplinore,

- vendin e punës ku është sistemuar dhënësi i shërbimit publik për të cilin paraqitet propozimi,

- përshkrimin e veprimit/eve me të cilën/cilat është bërë shkelja e rendit të punës dhe disiplinës ose mospërbushja e detyrimeve të punës,

- theksimin e kualifikimit të veprimit/eve nga paragrafi 1 alineja 3 të këtij neni me theksim konkret nëse kjo paraqet shkelje më të lehtë, përkatësisht më të rëndë të rendit të punës dhe disiplinës ose mosrespektimit të detyrimeve të punës,

- kohën, mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprimit me të cilin është bërë shkelja e rendit të punës dhe disiplinës ose mospërbushja e detyrimeve të punës,

- pasojat që kanë ndodhur nga shkelja e bërë e rendit të punës dhe disiplinës ose mospërbushja e detyrimeve të punës,

- theksimi i dëshmisë/ve nga të cilat vërtetohet kjo sjellje, përkatësisht dëshmi që i bashkëngjitet faktit se është kryer një veprim (shënim zyrtar, raport me shkrim, informatë, paraqitje, deklarata nga dëshmitarët),

- theksimi i emrit personal të personit i cili mund të thirret në cilësi të dëshmitarit,

- të dhënë nëse dhënësi i shërbimit publik për të cilin parashtrohet propozimi deri atëherë është përgjigjur për shkeljen e rendit të punës dhe disiplinës ose mospërbushjen e detyrimeve të punës në institucionin publik për mbrojtje sociale dhe

- të dhënë lidhur me shpërblimet paraprake të dhënësit të shërbimit publik.

Në shtojcë të propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen dëshmitë e përmendura në dokumentin e njëjtë dhe dokumentet tjera që sipas vlerësimit të propozuesit janë me rëndësi për rastin konkret.

Neni 217

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale formon komision për mbajtjen e procedurës disiplinore për shkelje disiplinore në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të propozimit për ngritje të procedurës disiplinore.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përbëhet nga tre anëtarë edhe atë një dhënës udhëheqës i shërbimit publik dhe dy dhënës të shërbimit publik nga të cilët një me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik kundër të cilit mbahet procedura disiplinore.

Kryetari i komisionit është nga radha e dhënësve të shërbimit publik udhëheqës. Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë zëvendës.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni, pas procedurës së zbatuar disiplinore, i propozon masë disiplinore adekuate drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale.

Nëse komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni përcakton se dhënësi i shërbimit publik nuk është përgjegjës ose nuk janë plotësuar kushtet për miratimin e aktvendimeve për shqiptimin e masës disiplinore i propozon drejtorit ta refuzojë propozimin, përkatësisht ta ndërpresë procedurën.

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës, në bazë të propozimit të komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni miraton aktvendim për shqiptimin e masës disiplinore për shkelje disiplinore.

Neni 218

Masat disiplinore për parregullsi disiplinore të dhënësit të shërbimit publik në institucionin publik për mbrojtje sociale i shqipton drejtori i institucionit publik, dhe sipas raportit paraprak me shkrim nga dhënësi i shërbimit publik epror i drejtpërdrejtë.

Para shqiptimit të masës disiplinore dhënësi i shërbimit publik njoftohet me shkrim për citimet e raportit nga paragrafi 1 i këtij neni që ekzistojnë kundër tij dhe i njëjti ka të drejtë të japë përgjigje me gojë ose me shkrim në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë.

Nëse dhënësi i shërbimit publik nuk dëshiron ta pranojë njoftimin për citimet në raportin nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej tre ditë, i njëjti do të publikohet në tabelën për shpallje në selinë e institucionit publik për mbrojtje sociale.

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës miraton aktvendim për shqiptimin e masës disiplinore.

Neni 219

Kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore nga nenet 214 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, dhënësi i shërbimit publik në institucionin publik për mbrojtje sociale ka të drejtë për ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 220

Dhënësi i shërbimit publik në institucionin publik për mbrojtje sociale është përgjegjës për dëmin të cilin në punë ose lidhur me punën me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme ia ka shkaktuar institucionit publik për mbrojtje sociale.

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale formon komision për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të dhënësit të shërbimit publik.

Komisioni nga paragrafi 2 të këtij neni është i përbërë nga kryetari, i cili është dhënës i shërbimit publik udhëheqës ose dhënës i shërbimit publik i cili nuk është me titull më të ulët se titulli i dhënësit të shërbimit publik kundër të cilit mbahet procedurë për përgjegjësi materiale dhe dy anëtarë nga të cilët njëri është dhënës i shërbimit publik, ndërsa njëri është përfaqësues i sindikatës. Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë zëvendës.

Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistimin e dëmit të bërë material, lartësinë e tij dhe mënyrën e kryerjes, kush e ka shkaktuar dënim dhe kush do ta kompensojë.

Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni për gjendjen e përcaktuar faktike parashtron raport në bazë të të cilit drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale miraton aktvendim për kompensim të dëmit.

Neni 221

Propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale kundër dhënësit të shërbimit publik në institucionin publik për mbrojtje sociale paraqet dhënësi i shërbimit publik epror i drejtpërdrejtë, përkatësisht nëpunësi udhëheqës ose drejtori i institucionit.

Procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngritet nëse kanë kaluar 30 ditë nga dita kur dhënësi i shërbimit publik epror i drejtpërdrejtë, përveç kur procedura ngritet sipas konstatimit të revizionit të brendshëm me çka afati për vjetërsim është një vit.

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të udhëhiqet më shumë se 60 ditë, duke konsideruar ditën e miratimit të aktvendimit për formimin e komisionit nga neni 220 paragrafi 2 të këtij ligji.

Kundër dhënësit të shërbimit publik i cili në afat prej 60 ditëve nga përfundimi i vendimit për kompensimin e dëmit, nuk e kompenzon dëmin, institucioni ngrit procedurë para gjykatës kompetente themelore.

Drejtori, mundet plotësisht ose pjesërisht ta lirojë dhënësin e shërbimit publik nga kompensimi i dëmit, nëse ajo nuk është kryer me qëllim ose nëse me pagimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar rrezikohet ekzistenca e dhënësit të shërbimit publik dhe familjes së tij ose në raste tjera të përcaktuara me marrëveshje kolektive.

Neni 222

Kundër aktvendimit nga neni 220 paragrafi 5 të këtij ligji dhënësi i shërbimit publik në institucionin publik për mbrojtje sociale ka të drejtë për ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

5.Përsosja profesionale e të punësuarve

Neni 223

Të punësuarit në institucion publik për mbrojtje sociale si dhënës të shërbimeve publike, kanë të drejtë të përsosjes profesionale, për çka drejtori miraton plan për zhvillim të vazhdueshëm profesional në pajtim me programin për edukim të vazhdueshëm të personave profesionistë, të përgatitur nga Enti për Veprimtari Sociale.

Neni 224

Institucionet për mbrojtje sociale vendosin sistem për menaxhim me efektin e dhënësve të shërbimeve publike.

Sistemin nga paragrafi 1 i këtij neni e përbëjnë: përcaktimi i qëllimeve dhe detyrave të punës, përcaktimi i planit individual për përsosje profesionale, si dhe procedura për vlerësim të efektit të dhënësit të shërbimeve publike.

Neni 225

Qëllimet dhe detyrat e punës për të punësuarin nga grupi i dhënësve të shërbimeve publike në mbrojtjen sociale nga ky ligj, përcaktohen në bazë të programit vjetor për punë të institucionit për mbrojtje sociale.

Qëllimet dhe detyrat e punës së dhënësve të shërbimeve publike duhet të jenë të qarta, precize, me masë dhe me përcaktimin e kornizës kohore për realizim.

Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga koordinatori i seksionit, ndërsa në rast kur nuk ka udhëheqës epror të drejtpërdrejtë, nga drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale në bashkëpunim

me dhënësin e shërbimeve publike në fund të procedurës së vlerësimit të arritjeve të punës, në dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Neni 226

Në planin individual për përsosje profesionale përcaktohet nevoja për përsosje profesionale të dhënësit të shërbimeve publike, për shkak të realizimit efikas të realizimit të qëllimeve dhe detyrave të punës dhe nevoja nga zhvillimi dhe avancimi i kompetencave të punës.

Plani individual për përsosje profesionale përcaktohet nga koordinatori i seksionit epror i drejtpërdrejtë, ndërsa në rast kur nuk ka udhëheqës epror të drejtpërdrejtë "nga drejtori i institucionit, në bashkëpunim me dhënësin e shërbimeve publike, në vendosjen e qëllimeve dhe detyrave të punës.

Neni 227

Koordinatori i seksionit epror i drejtpërdrejtë "ndërsa në rast kur nuk ka udhëheqës epror të drejtpërdrejtë, drejtori i institucionit është i detyruar në vazhdimësi ta ndjekë efektin e dhënësit të shërbimeve publike gjatë tërë vitit dhe sipas nevojës të propozojë masa për përmirësimin e tij.

Si pjesë e procesit të ndjekjes së vazhdueshme të efektit të dhënësit të shërbimeve publike, më së voni deri më 30 qershor të vitit, zbatohet intervistë gjysmëvjetore.

Pas zbatimit të intervistës gjysmëvjetore plotësohet raporti për intervistën gjysmëvjetore, të cilin e nënshkruajnë dhënësi i shërbimeve publike dhe udhëheqësi i seksionit epror i tij i drejtpërdrejtë, ndërsa në rast kur nuk ka udhëheqës seksioni, drejtori i institucionit.

Kopje nga raporti i paragrafit 3 të këtij neni i dorëzohet dhënësit të shërbimeve publike.

Nëse në raportin për intervistë gjysmë vjetore, koordinatori i seksionit epror i drejtpërdrejtë, kurse në rast kur nuk ka udhëheqës, drejtori i institucionit përcakton se dhënësi i shërbimeve publike nuk i ka përmbyshur qëllimet e caktuara përkatësisht tregon rezultate të pakënaqshme gjatë periudhës gjysmëvjetore, nuk tregon profesionalizëm të nevojshëm dhe kompetencë, ka gabime të konsiderueshme në punën dhe veprimet, detyrat e punës i realizon jo në kohë përkatësisht nuk tregon interes për kualitetin e realizimit të detyrave të punës, ai do të fillojë procedurë për përmirësimin e efektit.

Në procedurën për përmirësimin e efektit propozohen trajnime plotësuese ose mentorim dhe shqiptohet vërejtje me shkrim në të cilin dhënësi i shërbimeve publike paralajmëron për mundësinë të jetë i vlerësuar me notë negative nëse edhe përkrah sugjerimeve dhe masave të shqiptuara, deri në fund të vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nuk e përmirëson efektin e vet.

Neni 228

Dhënësit e shërbimeve publike, detyrimisht vlerësohen një herë në vit, edhe atë më së voni deri më 1 dhjetor për vitin rrjedhës.

Vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike e kryen udhëheqësi i seksionit epror i drejtpërdrejtë kurse në rast kur nuk ka udhëheqës të seksionit, drejtori i institucionit (në tekstin e mëtejme: vlerësues).

Vlerësuesi me nota "1", "2", "3", "4" ose "5" e vlerëson punën e dhënësit të shërbimeve publike në lidhje me kualitetin, efektivitetin dhe efikasitetin e punës, respektimin e afateve dhe nivelin e përmbyshjes së qëllimeve të përcaktuara të punës dhe detyrave, nivelin e përfshirjes dhe përkushtimit të punës, kontributin në realizimin e programit për punë të institucionit, realizimin e planit individual për përsosje profesionale dhe sjelljen e dhënësit të shërbimeve publike, kurse e merr parasysh edhe raportin e intervistës gjysmëvjetore.

Vlerësimi vjetor i dhënësit të shërbimeve publike merret në bazë të vlerësimit të vlerësuesit, me faktor peshe prej 60%, si dhe nga nota mesatare e dy dhënësve të tjerë të shërbimeve publike në institucion me të cilët i vlerësuari punon në mënyrë të drejtpërdrejtë (në tekstin e mëtejme: vlerësues tjerë), me faktor peshe nga 40%.

Vlerësuesit tjerë i zgjedh dhënësi i shërbimeve publike në marrëveshje me vlerësuesin e tij dhe ata me nota "1", "2", "3", "4" ose "5" i vlerësojnë kompetencat e përgjithshme të punës dhënësit të shërbimeve publike, dhe propozojnë mënyra të përmirësimit të punës të dhënësit të shërbimeve publike.

Vlerësuesit nga paragrafi 5 i këtij neni janë të detyruar në formular të përcaktuar në koordinim me drejtorin e institucionit publik për mbrojtje sociale, t'i vlerësojnë dhënësit e shërbimeve publike dhe më së voni deri më 1 nëntor t'ia dorëzojnë formularët për vlerësim.

Për zbatimin e vlerësimit nga vlerësues të tjerë, drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale, më së voni deri më 1 tetor është i detyruar të miratojë aktvendim në të cilin do të shënojë kohën dhe vendin e zbatimit të vlerësimit dhe do të formojë komision për zbatimin e vlerësimit.

Pas përfundimit të vlerësimit, kopje e formularit për vlerësim, përveç pjesës që ka të bëjë me notat individuale të vlerësuesve të tjerë, i dorëzohet edhe dhënësit të shërbimeve publike.

Kundër notës së efektit, dhënësi i shërbimeve publike i pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditë pas pranimit të kopjes së formularit për vlerësim.

Drejtori i institucionit publik për mbrojtje sociale është i detyruar të përgatisë dhe më së voni deri më 31 dhjetor te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të dorëzojë raport me rang listë të notave vjetore për të gjithë të vlerësuarit dhënës të shërbimeve publike në institucion për vitin rrjedhës.

Mënyrën e zbatimit të intervistës gjysmë vjetore dhe vlerësimin e dhënësve të shërbimeve publike në institucionet publike për mbrojtje sociale, si dhe formularin e raportit për intervistën gjysmëvjetore dhe formularin për vlerësim, i përcakton ministri.

Neni 229

Dhënësi i shërbimeve publike i cili gjatë vitit për të cilin kryhet vlerësimi, ka munguar nga puna më shumë se gjashtë muaj (pushim mjekësor, pushim pa pagesë dhe të tjera), si dhe dhënësi i shërbimeve publike i cili për herë të parë është punësuar në institucionin publik për mbrojtje sociale dhe ka punuar më pak se gjashtë muaj në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi, nuk do të vlerësohet.

Vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike, i cili gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nëpërmjet procedurës së mobilitetit janë sistemuar, përkatësisht marrë në vende tjera të punës, e kryen vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

Nëse vlerësuesi gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi, e ndryshon vendin e punës, ose i pushon marrëdhënia e punës, vlerësimin e dhënësit të shërbimeve publike me të cilat udhëhequr, e kryen vlerësuesi i ri, në bazë të raportit me shkrim nga vlerësuesi paraprak.

Neni 230

Vlerësimi vjetor i dhënësit të shërbimeve publike mund të jetë:

- "posaçërisht dallohet", nëse ka vlerë nga 4,51 deri më 5,00,
- "dallohet", nëse ka vlerë nga 3,51 deri më 4,50,
- "mjafton", nëse ka vlerë nga 2,51 deri më 3,50,
- "pjesërisht mjafton", nëse ka vlerë nga 1,51 deri më 2,50 dhe
- "nuk mjafton", nëse ka vlerë nga 1,00 deri më 1,50.

Neni 231

Dhënësit e shërbimeve publike të cilët janë vlerësuar me notën vjetore "posaçërisht dallohet", do të shpërblehen me tri ditë të lira.

Në rast kur për shkak të nevojave të punës nuk do t'i shfrytëzojnë ditët e lira, u paguhet kompensim në pajtim me ligj.

6. Pushim i marrëdhënies së punës

Neni 232

Dhënësit të shërbimit publik i pushon marrëdhënia e punës:

- me kërkesë të tij
- me marrëveshje,
- me fuqi të ligjit dhe
- në raste të tjera të përcaktuara me këtë dhe me ligj tjetër dhe me marrëveshje kolektive.

Të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës në institucion nëse parashtron kërkesë me shkrim për pushim të marrëdhënies së punës.

Në rast të pushimit të marrëdhënies së punës pas kërkesës së të punësuarit, afati i largimit zgjat 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për marrëdhënien e punës.

Neni 233

Të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës me fuqi të ligjit nëse:

- e humb aftësinë e punës në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktimin e aftësisë së humbur për punë,

- i pushon shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ditën e dorëzimit të aktvendimit për lëshimin nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- të jetë i dënuar për vepër penale në lidhje me detyrën zyrtare në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- i është shqiptuar ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- për shkak të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, në ditën e fillimit të vuajtjes së dënimit,

- mungesë të paarsyeshme nga puna së paku tri ditë pune të njëpasnjëshme në një muaj,

- është përcaktuar se gjatë punësimit ka heshtur ose ka dhënë të dhëna të rrejshme në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për punësim,

- në afat prej tri ditësh nuk është kthyer në punë pas përfundimit të mungesës pa pagesë,

- organi i administratës shtetërore kompetent për mbikëqyrjen inspektuese në afat prej një viti përcakton se i punësuarit është punësuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe kushte të tjera në pajtim me ligjin.

Të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës nëse është vlerësuar me notë "nuk mjafton" dy herë radhazi ose së paku tri herë në pesë vjetët e fundit.

Punëtorit profesionist i pushon marrëdhënia e punës nëse pas përfundimit të punës provuese nuk pajiset me licencë për punë në institucionin për mbrojtje sociale, në pajtim me këtë ligj.

Neni 234

Aktvendimin për pushim të marrëdhënies së punës së të punësuarit e miraton drejtori.

Aktvendimi për pushimin e marrëdhënies së punës i dorëzohet personalisht të punësuarit në hapësirat e punës së institucionit në të cilët punon, përkatësisht në adresë të vendbanimit të tij.

Nëse i punësuarit nuk mund të gjendet në adresë të vendbanimit ose nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi shpallet në tabelën për shpallje të institucionit edhe pas kalimit të tetë ditëve konsiderohet se aktvendimi është dorëzuar.

Kundër aktvendimit i punësuarit ka të drejtë në afat prej tetë ditëve të parashtrijë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 235

Punë të caktuara në mbrojtjen sociale, me autorizim të drejtorit të institucionit për mbrojtje sociale, pa kompensim mund t'i kryejnë vullnetarët, të cilët janë të kualifikuar për atë lloj të punës ose kanë kaluar nëpër trajnime për kryerjen e asaj pune.

Vullnetari nuk mund të vendosë për të drejtat nga mbrojtja sociale.

Punët të cilët mund të kryhen me punë vullnetare, mënyrën e kryerjes së tyre, si dhe kualifikimet e nevojshme ose trajnimet, i përcakton me akt institucioni për mbrojtje sociale, në pajtim me ligjin.

7. Licencimi i personave profesionistë dhënës së shërbimeve publike në institucione për mbrojtje sociale dhe si dhe te dhënës të tjerë të shërbimeve sociale

Neni 236

Personat profesionistë dhënës të shërbimeve publike të punësuar në institucionet publike dhe private për mbrojtje sociale dhe te dhënës të tjerë të shërbimeve sociale duhet të posedojnë licencë për kryerjen e punëve profesionale në veprimtarinë e mbrojtjes sociale.

Licenca nga paragrafi 1 i këtij neni jepet me vlefshmëri për periudhën prej pesë vjetëve, edhe atë si:

- licencë të përgjithshme për kryerjen e punëve sociale, juridike, pedagogjike dhe psikologjike profesionale në qendrën për punë sociale,

- licencë e përgjithshme për kryerjen e punëve profesionale në institucion për mbrojtje jashtë familjare, qendra për shërbime sociale, qendra për përkrahjen e familjeve kujdestare dhe dhënës të tjerë të shërbimeve sociale për mbrojtje jashtëfamiljare dhe shërbime në bashkësi,

- licencë e posaçme për udhëheqës të rastit në qendrën për punë sociale dhe

- licencë e specializuar për kryerjen e punëve profesionale në mbrojtje sociale edhe atë: edukim për kujdes, supervizion në qendrën për punë sociale, këshillim dhe punë këshilluese-terapeutike.

Personat profesionistë fitojnë licencën e specializuar për kryerjen e punëve profesionale në mbrojtjen sociale nëse posedojnë licencë të përgjithshme nga paragrafi 2, alinea 1 dhe 3 të këtij neni.

Licenca për punë e punëtorit profesionist paraqet dokument publik për punë dhe fitohet në hapësirat e punës të punëtorit profesionist.

Neni 237

Punëtorit profesionist i jepet licencë për punë, nëse:

- ka arsim të lartë me së paku 180 kredi të fituara sipas SETK-së ose shkalla e VII/1 e mbaruar,

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit veprimtarisë ose detyrës derisa vazhdojnë pasojat nga ndalimi,

- ka përfunduar edukimin fillestar të kryer në pajtim me Programin për edukimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve profesionistë në insitucionin për mbrojtje sociale dhe te dhënës të tjerë të shërbimeve sociale, dhe

- e ka dhënë provimin profesional.

Neni 238

Punëtori profesionist deri në marrjen e licencës për punë, ndërsa më së voni në afat prej gjashtë muajve nga punësimi i tij, detyrimisht duhet të kalojë edukim fillestar nga neni 237 paragrafi 1 alinea 4 të këtij ligji.

Punëtorit profesionist, i cili pas skadimit të 12 muajve nga punësimi i tij nuk siguron licencë për punë, i ndërpritet marrëdhënia e punës në institucion për mbrojtje sociale.

Neni 239

Pas mbarimit të edukimit fillestar nga neni 238 i këtij ligji, punëtori profesionist parashtron kërkesë për dhënien e provimit te Komisioni për Licencim, nëpërmjet Entit për Veprimtari Sociale, së bashku me dëshmitë për përmbushjen e kushteve për dhënien e provimit të përcaktuar me këtë ligj.

Nëse kandidati nuk i plotëson kushtet për dhënien e provimit Enti për Veprimtari Sociale, në bazë të mendimit të Komisionit për Licencim, miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për dhënien e provimit kundër të cilit mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditëve te Ministria.

Neni 240

Punëtori profesionist jep provimin profesional për marrjen e licencës për punë, në varësi nga detyrat e punës që i kryen, edhe atë:

- provim të përgjithshëm profesional për punëtor profesionist për kryerjen e punëve profesionale në qendrën për punë sociale,

- provimi i përgjithshëm profesional për kryerjen e punëve profesionale në institucione për mbrojtje jashtëfamiljare, qendra për shërbime sociale, qendra për përkrahjen e familjeve kujdestare dhe dhënës tjerë të shërbimeve sociale për mbrojtje jashtëfamiljare dhe shërbime në bashkësi,

- provimin e posaçëm për licencë për udhëheqës të rastit dhe

- provimin e specializuar profesional për punëtor profesionist për kryerjen e edukimit për përkujdesje, supervizion në qendrën për punë sociale, këshillimore dhe punë këshilluese - terapeutike.

Provimi profesional përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike.

Nëse punëtori profesionist nuk e jep provimin profesional, mund ta japë edhe një herë në afat prej gjashtë muajve.

Provimi profesional jepet sipas programit në të cilin përmbahen të gjitha materialet për përgatitjen e provimit dhe mënyrën e dhënies së provimit.

Programi për dhënien e provimit e miraton Enti për Veprimtari Sociale me propozim të Komisionit për Licencim.

Neni 241

Punëtorit profesionist i ripërtërihet licenca për punë, nëse ka marrë së paku 60 pikë në pajtim me Programin për edukim të vazhdueshëm të punëtorëve profesionistë në institucionet për mbrojtje sociale dhe te dhënës të tjerë të shërbimeve sociale, edhe atë: - së paku 40 pikë nga trajnimet e detyrueshme dhe

- së paku 20 pikë nga aktivitetet plotësuese profesionale me zgjedhje të punëtorit profesionist.

Punëtori profesionist së paku tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së licencës parashtron kërkesë për Komisionin për Licencim për ripërtëritje të licencës për punë.

Neni 242

Punëtorit profesionist i cili për arsye të arsyeshme (sëmundje, lehon, pushim të paguar ose pa pagesë dhe të ngjashme) nuk i ka plotësuar kushtet nga neni 241 të këtij ligji, Komisioni për Licencim do të vazhdojë licencën për punë me kërkesën e tij për gjashtë muajt e ardhshëm pas kthimit në punë, në cilën periudhë duhet ta mbarojë edukimin e detyrueshëm dhe e jep provimin profesional, përkatësisht ta mbarojë edukimin e vazhdueshëm.

Neni 243

Punëtorit profesionist i merret licenca për punë, nëse:

- nuk i plotëson kushtet nga neni 241 i këtij ligji për ripërtëritje të licencës,
- i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të shkeljes disiplinore dhe
- gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale konstatohet se punëtori profesionist në kryerjen e punëve vepron në kundërshtim me Kodeksin etik për punëtorët profesionistë në veprimtarinë e mbrojtjes sociale.

Enti për Veprimtari Sociale te Komisioni për Licencim dorëzon propozim për marrjen e licencës për punë, për rrethana të konstatuara nga paragrafi 1 alineja 3 të këtij neni.

Komisioni për Licencim menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tri ditëve e njofton drejtorin e institucionit për mbrojtje sociale ose dhënësin tjetër të shërbimit social për licencën e hequr të punëtorit profesionist.

Neni 244

Enti për Veprimtari Sociale jep, ripërtërinë, vazhdon dhe heq licencë për punë punëtorëve profesionistë në institucione për mbrojtje sociale dhe dhënësve të tjerë të shërbimeve sociale, mban regjistër për licenca të dhëna, të ripërtëritja, të vazhduara dhe të hequra dhe zbatimin e provimit profesional në procedurën për dhënie dhe ripërtëritjen e licencave.

Për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, Enti për Veprimtari Sociale formon Komision për Licencim, me pajtim paraprak të ministrit.

Komisioni për licencim është i përbërë prej nëntë anëtarëve edhe atë: tre përfaqësues nga Enti për Veprimtari Sociale, tre përfaqësues nga institucionet e larta arsimore për punë sociale dhe politikë sociale dhe tre përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, me mandat prej 4 vjetëve.

Në punën e komisionit mund të përfshihen edhe anëtarë të jashtëm nga radhët e dhënësve të trajnimeve, në procesin e përgatitjes së çështjeve për provim profesional.

Komisioni për Licencim zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin nga radhët e anëtarëve të Entit për Veprimtari Sociale.

Neni 245

Komisioni për Licencim i ushtron këto punë:

- vendos për dhënie, ripërtëritjen, vazhdimin dhe marrjen e licencave për punë,
- e zbaton provimin profesional,
- miraton Rregullore për punë,
- mban evidencës për pjesëmarrjet në trajnim dhe aktivitetet plotësuese profesionale të punëtorëve profesionistë dhënës të shërbimeve sociale,
- i përpilon çështjet për provimin profesional dhe
- i azhurnon çështjet për provimin profesional së paku një herë në vit.

Anëtarët të Komisionit për Licencim kanë të drejtë në kompensim vjetor në para në shumë prej më së shumti dy rroga mesatare neto të paguara në muaj në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të cilin e cakton ministri me aktvendim.

Neni 246

Enti për Veprimtari Sociale miraton aktvendim për licencë të lëshuar, vazhduar, ripërtëritur dhe licencë të hequr për punë, në bazë të vendimi të Komisionit për Licencim.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 këtij neni mund të deklarohet ankesë te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 247

Enti për Veprimtari Sociale formon Komision për Lejim të Programeve për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, pas pajtimit paraprak të ministrit.

Komisioni për Lejim të Programeve për Edukim të Vazhdueshëm Profesional është i përbërë prej pesë anëtarëve, edhe atë një përfaqësues nga Ministria, dy përfaqësues nga Enti për Veprimtari Sociale dhe dy përfaqësues nga institucioni i arsimit të lartë për punë sociale dhe politikë sociale, me së paku dhjet vjet përvojë pune në sferë.

Mandati i anëtarëve të Komisionit për Lejim të Zbatimi të Programi për Edukim të Vazhdueshëm Profesional është dy vjet me mundësi për rizgjedhje.

Anëtarët e Komisionit për Lejim të Programeve për Edukim të Vazhdueshëm Profesional kanë të drejtë kompensimi vjetor me para në shumë prej më së shumti dy rrogave mesatare neto të paguara në muaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, të cilin e cakton ministri me aktvendim.

Neni 248

Komisioni për Lejim të Programit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional zbaton procedurë dhe lejon program për edukim të vazhdueshëm profesional.

Komisioni e njofton Entin për veprimtari sociale për programet të lejuara, për shkak të futjes në regjistrin elektorin të programeve të lejuara për edukim profesional.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni së paku një herë në vit shpall ftesë publike në internet faqen e Ministrisë dhe të Entit për Veprimtari Sociale për lejim të programeve për edukim të vazhdueshëm profesional në veprimtarinë e mbrojtjes sociale.

Në ftesën publike theksohen kushtet, kriteret dhe afati për parashtrim të programeve dhe afati për shqyrtim të programeve.

Kriteret për lejim të programeve për edukim të vazhdueshëm profesional në veprimtarinë e mbrojtjes sociale dhe formën dhe përmbajtjen e regjistrit të programeve të lejuara për edukim profesional i përcakton ministri.

Neni 249

Shpenzimet për dhënie, ripërtëritje dhe vazhdim të licencës për punë dhe për mbajtje të evidencës janë në barë të punëtorit profesionist, në lartësi prej 2.000 denarësh, të harmonizuar me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura në Entin Shtetëror për Statistikë në janar për vitin rrjedhës.

Shpenzimet për edukim të vazhdueshëm profesional për dhënie dhe ripërtëritje të licencës për punëtorët profesionistë, të punësuar në institucionet publike të themeluara nga Qeveria, financohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa për punëtorët profesionistë, të punësuarit në institucionet publike të themeluara nga komuna e buxhetit të komunës.

Neni 250

Mënyrën e dhënies, vazhdimin, ripërtëritjes dhe marrjes së licencës për punë të punëtorëve profesionistë, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për punë i përcakton ministri.

Neni 251

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e punës së Komisionit për Licencim dhe Komisionit për Lejim të Programeve për Edukim të Vazhdueshëm Profesionist i ushtron Enti për Veprimtari Sociale.

Neni 252

Enti për Veprimtari Sociale formon Bord Etik të përbërë prej tre përfaqësuesve, prej të cilëve një nga Enti për Veprimtari Sociale, një nga Komisioni për Licencim dhe një përfaqësues nga institucionet publike për mbrojtje sociale.

Bordi Etik vepron pas shkresave dhe dijenive për veprim jopoetik të punëtorit profesionist në punën me shfrytëzues e cila është në kundërshtim me Kodeksin etik për punëtorë profesionistë.

Bordi Etik i kontrollon shkresat dhe dijenitë për veprim jopoetik të punëtorit profesionist, përpilon raport për gjendje të konstatuar i cili mund të përmbajë edhe propozim për marrje të licencave për punë të punëtorit profesionist, dhe të njëjtin e dorëzon te Komisioni për Licencim.

Bordi Etik miraton rregullore për punë.

8. Koha e punës në institucionet për mbrojtje sociale

Neni 253

Orarin, fillimin dhe përfundimin e kohës së punës në institucionin publik, varësisht nga lloji dhe vëllimi i mbrojtjes sociale dhe shërbime nga mbrojtja sociale, me aktvendim e përcakton ministri

9. Evidenca në institucionet për mbrojtje sociale

Neni 254

Institucioni për mbrojtje sociale mban evidencë për shfrytëzuesit e të drejtave nga mbrojtja sociale dhe dokumentacioni për punë profesionale.

Evidenca për shfrytëzuesit përmban të dhëna për numrin unik amë të qytetarit, gjininë, adresën e banimit dhe të dhëna tjera për shfrytëzuesin dhe anëtarët të familjes së tij, përkatësisht amvisërisë, ndërsa të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit personal dhe gjendjes së rrezikut social.

Në grumbullimin, përpilimin, shfrytëzimin, këmbimin dhe ruajtjen e të dhënave për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale zbatohen rregulla nga sfera e mbrojtjes së të dhënave personale.

Mënyrën e mbajtjes dhe përmbajtjen e evidencës dhe dokumentacionit nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton ministri.

Neni 255

Evidenca për shfrytëzuesit mbahet për persona të cilët kanë realizuar të drejtë ose shërbim në pajtim me ligj, edhe atë nga:

- mbrojtja sociale,
- mbrojtja e fëmijëve,
- mbrojtja familjare-juridike,
- invaliditet civilë,
- dhuna familjare dhe
- rregullat penale-juridike.

Evidenca për shfrytëzuesit e të drejtave në para nga mbrojtja sociale përmban të dhëna për të drejtë të realizuar të:

- ndihmës së garantuar minimale,
- kompensimit për shkak të pengesës,
- kompensimit për ndihmë dhe kujdes të personit tjetër,
- kompensimit për rrogë për kohë të shkurtuar të punës,
- shtesës për banim,
- kompensimit të përhershëm dhe
- ndihmës së njëhershme në para.

Kreu X.

REFUNDIMI I MJETEVE PËR BLERJE BLERJE TË AUTOMJETEVE TË UDHËTIMIT

Neni 256

Personi me pengesë të rëndë dhe më rëndë trupore, personi me pengesë mesatare, pengesë të rëndë dhe të thellë intelektuale, personi plotësisht i verbët me shoqërues dhe personi plotësisht i shurdhët mund të parashtrorj

kërkesë për refundim të mjeteve të paguara si taksa doganore, tatim i vlerës së shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit, të cilin do ta drejtojë parashtruesi i kërkesës ose bashkëshorti-ja e tij-saj, prindi, fëmija ose farefis tjetër i cili jeton me personin dhe ndërmjet tyre ekziston detyrë për mbajtje në pajtim me Ligjin për familje, përkatësisht kujdestar, ndërsa do të shfrytëzohet kryesisht për nevojat e personit për transport dhe integrim më të lehtë social në bashkësi.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet një herë në periudhë prej pesë vjetësh për blerje të automjetit të udhëtimit me vlerë të shitblerjes deri në 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, përkatësisht me vlerë të shitblerjes deri në 20.000 euro në kundërvlerë me denarë, nëse në automjet është futur pajisje plotësuese e cila mundëson që personi në mënyrë të pavarur ta drejtojë automjetin siç është marshi automatik ose gjysmëautomatik, komandat e dorës të cilat i zëvendësojnë komandat e këmbës, vinçi hidraulik për karrocë invalide ose barrierë për hipje për hyrje në automjet për çka dorëzohet edhe dëshmi nga kompani e autorizuar e cila e ka instaluar pajisjen e tillë të specializuar.

Lartësia e mjeteve të cilat refundohen për taksa të paguara doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit, mund të jetë më së shumti deri në 180.000 denarë.

Çmimi i shitblerjes së automjetit të udhëtimit i blerë jashtë vendit përcaktohet në bazë të dokumentit të lëshuar nga organi kompetent doganor në lidhje me të cilin paguhen taksat doganore.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet te Komisioni për Refundim të Mjeteve për Blerje të Automjetit të Udhëtimit, nëpërmjet qendrës kompetente për punë sociale.

Ministri formon Komision për Refundim të Mjeteve për Blerje të Automjeteve të Udhëtimit, të përbërë prej pesë anëtarëve prej të cilëve nga dy përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Financave dhe një përfaqësues nga Enti për Veprimtari Sociale, me mandat prej dy vjetësh.

Ministri miraton aktvendim për refundim të mjeteve për blerje të automjeteve të udhëtimit në bazë të mendimit paraprak të Komisionit nga paragrafi 6 i këtij neni.

Neni 257

Nëse personi të cilit i janë refunduar mjetet, të paguara si të taksa doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit, e tjetërson automjetin në periudhë prej pesë vjetësh pas marrjes së mjeteve, është i obliguar të njëjtat t'i kthejë me kamatë ligjore ndëshkuese, të llogaritur nga dita e pagesës në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rast të tjetërsimit të automjetit gjatë dëmtimit të krijuar në të njëjtën në lartësi më të madhe se 80% të vlerës së automjetit të përcaktuar me procesverbal nga vlerësues i autorizuar në momentin e krijimit të dëmit, si dhe në rast të tjetërsimit të automjetit pas vdekjes së parashtruesit të kërkesës, nuk do të ngrihet procedurë për kthim të mjeteve

të mara në bazë të refundimit të taksave të paguara doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit.

Neni 258

Qendra për punë sociale formon Komision për ushtrim të kontrollit në shtëpinë e parashtruesit të kërkesës, të përbërë prej tre personave profesionistë, të punësuar në qendër.

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni, gjatë parashtrimit të kërkesës e përcakton gjendjen faktike për mënyrën e shfrytëzimit të automjetit të udhëtimit, për çka përpilon procesverbal. Komisioni kërkesën me procesverbalin e dorëzon te Komisioni për refundim të mjeteve për blerje të automjeti të udhëtimit.

Komisioni për Refundim të Mjeteve për Blerje të Automjetit Motorik, në bazë të kërkesës, dokumentacionit të nevojshëm dhe procesverbalit të komisionit nga paragrafi 1 të këtij neni jep propozim te ministri për plotësimin e kushteve për refundim të mjeteve dhe miratim të aktvendimit sipas kërkesës.

Në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale mbahet evidencë për personat të cilët kanë parashtruar kërkesë për refundim të mjeteve për blerje të automjetit të udhëtimit, i cili përmban: emër, mbiemër, dhe numër unik amë të qytetarit parashtrues i kërkesës, konstatim dhe mendim të dhënë për shkallën e invaliditetit (numër, datë dhe institucion), datën e pranimit të kërkesës dhe datën e dhënies së aktvendimit ose njoftimit, në pajtim me rregullat nga sfera e mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 259

Komisioni për refundim të mjeteve për blerje të automjetit të udhëtimit, së paku një herë në vit kryen kontroll të shfrytëzimit të dedikuar të automjetit të udhëtimit për personin të cilit i janë refunduar mjetet e paguara si taksa doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të tij, nëpërmjet qendrës kompetente për punë sociale.

Nëse Komisioni për refundim të mjeteve për blerje të automjetit të udhëtimit përcakton se automjeti i udhëtimit nuk shfrytëzohet për nevoja personale për personin të cilit i janë refunduar mjetet, ndërsa në bazë të të dhënave të mara me kontroll nëpërmjet qendrës për punë sociale, Komisioni për Refundim të Mjeteve për Blerje të Automjetit të Udhëtimit jep propozim te ministri për miratimin e aktvendimi për kthim të mjeteve të pranuar pa bazë.

Kundër aktvendimit nga neni 256 paragrafi 7 të këtij ligji dhe aktvendimi nga paragrafi 2 i këtij neni mund të deklarohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Nëse personi të cilit i janë refunduar mjetet, të paguara si taksa doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit, nuk i kthen mjetet në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të parashtrorë padi te gjykata kompetente për kthim të mjeteve të pranuar me kamatë ligjore ndëshkuese.

Neni 260

Qeveria miraton Program vjetor për refundim të mjeteve të paguara si taksa doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit për persona me pengesë trupore të rëndë dhe më të rëndë, për persona plotësisht të verbët me përcjellës dhe për persona plotësisht të shurdhët, me të cilat rregullohen masat, bartësit, mënyra e zbatimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe mjetet e siguruar.

Refundimi i mjeteve të paguara si taksa doganore, tatim mbi vlerë të shtuar dhe akcizë për blerje të automjetit të udhëtimit për persona me pengesë trupore të rëndë dhe më të rëndë, për persona plotësisht të verbët me përcjellës dhe për persona plotësisht të shurdhët bëhet në korniza të mjeteve të siguruar për realizim të Programit vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni.

Kreu XI.**PROCEDURA PËR REALIZIM TË TË DREJTAVE TË MBROJTJES SOCIALE****1. Procedura për mbrojtje sociale**

Neni 261

Pas kërkesës për realizim të të drejtës për mbrojtje sociale në shkallë të parë vendos qendra për punës sociale kompetente për rajonin në të cilin parashtruesi i kërkesës ka vendbanim ose vendqëndrim.

Për ankesën kundër aktvendimit të qendrës për punë sociale vendos Ministria.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, për ankesën kundër aktvendimit të qendrës për punë sociale për të drejtën nga neni 27 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji vendos Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Ankesa nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, parashtrohet nëpërmjet qendrës kompetente për punë sociale.

Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Neni 262

Procedura për realizim të të drejtës së mbrojtjes sociale ngrihet pas kërkesës të qytetarit, përkatësisht përfaqësuesit të tij ligjor, kujdestar ose me detyrë zyrtare.

Qendra për punë sociale procedurën me detyrë zyrtare e ngre me iniciativë personale, me iniciativë të qytetarit, organit kompetent ose organeve të tjera dhe organizatave, kur kjo është në interes të qytetarit ose kur ekziston interes i personave të tretë.

Neni 263

Në procedurën për realizim të të drejtave nga mbrojtja sociale zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj më ndryshe nuk është e caktuar.

Neni 264

Parashtruesit të kërkesës i cili është gjendur në pozitë të rrezikut social jashtë nga rajoni në të cilin ka vendbanim, qendra për punë sociale kompetente për atë rajon do t'i sigurojë të drejtë adekuate të mbrojtjes sociale.

Për parashtruesin e kërkesës i cili në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka vendbanim, kompetenca vendore përcaktohet sipas vendqëndrimit.

Për parashtruesin e kërkesës me vendbanim të panjohur, kompetente është qendra për punë sociale në rajonin në të cilin personi është hasur.

Neni 265

Nëse parashtruesi i kërkesës është fëmijë, kompetenca vendore caktohet sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të prindërve ose kujdestarit.

Për fëmijën prindërit e të cilit nuk jetojnë së bashku, kompetenca vendore caktohet sipas vendbanimit të prindit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim.

Për fëmijë prindërit e të cilit nuk jetojnë së bashku, ndërsa procedura për besim të fëmijës në ruajtje dhe edukim të një nga prindërit nuk është zbatuar, kompetente është qendra në rajonin në të cilin fëmija është hasur në pozitë të rrezikut social.

Nëse prindërit e fëmijës nuk dihen, përkatësisht nëse e kanë lënë fëmijën ose janë me vendbanim të panjohur, përkatësisht vendqëndrim, kompetente është qendra për punë sociale në rajonin në të cilin fëmija është hasur në pozitë të rrezikut social.

Neni 266

Nëse rrethanat në bazë të të cilave është caktuar kompetenca vendore në pajtim me këtë ligj ndryshohen, procedurën do ta vazhdojë qendra vendore kompetente për punë sociale.

Nëse gjatë procedurës ose gjatë shfrytëzimit të të drejtës, kërkuesi, përkatësisht shfrytëzuesi i të drejtës për mbrojtje sociale e ndryshon vendbanimin, qendra për punë sociale është e obliguar lëndën e plotë ta dorëzojë te qendra kompetente për punë sociale në vendbanimin e ri, e cila ka obligim në afat prej 15 ditë të vendos për të drejtat e shfrytëzuesit.

Neni 267

Në rast të konfliktit për kompetencën vendore, qendra për punë sociale e cila e ka filluar procedurën, është e obliguar deri në përfundim të konfliktit t'i ndërmarrë punët e pashmangshme për shkak të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të shfrytëzuesit.

Konfliktin nga paragrafi 1 i këtij neni e zgjedh Ministria.

Neni 268

Personi i autorizuar zyrtar nga qendra për punë sociale i cili e mban procedurën është i obliguar në afat prej tri ditë nga dita e pranimit të kërkesës për realizim të të drejtës për mbrojtje sociale, me detyrë zyrtare të kërkojë dëshmi dhe të dhëna për të cilat evidencë zyrtare mban organi kompetent publik.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni është i obliguar t'i dorëzojë dëshmitë e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Dispozitat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe gjatë grumbullimit të dëshmimeve nga nenet 122 paragrafi 1 alineja 6, 186 paragrafi 2 pika 2, 211 paragrafi 1 alineja 4 dhe 325 paragrafi 1 alineja 4 të këtij ligji.

Neni 269

Qendra për punë sociale, në procedurat për realizim dhe shfrytëzim të të drejtave nga mbrojtja sociale, për shfrytëzuesit dhe anëtarët të familjes/amvisërisë të tyre në formë elektronike grumbullojnë të dhëna për pronën e patundshme nga Sistemi gjeodezik i informatave kadastrale i Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive.

Qendra për punë sociale të gjitha dokumentet të cilat përmbajnë bazë juridike në bazë të të cilave bëhet regjistrimi në kadastrën e patundshmërive, së bashku me fletëparaqitjet për regjistrim dhe dëshminë për kompensim të paguar, i dorëzojnë në formë elektronike te Agjencia për Kadastër të Patundshmërive e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 270

Me kërkesë të qendrës për punë sociale personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar të dorëzojnë të dhëna dhe dokumentacion që paraqesin dëshmi për realizim të të drejtave të shfrytëzuesve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 271

Të drejtat për ndihmë në para nga mbrojtja sociale realizohen nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Të drejtat për ndihmë në para nga mbrojtja sociale pushojnë me ditën e pushimit të kushteve për shfrytëzim të të drejtës.

Neni 272

Parashtruesi i kërkesës është përgjegjës për vërtetësinë e të dhënave në kërkesë.

Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor ose kujdestari është i obliguar që qendrën kompetente për punë sociale ta njoftojë për çdo ndryshim të fakteve ose rrethanave të cilat ndikojnë në shfrytëzimin e të drejtës dhe kanë qenë bazë për njohjen e të drejtës për mbrojtje sociale, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita kur janë krijuar ato ndryshime.

Nëse parashtruesi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor ose kujdestari nuk vepron në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, i pushon e drejta.

Neni 273

Qendra për punë sociale me detyrë zyrtare përkohësisht, ndërsa më së paku një herë në vit e rikontrollon ekzistimin e fakteve dhe kushtet për fitim dhe shfrytëzim të të drejtës për mbrojtje sociale dhe nëse përcakton se ato janë të ndryshuara, miraton aktvendim të ri.

Neni 274

Para se të vendosë për të drejtat e mbrojtjes sociale qendra për punë sociale qytetarit i sugjeron ndihmë profesionale gjatë parashtrimit të kërkesës dhe për mundësinë të realizojë të drejta në bazë të rregullave tjera.

Qendra për punë sociale e përcakton nevojën për realizim të të drejtave nga mbrojtja sociale dhe shfrytëzimi i shërbimeve sociale në bazë të kontrollit të drejtpërdrejtë të kryer në amvisërinë e shfrytëzuesit.

Qendra për punë sociale për shfrytëzues të të drejtave të ndihmës në para nga mbrojtja sociale përcakton nevojën nga shfrytëzimi i shërbimeve sociale në bazë të kontrollit të drejtpërdrejtë të kryer në amvisërinë e shfrytëzuesit, në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të aktvendimit.

Neni 275

Qendra për punë sociale gjatë procedurës për realizim të të drejtave të mbrojtjes sociale përpilon plan individual.

Në planin individual caktohen qëllimet të cilat planifikohet të arrihen dhe masat dhe aktivitetet të cilat ndërmerren për ndihmë të shfrytëzuesit dhe anëtarëve të familjes së tij, bartësit e masave dhe koha për zbatimin e tyre.

Gjatë përpilimit të planit individual nga paragrafi 1 i këtij neni, qendra për punë sociale bashkëpunon me shfrytëzuesin dhe anëtarët e familjes së tij, ndërsa pas nevojës edhe me persona të tjerë dhe institucione për shkak të aktivimit dhe sigurimit të shërbimeve sociale.

Neni 276

Punëtorët profesionistë në punën me shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale e zbatojnë qasjen e mbajtjes së rastit.

Neni 277

Udhëheqësi i rastit zgjidhet nga radhët e punëtorëve profesionistë në qendrën për punë sociale për çdo shfrytëzues individualisht, në varësi nga lloji i problemit social me të cilin ballafaqohet individi ose familja.

Neni 278

Udhëheqësi i rastit është i obliguar të përpilojë plan individual në bazë të vlerësimit paraprak profesional, në bashkëpunim me individin ose familjen, si dhe persona të tjerë profesionistë nga institucione sociale, shëndetësore, arsimore dhe trupa dhe organe të tjera shtetërore, shoqata dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë.

Neni 279

Plani individual realizohet nga udhëheqësi i e rastit dhe shfrytëzuesi, me përfshirjen e personave të tjerë profesionistë dhe familjes.

Neni 280

Udhëheqësi i rastit është përgjegjës për zbatimin e planit për shërbime dhe organizim të takimeve ekipore me personat profesionistë, të përfshira në realizimin e planit.

Neni 281

Si dokumentacion zyrtar të cilin gjatë procedurës e përpilon dhe për të cilin vendos qendra për punë sociale, krahas dokumentacionit të përcaktuar me ligj, konsiderohet

edhe plani individual, lista e shfrytëzuesit, konstatimi dhe mendimi i punëtorit profesionist, përkatësisht konstatimi dhe mendimi i udhëheqësit të rastit dhe konstatimi dhe mendimi i ekipit profesional.

Në rast kur udhëheqësi i rastit përfshin persona të tjerë profesionistë, si dhe në rast kur veprimi i ekipit profesional është paraparë me ligj, si dokumentacion zyrtar përpilohet konstatimi dhe mendimi i ekipit profesional.

Qendra për punë sociale është e obliguar ta përpilojë dokumentacionin zyrtar nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës.

Konstatim dhe mendim i punëtorit profesionist dhe listë e shfrytëzuesit nuk përpilohet për shfrytëzues të të drejtës së kompensimit në para për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër dhe e drejta e kompensimit në para për shkak të pengesës.

Neni 282

Qendra për punë sociale në procedurën për realizim të të drejtës së mbrojtjes sociale është i obliguar të miratojë aktvendim në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 283

Ministri në procedurat në të cilat vendos në shkallë të parë është i obliguar të miratojë aktvendim në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 284

Qendra për punë sociale lëshon vërtetim ose certifikatë për statusin e shfrytëzuesit të mbrojtjes sociale në pajtim me evidencën zyrtare në afat prej dhjetë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 285

Konstatimi, vlerësimi dhe mendimi për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër, mendim konziliar dhe konstatim për kompensim për shkak të pengesës, me zgjedhje të rastësishme i nënshtrohen revizionit.

Mënyrën e ushtrimit të revizionit nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i Shëndetësisë në pajtim me ministrin e Punës dhe Politikës Sociale.

Nëse pas revizionit të kryer miratohet mendim i cili është në kundërshtim me konstatimin, vlerësimin dhe mendimin për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër ose mendim konziliar dhe konstatim për kompensim për shkak të pengesës, qendra për punë sociale është e obliguar të veprojë sipas mendimit dhe të miratojë aktvendim për pushimin e të drejtës.

Neni 286

Në procedurën për vendosje për shfrytëzimin e shërbimit në shtëpi ose shërbim në bashkësi, qendra për punë sociale e merr parasysh zgjedhjen e shfrytëzuesit për dhënësin e autorizuar të shërbimit.

Neni 287

Fëmija shfrytëzon shërbimin për përkujdesje të përkohshme dhe jashtë familjes, vetëm në bazë të aktvendimit të qendrës për punë sociale.

Prindi ose kujdestari i fëmijës, nuk mund drejtpërdrejtë të zgjedhë, as të pajtohet që fëmija të shfrytëzojë shërbim i cili përfshin qëndrim të përkohshëm dhe përkujdesje jashtë familjes.

Neni 288

Institucioni publik për mbrojtje sociale mundet drejtpërdrejtë t'u japë shërbime shfrytëzuesve në bazë të marrëveshjes së lidhur.

Ministri me aktvendim e përcakton numrin e shfrytëzuesve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 289

Institucioni privat për mbrojtje sociale, përkatësisht dhënësi i autorizuar i shërbimeve sociale mundet drejtpërdrejtë të kontrakttojë dhënie të shërbimeve, përveç për kapacitetet me të cilat institucioni, përkatësisht dhënësi i shërbimit nuk mund lirshëm të disponojë, të përcaktuara me marrëveshjen administrative.

Institucioni për mbrojtje sociale dhe dhënësi i autorizuar i shërbimeve sociale janë të obliguar te ministri të dorëzojnë të dhëna për shërbime kontraktuese në mënyrë dhe në afat të përcaktuar me marrëveshjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Neni 290

Shfrytëzuesi i shërbimit social, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor mundet në mënyrë të drejtpërdrejtë të zgjedh shërbim social të cilin e jep institucioni për mbrojtje sociale, përkatësisht dhënësi i licencuar i shërbimit social me të cilin do të lidhet marrëveshje për shfrytëzim të shërbimeve dhe pa aktvendim të Qendrës për Punë Sociale.

Për shfrytëzimin e shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni, shpenzimet janë në barë të shfrytëzuesit.

Kujdestari i personit me aftësi të hequr afariste, është i obliguar ta njoftojë qendrën për punë sociale për shfrytëzimin e shërbimi të mbrojtjes jashtë familjes në bazë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë, në afat prej 15 ditësh pas lidhjes së marrëveshjes.

2. Procedura të cilat mbahen në qendrën për punë sociale në pajtim me rregulla tjera

Neni 291

Procedurën për pajtim të bashkëshortëve e zbaton qendra për punë sociale e cila ka kompetencë vendore në rajonin e komunës, për të cilën është kompetente gjykata vendore para se ta mbajë procedurën për shkurorëzim për lëndën e njëjtë.

Neni 292

Në procedurën për pajtim, bashkëshortët ftohen të marrin pjesë personalisht, me ç'rast është përjashtuar publiku dhe prania e të autorizuarit.

Neni 293

Qendra për punë sociale është e obliguar pa prolongim të dorëzojë te gjykata kompetente raport me shkrim për rezultatin e procedurës për pajtim.

Neni 294

Në procedurën për rregullim të marrëdhënieve personale të fëmijës me prind me të cilin nuk jeton së bashku, prindërit ftohen të marrin pjesë personalisht, me ç'rast është përjashtuar publiku dhe prania e të autorizuarit.

Neni 295

Qendra për punë sociale në bazë të konstatimit dhe mendimit nga organ kompetent miraton aktvendim për llojin dhe shkallën e pengesës dhe e evidenton personin me pengesa në zhvillim.

Mënyrën e përcaktimit të llojit dhe shkallën e pengesës i përcakton ministri, në pajtim me ministrin e Arsimit dhe Shkencës dhe ministrin e Shëndetësisë.

Me rregulloren nga paragrafi 2 i këtij neni rregullohet profili profesional i anëtarëve të organit profesional që jep konstatim dhe mendim për vlerësim të llojit dhe shkallës së pengesës dhe nevojat e veçanta të personave me pengesa, organit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, mënyra dhe procedura për vlerësim të nevojave të veçanta, mbajtja e evidencës për nevojat e veçanta për këto persona dhe institucionet të cilat formojnë organe profesionale të cilat japin konstatim dhe mendim.

Revizion të konstatimit dhe mendimit nga organi i shkallës së parë kryen komisioni i formuar nga ministri, i përbërë prej tre anëtarëve - doktorë të mjekësisë.

Nëse gjatë revizionit të konstatimit dhe mendimit të organit të shkallës së parë konstatohet se ai nuk është adekuat në gjendjen e përcaktuar faktike të shëndetit dhe dokumentacionit mjekësor në bazë të të cilit ai është dhënë, komisioni nga paragrafi 4 i këtij neni, parashtrohet kallëzim penal për dijeni për vepër të kryer penale, kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes ose iniciativë për ngritje të procedurës disiplinore të organi kompetent.

Neni 296

Në rastet kur personi i moshës madhore i cili ka pronë ose të hyra nga prona, i cili e tejkalon lartësinë e të drejtës së ndihmës së garantuar minimale ose të drejtën e sigurisë sociale për personat e moshuar dhe ka parashtuar kërkesë për realizim të shërbimit për mbrojtje jashtë-martësore, qendra për punë sociale me personin mund të lidh; marrëveshje për përkujdesje jetësore në pajtim me ligj, ndërsa pas pajtimit paraprak të Ministrisë.

Në kërkesë të personit nga paragrafi 1 i këtij neni qendra mundet përkohësisht ta vendosë në familje të përkujdesjes.

Neni 297

Qendra për punë sociale mund të themelojë fondacion me qëllim prona e fituar në bazë të marrëveshjes së lidhur për përkujdesje jetësore ose bazë tjetër, të shfrytëzohet për realizimin e mbrojtjes sociale të qytetarëve në komunën dhe në qytetin e Shkupit, për rajonin e të cilit është kompetente qendra për punë sociale.

Bordi drejtues i fondacionit nga paragrafi 1 i këtij neni e përbëjnë tre anëtarë prej të cilëve dy përfaqësues nga qendra për punë sociale dhe një përfaqësues i emëruar nga këshilli i komunës dhe Këshilli i qytetit të Shkupit në rajonin e të cilit është selia e qendrës për punë sociale.

Themelimi, udhëheqja, menaxhimi dhe procedura për mbikëqyrje të punës së fondacionit rregullohet në pajtim me ligj.

Neni 298

Nëse personi i moshuar, pa forcë, i paaftë, invalid dhe fëmijë ka anëtarë të familje i cili nuk e mban këtë person, ndërsa i cili në pajtim me Ligjin për familje është i obliguar ta mbajë, qendra personit do t'i sigurojë të drejtë të ndihmë të garantuar minimale ose shërbim nga mbrojtja sociale, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka parashtuar padi për mbajtje ligjore, qendra për punë sociale me autorizim nga personi ngre procedurë për realizim të të drejtës për mbajtje ndaj personave të cilët sipas ligji janë të obliguar ta mbajnë.

Pas aktgjykimit të miratuar të plotfuqishëm me të cilin është caktuar mbajtja ligjore në procedurën nga paragrafi 2 i këtij neni, personi nga paragrafi 1 i këtij neni, është i obliguar t'i kthejë mjetet e paguara në emër të mbajtjes nga anëtarë i familjes, ndërsa më së shumti deri në shumën e të drejtës së paguar të ndihmës në para si dhe shpenzimet për shërbimin e dhënë nga mbrojtja sociale, në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 299

Procedura në realizimin e të drejtës për mbrojtje sociale, mbrojtje familjare-juridike dhe kompetenca e përcaktuar me rregullat penale-juridike, si dhe faktet dhe të dhënat e përcaktuara në këto procedura të cilat mund ta dëmtojnë autoritetin, dinjitetin dhe interesin e qytetarit dhe familjes së tij janë të mbrojtura me detyrimin të institucionit dhe të punëtorëve profesionistë në të, të ruajnë sekret profesional dhe zyrtar, në pajtim me ligj.

Neni 300

Në pikëpamje të procedurave për ndërmarrje të masave për mbrojtje dhe përkujdesje të personave viktime të dhunës familjare, të personave viktime të tregtisë me njerëz, qendra për punë sociale vepron në pajtim me ligj.

Kreu XII.**KTHIMI I MJETEVE TË PRANUARA PA BAZË DHE KOMPENSIMI I DËMIT**

Neni 301

Shfrytëzuesi, i cili me aktvendim të qendrës për punë sociale ka realizuar të drejtë të mbrojtjes sociale dhe atë të drejtë të ndihmës në para dhe/ose shërbim nga mbrojtja jashtë-martësore në pajtim me këtë ligj, është i obliguar t'i kthejë mjetet e pranuar dhe ta kompensojë dëmin, nëse:

- në bazë të të dhënave të paplota dhe të pasakta, për të cilat ka qenë në dijeni ose doemos është dashur të dijë se janë të paplota ose të pasakta, përkatësisht në mënyrë tjetër kundërligjore ka realizuar të drejtë të mbrojtjes sociale në të cilën nuk ka gëzuar të drejtë sipas dispozitave të këtij ligji ose të drejtën e ka realizuar në shumë më të lartë nga shuma e cila i ka takuar për të drejtë konkrete në pajtim me ligj,

- të drejtën e mbrojtjes sociale e ka realizuar për shkak të asaj që pa shkaqe të arsyeshme nuk pa paraqitur ndryshim i cili ndikon në pushimin e lartësisë së të drejtës, përkatësisht të lartësisë së pjesëmarrjes në shpenzimet për vendosje në institucion ose familje kujdestare, ndërsa ka qenë në dijeni ose doemos është dashur të dijë për atë ndryshim dhe

- me tjetërsim të pronës së tij është sjellë në gjendje të mund të realizojë të drejtë të mbrojtjes sociale ose pronën e ka tjetërsuar për kohën e shfrytëzimit të të drejtës.

Neni 302

Nëse shfrytëzuesi nga neni 301 i këtij ligji vdes, qendra për punë sociale ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara dhe të drejtë të kompensimit të dëmit të trashëgimtarëve të cilët do ta trashëgojnë pronën e shfrytëzuesit, në lartësi të pjesës së tyre të trashëguar nëse ka prone të tillë.

Qendra për punë sociale nuk do të kërkojë kthimin e mjeteve të pranuar dhe kompensim të dëmit për mjetet të paguara në bazë të të drejtave dhe shërbimeve nga mbrojtja sociale, nëse me pagesën e këtyre mjeteve trashëgimtarët e shfrytëzuesit dhe anëtarët të familjes së tyre më të ngushtë do të mbeten pa mjete minimale për ekzistencë, më të ulëta se lartësia e ndihmës së garantuar minimale të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 303

Kërkesa për kthim të shumës së mjeteve të paguara nga nenet 301 dhe 302 të këtij ligji kanë të bëjnë vetëm me kërkesat e maturuara për pagesë në shumë të përgjithshme të llogaritur nga dita e pagesës së mjeteve të realizuara në mënyrë kundërligjore në pajtim me nenin 301 të këtij ligji, deri në ditën e maturimit të kërkesës, së bashku me kamatën të llogaritur ligjore.

Neni 304

Kërkesa për kthimin të shumës së mjeteve të paguara dhe kërkesa për kompensim të dëmit vjetërsohet me kalimin e afateve të parapara në Ligjin për marrëdhënie obliguese.

Afatet për vjetërsim për kthim të shumës së mjeteve të paguara dhe për kërkesën për kompensim të dëmit në pajtim me këtë ligj fillojnë të rrjedhin:

- për rastet nga neni 301 paragrafi 1, alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji nga dita e cila është përcaktuar me aktvendimin përfundimtar se shfrytëzuesi ka fituar të drejtën e mbrojtjes sociale në mënyrë kundërligjore,

- për rastet nga neni 301 paragrafi 1, alineja 3 të këtij ligji nga dita e cila është përcaktuar me aktvendimin përfundimtar se shfrytëzuesi i të drejtës për mbrojtje sociale e ka tjetërsuar pronën dhe

- në rastet nga neni 302 paragrafi 1 të këtij ligji nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për shpallje të trashëgimtarëve të shfrytëzuesit të të drejtës për mbrojtje sociale.

Neni 305

Qendra për punë sociale kur do të përcaktojë se shfrytëzuesi ka realizuar të drejtë të mbrojtjes sociale në mënyrë të përcaktuar në nenin 301 të këtij ligji, do të miratojë aktvendim me të cilin shfrytëzuesit do t'i pushojë e drejta e mbrojtjes sociale.

Kur aktvendimi i qendrës për punë sociale me të cilin shfrytëzuesit i pushon e drejta e mbrojtjes sociale do të bëhet përfundimtar, qendra do ta thërrasë shfrytëzuesin e të drejtës së mbrojtjes sociale të merren vesh për shumën, mënyrën dhe afatin e kthimit të mjeteve të pranuar, si dhe për lartësinë e dëmit të shkaktuar të cilin ai duhet ta kompensojë.

Nëse shfrytëzuesi i të drejtës për mbrojtje sociale dhe qendra për punë sociale nuk merren vesh, qendra do të parashtrojë padi të gjykata kompetente për kthim të mjeteve të paguara dhe të drejtës së kompensimit të dëmit.

Kreu XIII.

FINANCIMI

Neni 306

Mjetet për financim të mbrojtjes sociale sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet për financim të mbrojtjes sociale sigurohen edhe nga buxheti i komunës, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 307

Mjetet për financim të mbrojtjes sociale sigurohen edhe nga pjesëmarrja e shfrytëzuesit dhe personat të cilët janë të obliguar ta ruajnë në bazë të rregullave tjera, nëpërmjet arkëtimit të shërbimeve, dhuratave, legatave dhe shuma të tjera në pajtim me ligj.

Mjetet e mara në bazë të dhuratës dhe legatës mbahen në llogari të veçantë të pranuesit të dhuratës dhe legatorit, që realizohet në pajtim me ligj.

Me mjetet nga paragrafi 2 i këtij neni menaxhon dhe disponon pranuesi i dhuratës dhe legatori.

Pagesa e shërbimit të shfrytëzuesit dhe personat nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në varësi nga lloji i shërbimeve të cilat shfrytëzohen dhe mundësitë materiale të shfrytëzuesit të familjes së tij.

Lloji dhe vëllimi i shërbimeve të cilat paguhen nga shfrytëzuesit dhe lartësia e pjesëmarrjes në shpenzimet e shfrytëzuesit dhe personat nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton ministri.

Neni 308

Çmimet e shërbimeve të mbrojtjes sociale me vendim i përcakton ministri në bazë të metodologjisë për formim të çmimeve të shërbimeve në varësi të standardeve dhe normativave për dhënie të shërbimit social.

Metodologjia nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri.

Neni 309

Mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për financim të mbrojtjes sociale sigurohet në bazë të programit vjetor për realizim të mbrojtjes sociale nga neni 9 alineja 2 të këtij ligji.

Neni 310

Me mjetet nga nenet 306 paragrafi 1 dhe 309 të këtij ligji financohen:

- 1) të drejtat e mbrojtjes sociale të përcaktuara me këtë ligj;
- 2) veprimtaria e institucioneve për mbrojtje sociale në pajtim me programin për punë të institucionit dhe
- 3) mirëmbajtja rrjedhëse, ndërtimi dhe pajimi i objekteve për mbrojtje sociale.

Neni 311

Në programin për punë të institucionit për mbrojtje sociale përcaktohet lloji, vëllimi, përmbajtja dhe kualiteti i shërbimeve të cilat u jepen shfrytëzuesve, përkatësisht veprimtaria e cila bëhet në institucion gjatë zbatimit të mbrojtjes sociale.

Për realizimin e programit nga paragrafi 1 i këtij neni, institucioni publik për mbrojtje sociale i themeluar nga Qeveria e përcakton vëllimin e mjeteve të nevojshme, edhe atë për:

- të drejtat e mbrojtjes sociale të cilat realizohen në institucionin për mbrojtje sociale, në lloj dhe vëllim të përcaktuara me këtë ligj,
- rrogat në bazë të ligjit dhe marrëveshjes kolektive,
- amortizim në pajtim me ligj,
- shpenzime materiale,
- mirëmbajtje rrjedhëse, ndërtim dhe pajisje dhe
- me ligj obligime të përcaktuara të institucionit.

Ministri i lejon mjetet e institucionit publik për mbrojtje sociale për realizim të programit për punë nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 312

Qendra kompetente për punë sociale është obliguar më së voni deri në datën 5 të muajit të dorëzohet te Ministria raport për shfrytëzim të mjeteve për muajin e fundit dhe kërkesë për mjetet e nevojshme për pagesë të të drejtave të ndihmës në para nga mbrojtja sociale për muajin rrjedhës me numrin e përgjithshëm të amvisërive, përkatësisht shfrytëzues për të cilët duhet të paguhet ndihmë.

Pas përfundimit të çdo gjashtë mujori të vitit, qendra për punë sociale përpilon raport për gjendjet nga kontrolli i kryer te amvisëritë në gjashtëmujorin e kaluar dhe e dorëzon te Ministria.

Neni 313

Institucioni për mbrojtje sociale mund të realizojë mjete dhe në bazë të ushtrimit edhe të veprimtarive tjera për avancim të veprimtarisë së institucionit.

Për shfrytëzimin e mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 30 ditësh njoftohet Ministria.

Neni 314

Mjetet për punë të institucionit publik për mbrojtje sociale të cilën e themelon komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit i siguron komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit.

Me mjete personale dhe nga burime të tjera komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit në mënyrë të pavarur mund të financojnë edhe program për mbrojtje sociale të qytetarëve nga rajoni i tyre mbi nivelin të cilin e siguron Republika.

Neni 315

Për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve për mbrojtje sociale institucioni për mbrojtje sociale i themeluar nga Qeveria është i obliguar të parashtojë raport tremujor te Ministria.

Institucioni nga paragrafi 1 i këtij neni është i obliguar të parashtojë llogari vjetore te Ministria.

Institucioni publik për mbrojtje sociale i themeluar nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit parashtron raport tremujor dhe llogari vjetore te themeluesi.

Ministria, kurdoherë të vlerësojë se ekzistojë shkaqe, do të kryejë kontroll të drejtpërdrejtë të mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve për mbrojtje sociale në institucionin për mbrojtje sociale për të cilin siguron mjete financiare dhe do të imponojë masa për mënjanim të parregullsive të parashikueshme.

Kreu XIV.

MBIKËQYRJA

Neni 316

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të dispozitave të këtij ligji, e kryen Ministria.

Neni 317

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes për ligjshmërinë e punës, Ministria mund ta ndalojë zbatimin e aktit të përgjithshëm të institucionit për mbrojtje sociale, për të cilin mendon se nuk është në pajtim me ligjin.

Neni 318

Ministria me të drejtën e mbikëqyrjes mund ta shfuqizojë aktvendimin përfundimtar të qendrës, nëse konfirmon se me atë është shkelur ky ligj.

Pas shfuqizimit të aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, qendra është e obliguar që menjëherë ta ndalojë zbatimin e tij.

Neni 319

Ministria ka të drejtë dhe obligim që t'ua ndalojë personit juridik, personit fizik dhe shoqatës së qytetarëve që kryejnë veprimtari nga fusha e mbrojtjes sociale, kryerje

të veprimtarisë nga mbrojtja sociale, nëse në bazë të mbikëqyrjes së realizuar konfirmon se më tej nuk janë të plotësuar kushtet e përcaktuara për kryerjen e veprimtarisë, ose veprimtaria kryhet në dëm të shfrytëzuesve, ndërsa të metat e konstatuara, personi juridik, fizik dhe shoqata e qytetarëve nuk i mënjanojnë në afatin e caktuar nga Ministria.

Kundër aktvendimit për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë, mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 320

Pas aktvendimit përfundimtar nga neni 319 i këtij ligji, Ministria:

- , di t'i heqë marrjen e vendimit për themelimin e qendrës për shërbime sociale në komunitet nga neni 173 i këtij ligji,

- i propozon Qeverisë që ta heqë lejen për themelimin e qendrës për punë sociale dhe institucionit për mbrojtje sociale jashtë-familjes nga neni 171 paragrafi 2 të këtij ligji, ndërsa kur bëhet fjalë për institucion publik të themeluar nga Qeveria, dhe marrje të vendimit për shuarjen e institucionit publik.

Neni 321

Mbikëqyrjen e punës së organeve të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, e kryen Ministria në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe rregullave nga lëmi i mbrojtjes sociale.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së punës së organeve të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria i kryen punët në vijim:

- e ndjek ligjshmërinë e punës, ndërmerr masa dhe aktivitete dhe parashtron iniciativa për realizimin e kompetencave të organeve të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, në pajtim me këtë ligj,

- vlerëson nëse organet e komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, i sigurojnë kompetencat e komunës, Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, të kryhen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj,

- u sugjeron organeve të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj, dhe u propozon masa adekuate për tejkalim, e sipas nevojës ndërmerr masa nga kompetenca e vet për tejkalimin e gjendjeve të atilla,

- jep rekomandime për zbatim konsekuent të kompetencave të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, në kuadër të këtij ligji, me kërkesë të tyre,

- parashtron iniciativa dhe propozime te komuna, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, nëse konstaton moszbatim të këtij ligji për shkak të ndeshjes së kompetencave ndërmjet organeve të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit,

- e ndjek ligjshmërinë e aktvendimeve që kryetari i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit, i miraton për zgjidhjen e të drejtave, obligimeve dhe interesave individuale, të personave fizikë dhe juridikë dhe ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj,

- e ndjek realizimin e mbikëqyrjes së mëparshme të rregullave të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit dhe

- me kohë i informon organet e komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, për gjendjet e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Ministria mund t'ua heqë kompetencat komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, në rastin kur do të konstatojë moszbatim të ligjeve dhe rregullave nga lëmi i mbrojtjes sociale, me ç'rast cakton edhe afat për mënjanim të tyre.

Kreu XV.

MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Neni 322

Ministria kryen mbikëqyrje inspektuese të zbatimit dhe aplikimit të ligjeve dhe rregullave tjera nga sfera e mbrojtjes sociale, të institucioneve për mbrojtje sociale dhe dhënësve të tjerë të shërbimeve sociale.

Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat nga Ligji për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj më ndryshe nuk është e rregulluar.

Neni 323

Mbikëqyrja inspektuese, përfshin:

- mbikëqyrje të aplikimit dhe zbatimit të këtij ligji dhe ligjit tjetër, si dhe të akteve të përgjithshme dhe të veçanta të miratuara në bazë të të njëjtëve, me të cilat janë të rregulluara punët nga sfera e mbrojtjes sociale,

- mbikëqyrje të punës me rëndësi për statusin e kryerësit të veprimtarisë së mbrojtjes sociale,

- mbikëqyrje të përmbushjes së kushteve që kanë të bëjnë me hapësirën, pajisjen dhe kuadrin profesional për kryerjen e veprimtarisë nga mbrojtja sociale,

- mbikëqyrje për realizimin e të drejtave dhe plotësimin e obligimeve të shfrytëzuesve, të përcaktuara me këtë ligj,

- mbikëqyrjen e përmbushjes së kushteve të nevojshme për kryerjen e punëve të punëtorit profesionist ose tjetër në institucionin për mbrojtje sociale, personit juridik ose fizik, të cilët kryejnë punë të caktuara nga mbrojtja sociale,

- përgatitjen e evidencës, dokumentacionit dhe raporteve për punën e kryerësve të mbrojtjes sociale dhe

- mbikëqyrje për zbatimin e masave të shqiptuara pas mbikëqyrjes inspektuese të kryer paraprakisht.

Neni 324

Mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë inspektorët dhe nëpunës të tjerë shtetërorë në Ministri, të autorizuar për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese.

Neni 325

Inspektor mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka fituar të paktën 300 kredi sipas SEKT-së ose ka përfunduar shkallën VII/1 në fushën e shkencave shoqërore, të dëshmuar me certifikim,
- ka pesë vjet përvojë pune në fushën e mbrojtjes sociale,
- i përbush kushtet e tjera të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- posedon certifikatë për njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, dhe
- ka licencë për inspektor në fushën e kompetencës së shërbimit inspektues.

Neni 326

Ministri e emëron dhe e autorizon inspektorin, në pajtim me këtë ligj.

Neni 327

Inspektori posedon legjitimacion zyrtar, si dokument zyrtar me të cilin e tregon cilësinë zyrtare, identitetin dhe autorizimin për ndërmarrjen e punëve nga mbikëqyrja inspektuese.

Ministri e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi 1 i këtij neni, mënyrën e dhënies së tij, përdorimin, heqjen dhe evidencën e legjitimacioneve të dhëna dhe të hequra.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori është i detyruar që ta tregojë legjitimacionin zyrtar.

Neni 328

Procedurën e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori e ngrit dhe udhëheqë sipas detyrës zyrtare, sipas dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Neni 329

Mbikëqyrjen inspektuese inspektori e kryen nëpërmjet:

- mbikëqyrjes së rregullt inspektuese,
- mbikëqyrjes inspektuese kontrolluese dhe
- mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese.

Mbikëqyrja e rregullt kryhet në bazë të programit vjetor.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme realizohet me detyrë zyrtare, iniciativë qytetare, të organit kompetent, organeve dhe organizatave tjera dhe personave tjerë juridikë, kur ekziston interes i qytetarit, interes i personave të tretë ose interes i përgjithshëm.

Neni 330

Ministri përgatit propozim për programin vjetor të punës të shërbimit inspektues dhe ia paraqet Këshillit të Inspektimit jo më vonë se 31 tetori i vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

Ministri miraton programin vjetor të punës nga paragrafi 1 i këtij neni, në afat prej shtatë ditëve nga dita e marrjes së pëlqimit, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës nëse këshilli inspektues nuk e shqyrton dhe dorëzon pëlqimin.

Në bazë të programit vjetor të miratuar, Ministri përgatit planet tremujore për punë për secilin inspektor i cili në përmbledhje i dorëzon në shqyrtim te Këshilli Inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit tjetër kalendarik deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë të vitit vijues, deri më 15 mars tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për të tretin, përkatësisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit aktual.

Në planet tremujore për punë për secilin inspektor ministri në mënyrë të detyrueshme i regjistron numrin e mbikëqyrjes së planifikuar në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikimit të secilës prej mbikëqyrjeve.

Në bazë të planeve tremujore për secilin inspektor ministri përgatit plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjes sipas datave dhe sipas subjektit të mbikëqyrjes.

Ministri më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit rrjedhës kalendarik për vitin kalendarik paraprak për Këshillin e Inspektoratit në përmbledhje dorëzon raporte tremujore për punën e çdo inspektori deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit vijues, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për të dytin, përkatësisht deri në 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

Ministri më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës te Këshilli i Inspektimit dorëzon raport vjetor për punë në shërbimin inspektues për vitin e kaluar.

Neni 331

Mbikëqyrja inspektuese e jashtëzakonshme nuk do të zbatohet, nëse nga iniciativa konstatohet se

- procedura nuk ka mbaruar në mënyrë të plotfuqishme,
- paraprakisht për punën e njëjtë, është kryer mbikëqyrje inspektuese,
- nga dokumentacioni i parashtruar duket qartë se procedura është udhëhequr në pajtim me rregullat ligjore,
- realizimi i mbikëqyrjes inspektuese, është në kompetencë të organit tjetër inspektues.

Neni 332

Para se të fillojë realizimi i mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese, inspektori i ndërmerr aktivitetet e mëposhtme:

- e thirr parashtruesin e kërkesës, përkatësisht iniciativës që t'i plotësojë me dokumentet e nevojshme ose t'i arsyetojë më hollësisht dhe
- kryen vlerësim profesional dhe kontroll të kompetencës, obligimeve dhe përgjegjësiive të institucionit, personave tjerë nga mbrojtja sociale.

Neni 333

Inspektori i informon personin udhëheqës ose personin tjetër të autorizuar për ardhjen e tij në institucionin për mbrojtje sociale dhe dhënësit tjerë të mbrojtjes sociale.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori në realizimin e mbikëqyrjes inspektuese ka të drejtë që në çdo kohë, pa paralajmërim dhe leje të personit udhëheqës, të hyjë në lokalet e institucionit për mbrojtje sociale dhe dhënësve të tjerë nga mbrojtja sociale.

Neni 334

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori mund t'i kontrollojë objektet dhe lokalet e punës, librat afariste, regjistrat, evidencën dhe dokumentacionin, dokumentet dhe shkresat e lëndëve, t'i dëgjojë shfrytëzuesit, të punësuarit, si dhe personat tjerë, ta konfirmojë identitetin e personit duke e kontrolluar dokumentin personal, përkohësisht t'i marrë dokumentacionin, lëndët dhe shkresat tjera, ta ndjekë kryerjen e masave të caktuara për tejkalimin e parregullsisë të caktuara, si dhe të ndërmarrë punë të tjera të përcaktuara dhe në pajtim me këtë ligj.

Inspektori është i detyruar të veprojë me ligj, në kohë dhe në përputhje me Kodin e Etikës së nëpunësve civilë dhe Kodin e etikës së shërbimit inspektues dhe të mbajë fshehtësinë e të dhënave të klasifikuara.

Udhëheqësi ose ndonjë person tjetër i autorizuar në institucionin e mbrojtjes sociale dhe dhënësi tjetër i shërbimeve sociale është i detyruar që inspektorit t'i mundësojnë kryerje të papenguar të mbikëqyrjes inspektuese dhe t'i sigurojë disponim dhe inspektim në të gjitha mjetet dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 335

Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, gjendjen e konstatuar dhe masat e ndërmarra, përkatësisht masat dhe afatet e përcaktuara për mënjanimin e parregullsisë të caktuara, inspektori përpilon procesverbal.

Neni 336

Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar konstaton se ka pasur parregullsi nga neni 350 i këtij ligji, inspektori i autorizuar është i detyruar të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer nga punëtori profesionist i cili drejtpërdrejt kryen punët në implementimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregullave në fushën e mbrojtjes sociale, me sugjerim për realizim të parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzimin e njëkohshëm të thirrjes për zbatimin e edukimit të punëtorit dhe të subjektit ku është përcaktuar parregullsia.

Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri.

Edukimin e organizon dhe e realizon inspektori, përkatësisht edhe nëpunësit e tjerë shtetëror në Ministri, të autorizuar për realizimin e mbikëqyrjes inspektuese, në afat jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e kryerjes së inspektimit.

Edukimi mund të realizohet për një numër parregullsisish identike ose identike të përcaktuara për një ose më shumë punëtorë profesionistë që i kryejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat dhe subjektet.

Nëse në terminin e caktuar punëtori profesionist ose subjekti në të cilën realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është zbatuar.

Nëse punëtori profesionist ose subjekti në të cilin zhvillohet edukimi paraqitet në edukimin e planifikuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se ai është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

Nëse inspektori i autorizuar gjatë zbatimit mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 të këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

Nëse inspektori i autorizuar, gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Inspektori dhe nëpunësit e tjerë shtetërorë në Ministri, të autorizuar për zbatim të mbikëqyrjes inspektuese mbajnë evidencë për zbatimin e edukimit.

Ministri me akt e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës nga paragrafi 9 i këtij neni.

Neni 337

Ministria për kontrollin e kryer nga inspektorët dhe edukimet e zbatuara përgatit raporte tremujore, të cilat i publikon në ueb faqen e Ministrisë për rishikimin tremujor të unifikuar.

Neni 338

Në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori është i autorizuar që me aktvendim t'i caktojë masat në vijim:

- të urdhërojë mënjanimin e mangësive dhe parregullsisë të konstatuara, në afat të caktuar dhe
- të urdhërojë që miratuesi i aktvendimit, ta rishqyrtojë atë dhe të miratojë aktvendim të ri, me të cilin do ta zëvendësojë aktvendimin e mëparshëm, të miratuar në kundërshtim me ligjin ose rregull tjetër.

Në aktvendimin me të cilin caktohet masa përcaktohet edhe afati për zbatimin e tij.

Në rast të rrezikut të prishëm të drejtpërdrejtë për shëndetin ose jetën e qytetarëve, inspektori do të marrë aktvendim gojor dhe menjëherë do të urdhërojë zbatimin e tij. Aktvendimi gojor futet në procesverbalin nga neni 335 i këtij ligji, ndërsa aktvendimi me shkrim merret në afat prej tetë ditësh nga dita e shqiptimit të aktvendimit gojor.

Neni 339

Inspektori, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese i ka të drejtat dhe obligimet si vijojnë:

- me aktvendim të ndalojë që institucioni për mbrojtje sociale dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë punë të caktuara nga mbrojtja sociale, të zbatojnë masa dhe të ndërmarrin punë të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe dispozitë tjetër dhe